**Shtojca 1.**

Programi për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave dhe Lirive themelore të Njeriut (2021-2025), dhe Plani i Veprimit (2021-2023)

**Raporti i monitorimit të zbatimit të  Planit të Veprimit për vitin (2021-2022)**

**Mars, 2023**

Në vijim është prezantuar Plani i Veprimit(2021-2023) për zbatimin e Programit për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave dhe Lirive themelore të Njeriut (2021-2025), me kolonën në fund ku tregohet progresi në zbatim, siç rekomandohet nga Manuali i Qeverisë për Planifikimin, Hartimin dhe Monitorimin e Dokumenteve Strategjike (2019).

Udhëzim:

Ngjyra e gjelbërt tregon zbatimin e plotë të një aktiviteti
Ngjyra e portokalltë tregon zbatimin e pjesshëm apo se një aktivitet është në zbatim e sipër
Ngjyra e kuqe tregon se aktiviteti nuk është zbatuar dhe nuk ka asnjë zhvillim lidhur me të

## Shtojca 1.

**Raporti i monitorimit të planit të veprimit për vitin (2021 -2022)- Modeli për progresin kundrejt veprimeve**

Fokusi i raportit të planit të veprimit është në përfundimin e veprimeve (progresit) siç parashihet në planin e veprimit dhe arsyet e vonesave, të cilat jepen në shtyllën "Progresi në zbatim".

| **Nr.** | **Objektivat dhe veprimet** | **Afati i fundit** | **Burimi i financimit** | **Institucioni udhëheqës dhe mbështetës** | **Produkti (Output)** | **Progresi në zbatim** |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **I.** | **Objektivi strategjik: Përmirësimi i qeverisjes, transparencës, koordinimit institucional dhe llogaridhënies brenda institucioneve publike për të realizuar më tej të drejtat e njeriut** | | | | | |
| **I.1** | **Objektivi specifik: Zhvillimi i mekanizmave institucional efektiv, të përgjegjshëm, gjithëpërfshirës, pjesëmarrës dhe të përgjegjshëm, në të gjitha nivelet për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut** | | | | | Progresi në zbatim |
| I.1.1 | Të Funksionalizohet Grupi Koordinues Ndërministror për të Drejtat e Njeriut, si mekanizëm kryesor Koordinues qeveritar për të drejtat e njeriut | 2021 | Buxheti i Kosovës | ZKM/ZQM | Grupit Koordinues Ndërministror për të Drejtat e Njeriut funksional<br><br>Rregullorja e punës së Grupit Koordinues Ndërministror për të Drejtat e Njeriut e aprovuar | Qveria e Kosovës është duke i dhënë prioritet përmirësimit të koordinimit ndër-institucional në aspektin e hartimit dhe zbatimit të legjislacionit dhe Politikave në fushën të drejtave të njeriut. Me dt .10 dhjetor 2021, në rrjedhën e koordinimit të procesit për plotësim ndryshim të Vendimit Nr.06/87, Datë:13.05.2016 për Grupin Koordinues Ndërministror për të Drejtat e Njeriut, Qeveria e Kosovës ka marrë Vendim për themelimin e Grupit Koordinues Ndërinstitucional për të Drejtat e Njeriut. Ndryshimet janë fillimisht me emërtimin e grupit duke qenë se anëtarët e saj nuk janë vetëm ministrit e linjës por edhe institucione të pavarura dhe si i tillë nuk mund të quhet mekanizëm ndërministror duke ju referuar (vendimit të kaluar) por mekanizëm ndërinstitucional. Ky mekanizem do të udhëhiqet nga Zëvendëskryeministrja e tretë për çështje të pakicave dhe të drejtave të njeriut znj. Emilija Rexhepi. Grupit Koordinues Ndërinstitucional për të Drejtat e Njeriut është organ kryesor koordinues për të drejtat e njeriut, në kuadër të Qeverisë së Kosovës, detyrat, përgjegjësitë dhe përbërja e të cilit janë të përcaktuara me Vendim Nr.10/47 me date 10.12.2021<br>Grupi funksion në bazë të Rregullores së punës Nr.01/2021.Në muajin qershor 2022-është mbajt takimi konstituiv i këtij mekanizmi qeveritar me përbërje të re. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| I.1.2 | Funksionalizimi dhe fuqizimi i i mekanizmave për mbrojtjen nga diskriminimi në qeveri dhe komuna konform legjislacionit në fuqi | 2021-2022 | Buxheti i Kosovës | ZKM/ZQM Ministritë, Komunat KE ZBEK | Në nivelin qendror dhe lokal të qeverisjes janë funksionalizuar mekanizmat për mbrojtjen nga diskriminimi | Në nivel ministror dhe të komunave janë themeluar mekanizmat institucional për mbrojtjen nga diskriminimi. Sipas të dhënave zyrtare të MAPL, shohim se deri më tani janë 30 komuna të cilat kanë caktuar zyrtarin për mbrojtjen nga diskriminimi, ndërsa 8 komuna (Klinë, Kamenicë, Kllokot, Hani Elezit, Partesh, Novobërdë, Kaçanik, dhe Zubin Potok), janë zyrtarë tjerë që e mbulojnë këtë fushë. Probleme në vete është se këto mekanizma –struktura, nuk kanë një strukturë uniforme të organizimit dhe emërimit ,dhe jo në konformitet me Ligjin NR. 05/L -021 për mbrojtjen nga diskriminimi,si dhe Rregulloren Nr.03/2017 për mekanizmat institucional për mbrojtën nga diskriminimi në Qeveri dhe Komuna.<br>Me qenëse është në proces Vlerësimi Ex-post i Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në kuadër të këtij vlerësimi do të bëhet edhe vlerësimi i procesit të themelimit dhe funksionimit të mekanizmave për mbrojtjen nga diskriminimi në ministri dhe komuna. |
| I.1.3 | Këshillime profesionale për realizimin e të drejtës, informim të drejtë dhe të shpejtë dhe të qasshëm të dokumenteve përmes të cilave realizohen të drejtat e tyre. | 2021-2023 | Buxheti i Kosovës | ZKM/ZQM ABGJ Ministrit Komunat | Numri i fushatave dhe aktiviteteve vetëdijusese dhe informuese të organizuara Realizimi i debateve, tryezave me grupet e ndryshme të interesit<br><br>Ndërgjegjësimi i qytetarëve për të drejtat e tyre dhe qasjen në shërbime | Në zbatim të kësaj mase ka pas aktivitete të shumta të realizuara nga ana e ministrrive dhe komunave, agjensioneve, duke vu theksin në disa me kryesore; Njësia për të drejtat njeriut dhe mbrojtje nga diskriminimi në MBPZHR, në vazhdimësi ka informuar dhe udhëzuar për të drejtën e mbrojtjes nga diskriminimi dhe për mjetet ligjore të disponueshme për këtë mbrojtje për të gjithë punonjësit dhe fermerët/fermeret, që pretendojnë se janë të diskriminuar.<br>**Ministria e Shëndetsisë,** ka mbajtur tryeza diskutimin në 8-të QKMF - Komunale me profesioniste shëndetsore, ku është prezantur Ligji për mbrojte nga diskriminimi si dhe jane dhënë këshilla dhe rekomandime si të zbatohet në praktik ,si dhe qajsa e punëtorëve shëndetsorë në raport me qytetarin gjatë marrjes së shërbimeve shëndetësore. MSh ka linjen e akesave ku qytetaret munden me shprehë pakënaqesit gjatë marrjes së shërbimeve shëndetësore.<br>**Promovimi i të drejtës për qasje në shërbime shëndetësore-** Me përkrahjen e projektit të ‘’Accessible Quality Healthcare’’ është përgatitur video mesazhi lidhur me të drejtën e qasjes në shërbimet shëndetësore, pjesë e videos është edhe numri i linjës se ankesave 080017777. Video mesazhi është shfaqur në televizionet nacionale në Kosovë si dhe në rrjetet sociale.<br>**Gjatë vitit 2022** me qëllim që profesionistët shëndetësor të njoftohen me Ligjin për Mbrojtje nga Diskriminimit lidhur me obligimet dhe të drejtat që parshehë ky ligj si dhe janë prezantuar disa nene të Konventave ndërkombëtare me të cilat mbrohet e drejta për shëndet; prezantimet janë mbajtur në 5 (pesë) QKMF me përkrahjen financiare nga projektit të |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | AQH-së;<br>Vazhdimi i tryezave në kujdesin Parësor, pasi që kontakti i parë i pacientit me mjekun është në nivel të kujdesit parësor shëndetësorë.Tryezat kanë përfshirë 50 profesionistë shëndetësor të nivelit: udhëheqës i drejtorisë, shefa të njësive në kuadër QKMF–ve, kryeinfermierë, koordinator i cilësis, kërkesa e tyre ka qene që të vazhdohet me këtë temë prezantimin në të gjitha Komunat po të mbahet dhe për stafin e mesëm infermierik deri me tani kemi përfshi 15 Komuna të QKMF-ve.<br>MSh me qëllim të ngritjes së cilësisë në shërbimet shëndetësore dhe me qëllim që qytetarit ti krijohet mundësia që ti shprehe pakënaqesitë gjatë marrjes se shërbimeve shëndetësore ka themeluar linjen e ankesave që nga viti 2013 dhe gjatë vitit 2022 janë regjistruar gjithësej 204 ankesa përmes linjës ankesave dhe emailit linjafalas@rks-gov.net si dhe një numër i madhe kanë qene për informata dhe qështje tjera për natyra të ndryshëme, raporti i ankesave është i publikuar në ueb faqen e MSh –së për vitin 2022.Me qëllim që qytetaret e komunitetit rom ashkali dhe egjiptase të njoftohen për linjen e ankesave dhe si me parqite ankese pasi dhe e kemi pa pages, kemi mbajtur tri tryeza diskutimi me përkrahjen e projektit të AQH-së me përfaqësusesit e organizatave që merren me të drejtat e komunitetit në fjale me ni numër të qytetareve të këtij komuniteti, me qëllim që ata të njoftojnë komunitetin e tyre se kanë një linje pa pages ku munden me thirre dhe me paraqite ankesat dhe pakënaqësit lidhur me marrjen e shërbimeve shendetësore.<br>Këto tryeza kanë përfëshi 30 pjesëmarrës.<br>**Komuna e Prishtines;** ka realizuar 2 fushata vetëdijësuese, për të drejtat e njeriut si dhe në kuadër të tyre pjesë e diskutimeve ka qenë edhe informimi se si të i shfrytëzojnë shërbimet dhe të drjetat e tyre në kudër të komunës.<br>Web faqja e komunës për çdo dite përditësohet me informata për të gjitha veprimet e komunës<br>Komuna e Prizerenit; ka mbajtur takim vetëdijesues me OJQ dhe zyrtar komunal për rendësin e përfaqësimit të femrave në vendimmarrje dhe për nevojën e rregullimit të infrastrukturës institucioane dhe hapsinore për të derjtat në qasje të Personave me aftësi të kufizuara.<br>Komuna e Kamenices- NJKDNJ, gjatë gjithë vitit organizon aktiviteteve vetëdijusese dhe informuese për ndërgjegjësimin e qytetarëve për të drejtat e tyre dhe qasjen në shërbime.<br>Agjensioni për Informim dhe Privatësi ka qenë i fokusuar në Promovimin e së drejtës për qasje si dhe këshillimi dhe njoftimi i drejtpërdrejtë i qytetarëve për procedurat e realizimit të së drejtës së tyre për qasje në dokumente publike, përmes paraqitjeve në emisione televizive, debateve |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | Janë përditësuar web faqet e ministrive dhe komunave me informacione të nevojshme lidhur me informin e qytetarëve lidhur me realizimin e të drejtave të tyre për qasje në shërbime | ,tryezave etj.<br><br>Web faqet e ministrive dhe komunave në vazhdimësi përditësohen dhe ofrojnë informacione relevante lidhur me realizimin e të drejtave të qytetarëve për qasje në shërbime në fushat e ndryshme të të drejtave të njeriut, konform legjislacionit në fuqi.<br>MAPL ka filluar procesin e digjitalizimit të shërbimeve komunale përmes zhvillimit të platformës E-KOMUNAT. Kjo platformë do të jetë në shërbim të qytetarëve për të rritur pjesëmarrjen e tyre në vendimmarrje në nivelin lokal dhe do të jetë në shërbim të vet komunave për digjitalizimin e shërbimeve komunale duke rritur efikasitetin dhe kualitetin e këtyre shërbimeve karshi qytetarëve. |
| I.1.4 | Të bëhet vlerësimi vjetor i performancës së zyrtarëve publik në kuadër të komunave lidhur me zbatimin e ligjeve në shërbim të qytetarëve për këto shërbime komunale;<br><br>Shërbimet publike administrative;<br>Transparenca komunale;<br>Të drejtat e njeriut, shërbimet sociale dhe familjare;<br>Barazia Gjinore | 2021-2023 | Buxheti i Kosovës | MAPL Komunat Departamenti për Performancë dhe Transparencë Komunale, Koordinatori komunal për Performancë;<br>Drejtori i administratës komunale; dhe Kryetari i Komunës. | Raportet e monitorimit të performancës së komunave të publikuara<br><br>Publikimi i rezultateve të performancës në faqen zyrtare të komunës përkatëse, bërjen transparente të punës së komunës përballë qytetarëve; si dhe krahasimi i | **Raporti i performancës komunale për vitin 2021** prezanton rezultatet e punës së komunave në 19 fusha të kompetencave që janë nën përgjegjësi të tyre, përmes 104 treguesve nga 119 sa ka gjithësej Sistemi për Menaxhimin e Performancës Komunale.<br>Për vitin 2021, raporti përmbledh 7 tregues më shumë se për vitin 2020, për shkak të reduktimit të masave të pandemisë dhe reflektimit të tyre në punën e institucioneve lokale.<br>Raportimi i të dhënave dhe vlerësimi i tyre është bërë përmes Sistemit Elektronik të Menaxhimit të Performancës Komunale. Sistemi shërben edhe për autoritetet qendrore për të planifikuar dhe orientuar politikat në sektorët në nevojë, sipas vlerësimeve reale, kritereve të qarta, ashtu që shpërndarja e investimeve të bëhet në mënyrë të drejtë dhe objektive. Në këtë drejtim, qëllimi i matjes shërben edhe për nevoja të Grantit të Performancës Komunale, pasi tërësia e treguesve të këtij granti, shërbehet me të dhënat e raportit të performancës komunale.<br>**Prandaj, të dy këto procese, matja e performancës dhe ndarja e grantit për performancë, synojnë të përmirësojnë punën e administratës komunale në përgjithësi, të rrisin nivelin e përgjegjësisë dhe llogaridhënies, si dhe të reflektojnë në qeverisje më të mirë dhe shërbime sa më cilësore për qytetarë.**<br>Gjithashtu në periudhën Janar - Mars 2022, në bashkëpunim me KLG është |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | Kulturë, rini dhe sport;<br>Menaxhimi i fatkeqësive;<br>Planifikimi hapësinor;<br>Hapësirat publike;<br>Infrastruktura rrugore;<br>Transporti Publik;<br>Parkingjet publike;<br>Furnizimi me ujë të pijshëm;<br>Kanalizimi;<br>Menaxhimi i mbeturinave;<br>Mbrojtja e mjedisit. | | | Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA)<br>Zyrtaret për Barazi Gjinore;<br>Njësitë për të drejtat e njeriut, në kuadër të komunave; | performancës së komunave në nivelin e fushave prej viti në vit<br><br>Raportim dhe monitorim i nivelit të konsultimit te zyrtareve komunale me mekanizmat institucionale për barazi gjinore (Zyrtare per Barazi Gjinore) dhe me organizata te grave;<br><br>Publikim dhe raportim i nivelit te integrimit gjinor dhe buxhetimit të përgjegjshëm gjinor në hartimin dhe zbatimin e politikave; | realizuar trajnimi 2 ditor me temën "*Ndryshimet në legjislacionin e vetëqeverisjes lokale në Kosovë*" dhe "*Matja e Performancës Komunale*". Ndërsa në bashkëpunim me IKAP dhe DEMOS është realizuar trajnimi 4 ditorë me sesione trajnuese për procesin përgatitor të raportimit të performancës për vitin 2021. Trajnimi është mbajtur në fushat: Transparenca, komunale, përgjegjshmëria, arsimi parauniversitar, shëndetësia primare dhe barazia gjinore. Në të gjitha këto trajnime, pjesëmarrës kanë qenë 151 zyrtarë komunal.<br><br>Informacione më të zgjeruara ofrohen te Raporti i Performancës së Komunave të cilin çdo vit e publikon MAPL.<br>Raporti i performancë së komunave hartohet sipas pikës 7 shtojca 12 e rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të zyrës së kryeministrit dhe ministrive, ku përshkruhet përgjegjësia e MAPL-së në lidhje me mbikëqyrjen cilësisë së shërbimeve komunale.<br><br>Agjensioni për Barazi Gjionore se bashku me UN Women ka mbajtur punëtorin ‘’ Buxhetimi i Përgjegjshëm Gjinor si një mjet për avancimin e barazisë gjinore ne nivel komunal’’ , kjo punëtori është organizuar për nevojat e pushtetit lokal dhe obligimeve në zbatim të Ligjit për Barazi Gjinore dhe Programit të Kosovës për Barazi Gjinore 2020-2024. |
| I.1.5 | Bashkërendimi i veprimeve ndërmjet institucioneve vendore e | 2021-2023 | Buxheti i Kosovës<br>**Donatorët** | MAPL Departamenti për Performancë dhe | Aplikimi i Buxhetimit të Përgjegjshëm Gjinor në sektorët | Gjatë procesit të planifikimit të buxhetit, komunat duhet të përmirësojne dokumentet planifikuese dhe financiare duke marrë për bazë elementin gjinor,të përpilojnë dhe të formulojnë pjesën e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor sipas kritereve ligjore. Politikat lokale duhet të vlerësojnë ndikimin gjinor, ashtu që burimet financiare të ndahen proporcionalisht për të dy |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | ndërkombëtare për ndarjen e fondeve stimuluese komunave<br>➢ bazuar në performancën e të drejtave të njeriut,<br>➢ shërbimet sociale dhe familjare<br>➢ barazinë gjinore dhe nevojat e ndryshme të burrave dhe grave në komunat përkatëse; | | | Transparencë Komunale,<br><br>Koordinatori komunal për Performancë;<br>Drejtori i administratës komunale; dhe<br>Kryetari i Komunës. | përkatës dhe paraqitja e shtojcës se BPGJ-së nga komunat - e kërkuar nga Ministria e Financave me Kornizën Afatmesme të Buxhetit (KAB).<br><br>Komunave më të suksesshme u ndahen mjete financiare nga fondi stimulues për zbatimin e projekteve prioritare të propozuara nga vetë komunat.<br><br>Fondet stimuluese të ndara nga ministria dhe donatorët e mundshëm të cilët e përkrahin zhvillimin e pushtetit | gjinitë.<br>Situata aktuale rezulton si në vijim:<br>• Buxhetimi dhe shpenzimi i përgjegjshëm gjinor,39,19%<br>• Barazia gjinore në buxhetim për punësim dhe ndërmarrësi të grave,60,74%<br>• Pjesëmarrja e grave në takime publike, 29,01%<br><br>MAPL në bashkëpunim me SDC-DEMOS, SIDA dhe Ambasadën Norvegjeze në Kosovë, kanë përmbyllur procesin e përzgjedhjes së komunave përfituese nga granti për performancë komunale për komunat të cilat gjatë vitit 2019 kanë treguar performancë më të lartë në ofrimin e shërbimeve. Për 21 komunat përfituese, nga programi për bashkëfinancim me donatorë bazuar në skemën e grantit për performancë të komunave ne bashkëpunim me projektin DEMOS dhe donatoret e tjerë janë financuar 57 projekte në vlerë prej 3,615,474.00€, prej tyre nga buxheti i MAPL 24 projekte në 8 komuna në vlerë prej 1,232,744.24€ dhe nga buxheti i projektit DEMOS janë financuar 33 projekte në 21 komuna në vlerë prej 2,383,130.00€. Ndërsa, vlerësimi i komunave për grantin e performancës për vitin e alokimit 2022, sipas rezultateve të performancës së vitit 2020 i paraparë për vitin 2021 ka vazhduar gjatë muajit Janar 2022. Rezultatet e performancës për këtë periudhë janë komunikuar në komuna.<br><br>Në vitin 2021, kërkesës për raportim të performancës u janë përgjigjur 37 komuna. Rezultatet e tregojnë se niveli i të arriturave të komunave ndër vite varion prej 56% deri në 66%.<br>Duhet cekur se elementet e matjes së performancës kanë ndryshuar ndër vite, për shkak të përfshirjes së risive brenda SMPK-së, përkatësisht shtimit të treguesve dhe të dhënave të reja. Qëllimi i zgjerimit të fushave dhe treguesve ka qenë që të maten sa më shumë shërbime të mundshme të cilat ofrohen nga ana e institucioneve lokale.<br>Më poshtë është janë paraqitur përqindjet mesatare nga viti 2017 deri në vitin 2021, si në vijim: |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | lokal, në bazë të performancës së treguesve e cila është e shtrirë në tri nivelet e arritjes: **të lartë, të mesëm dhe ultë**<br><br>Raporti i Performancës së Komunave paraqet nivelin e performancës së komunave lidhur me ofrimin e shërbimeve për qytetarët, të vlerësuar sipas indikatorëve matës të sistemit të performancës Komunale, të vendosur nga MPL. | <br>Informacione më të zgjeruara ofrohen te Raporti i Performancës së Komunave të cilin çdo vit e publikon MAPL.<br>Raporti i performancë së komunave hartohet sipas pikës 7 shtojca 12 e rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të zyrës së kryeministrit dhe ministrive, ku përshkruhet përgjegjësia e MAPL-së në lidhje me mbikëqyrjen cilësisë së shërbimeve komunale. |
| I.1.6 | Monitorimi i procesit të zbatimit të rekomandimeve të dala nga raporti i | 2021-2023 | Buxheti i Kosovës | MAPL Departamenti për Performancë dhe | Raporti mbi monitorimin e rekomandimeve të dala nga raporti i performancës | Sa i përket të dhënave për vitin 2021, performanca e përgjithshme e komunave në 19 fusha me 109 tregues të matjes është **56.8%,** që do të thotë se komunat kanë ofruar shërbime më të uëlta për 0.26% krahasuar me 2020. Mesatarja e përgjithshme tregon se komunat duhet të rrisin përpjekjet tyre për të përmirësuar shërbimet dhe qeverisjen. Referuar % sipas fushave, nevoja më e madhe për rritjen e performancës shprehet në këto fusha: |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | performancës së komunave në përmirësimin e shërbimeve përkatëse për qytetarët; | | | Transparencë Komunale, | së Komunave, si dhe Arritjet e përgjithshme të performancës sipas komunave në përqindje. | **përfaqësim të barabartë gjinor (38.02%), kanalizim (35.49%), parkingje (47.04%), zhvillim ekonomik lokal (44,45%), planifikim hapësinor, shërbime shëndetësore, hapësira publike dhe infrastrukturë**.   |
| **I.2** | **Objektivi specifik: Avancimi i mbledhjes së të dhënave për të drejtat e njeriut, monitorimit dhe raportimit** Progresi në zbatim | | | | | |
| I.2.1 | Hartimi i manualit për krijimin e sistemit të monitorimit të drejtave të njeriut në nivel vendi, në konsultim me | 2021 | Financimi i donatorëve | ZKM/ ZQM, ASK ABGJ Ministrite e linjës, Njësia për të Drejtat e | Manuali i hartuar përcakton hapat dhe procedurat për funksionimin e sistemit të | Ka përfunduar Hartimi i manualit ( doracakut për Hapat praktikë të zbatimit për krijimin e një sistemi efektiv të Monitorimit dhe Raportimit të të Drejtave të Njeriut në nivel kombëtar.Mbi bazën e këtij manuali është hartuar Koorniza e Treguesve për të Drejtat e njeriut. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | shoqërinë civile; | | | Njeriut në Komuna si dhe Zyrtarët për Integrime Evropiane në Komuna dhe Zyrtarët për Barazi Gjinore OHCHR | monitorimit të të drejtave të njeriut në nivel vendi | |
| 1.2.2 | Zhvillimi i kornizës së treguesve për të drejtat e njeriut | 2021-2022 | Buxheti dhe **donatorët** | ZKM/ ZQM, Zyra e Komisariatit të lartë për të drejtat e Njeriut OSBE UNICEF UNDP BE KE ABGJ IAP OHCHR | Korniza e treguesve për të drejtat e njeriut e miratuar dhe është në përputhje me treguesit global për të drejtat e njeriut. | Është hartuar Koorniza e Treguesve për të Drejtat e Njeriut. Me qëllim që treguesit të ishin sa më të kuptueshëm dhe shterues, metodologjia e hartimit të tyre konsistoi në përgatitjen e treguesve për secilën të drejtë të detyrueshme të përcaktuar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe në aktet ndërkombëtare të detyrueshme në Republikën e Kosovës. Kjo metodë lehtëson edhe ndarjen e përgjegjësive midis institucioneve të ndryshme, pasi bën më të lehtë identifikimin e treguesve që mbulohen sipas detyrave që u ka ngarkuar ligji institucioneve përkatëse. |
| I.2.3 | Zhvillimi i sitemit (bazës së të dhënave për grumbullimi, analizimin dhe monitorimin e zbatimit të treguesve për të | 2022 | Buxheti dhe donatorët | **ZKM/ ZQM,** ASK ABGJ<br><br>Ministritë e linjës, Komunat UNICEF, | Sistemi për monitorimin e zbatimit të kornizës së treguesve për të drejtat e njeriut gjeneron të dhëna sipas | Sistemi për monitorimin e zbatimit të kornizës së treguesve për të drejtat e njeriut do të vihet në funksion gjatë vitit 2024, pasi të ngriten kapacitetet e institucioneve përkatëse për monitorim dhe raportim konform Kornizës së Treguesve për të Drejtat e Njeriut. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | drejtat e njeriut). | | | Komisioni Evropian<br>Këshilli i Evropës<br>OSBE<br>OHCHR | standardeve të përcaktuara | |
| I.2.4 | Ngritja e kapaciteteve të institucioneve për të siguruar mbledhjen, përdorimin dhe analizën e të dhënave cilësore lidhur me të drejtat e njeriut, të ndara sipas gjinisë;moshës, aftësisë së kufizuar, përkatsisë etnike etj. | 2022-2023 | Buxheti dhe donatorët | ZKM/<br>ZQM,<br>ASK<br>ABGJ<br>Ministritë e linjës,<br>Komunat<br>UNICEF,<br><br>Komisioni Evropian<br>Këshilli i Evropës<br>OSBE<br>OHCHR | Të paktën 40 zyrtarë të trajnuar në mbledhjen, përdorimin dhe analizën e të dhënave;<br><br>Databazat funksionale dhe të përditësuara me të dhëna të ndara sipas gjinisë,moshës, aftësisë së kufizuar, përkatsisë etnike etj. | ZQM-rë me mbështetjen e projektit të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës, "Promovimi i Diversitetit dhe Barazisë për Ballkanin Perëndimor me dt.21 dhe 22 tetor 2021 ka organizuar punëtorinë (trajnimin) për prezantimin e Sistemit të Monitorimit të zbatimit të Ligjit 05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi, e cila ju është dedikuar zyrtarëve për mbrojtje nga diskriminimi në ministri dhe komuna .<br>Zyra për Qeverisje të Mirë ka organizuar me datë; 6-7 shtator 2022, trajnimin dy ditor "Hartimi dhe monitorimi i politikave për të drejtat e njeriut"<br>Qëllimi i trajnimit ishte -Aftësimi i mëtejshëm i zyrtarëve për të drejtat e njeriut dhe anti-diskriminim nga institucionet e Qeverisë së Kosovës dhe institucione të tjera publike të pavarura të Kosovës për t'u aftësuar më the për hartimin dhe monitorimin e zbatimit të politikave publike për të drejtat e njeriut, me fokus në Treguesit e të drejtave të njeriut dhe përdorimi praktik i tyre, gjatë procesit të hartimit, monitorimit dhe raportimit të zbatimit të politikave.<br>Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në bashkëpunim dhe koordinim të ngushtë me Programin për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (UNDP), kanë mbajtur trajnimin dy ditor me zyrtarë/e për barazi gjinore në komuna.<br>Qëllimi i këtij trajnimi ishte ngritja e kapaciteteve profesionale, fuqizimi i mekanizmave lokal në fushën e të drejtave të njeriut, gjithashtu rëndësi e veçantë i është dhënë edhe shkëmbimit të përvojave në mes komunave. Shkëmbimi i përvojave ishte planifikimi i përgjegjshëm gjinor, **mbledhja e të dhënave, raportimi** etj..<br>Agjensioni për Barazi Gjionore se bashku me UN Women ka mbajtur punëtorin ‘’ Buxhetimi i Përgjegjshëm Gjinor si një mjet për avancimin e barazisë gjinore në nivel komunal’’ , kjo punëtori është organizuar për nevojat e pushtetit lokal dhe obligimeve në zbatim të Ligjit për Barazi Gjinore dhe Programit të Kosovës për Barazi Gjinore (2020-2024).<br>ABGJ ka mbajtur punëtori me Zyrtare për Barazi Gjinore ne nivel Ministrore dhe Komunal për monitorimin dhe zbatimin e Programit të Kosovës për Barazi Gjinore, ne vlere prej 1361.00 euro. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| I.2.5 | Raportimi vjetor i progresit për të drejtat e njeriut | 2021-2023 | Buxheti dhe donatorët | ZKM/ ZQM, Ministrit, Komunat, Agjensionet | Raporti vjetor mbi situatën e të drejtave të njeriut i publikuar | Zyra për Qeverisje të Mirë çdo vit harton Raport Vjetor lidhur me situatën e të drejtave të njeriut në vend.Në takimin e fundit të Grupit Koordinues Ndërinstitucional për të drejtat e njeriut mbajtur me 21 Qershor 2022,është prezantuar për shqyrtim dhe aprovim Raporti për të drejtat e njeriut për vitin 2021. Raporti përmban informacione mbi veprimet institucionale të cilat i kanë ndërmarrë institucionet relvante në zbatimin e legjislacionit dhe politikave në fushat e të drejtave të njeriut. Në raport pa mëdyshje evidentohet progresi dhe sfidat e institucioneve karshi obligimeve kushtetuese,ligjore dhe institucionale për mbrojtjen, respektimin dhe zbatimin e të drejtave të njeriut si dhe rekomandimet të cilat adresohen në fushat e ndryshme të drejtave të njeriut. |
| **I.3** | **Objektivi specifik: Rritja e Transparencës dhe lehtësimi i qasjes në informata dhe dokumente publike** Progresi në zbatim | | | | | |
| I.3.1 | Të monitorohet me përpikëri respektimi i afatit kohor për qasje në dokumentet publike nga institucionet publike dhe zyrtarët përgjegjës | Në vazhdimësi | Nuk ka nevojë për buxhet | Agjencia për Informim dhe Privatësi – (AIP) Ministritë Komunat | Është siguruar qasje në informata dhe dokumente publike komfor afatit kohor të përcaktuar me legjislacionit në fuqi nga ana e institucioneve publike<br><br>Numri i gjobave të shqiptuara ndaj | Agjencia për Informim dhe Privatësi, si institucion kompetent për mbikëqyrjen dhe garantimin e zbatimit të Ligjit për Qasje në Dokumente Publike, në bazë të dispozitave të këtij ligji, ka vazhduar të obligojë të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës që të raportojnë mbi numrin e kërkesave për qasje për periudhën njëvjeçare.<br>Nga një total prej 7561 kërkesave për qasje në dokumente publike, 7408 kanë qenë të lejuara, pra iu është dhënë qasje në dokumente publike. Kjo tregon një nivel të lartë të transparencës në institucionet publike, njëkohësisht numri i shtuar i kërkesave për qasje pranë këtyre institucioneve paraqet një vetëdijesim të shtuar të qytetarëve për të realizuar të drejtën e tyre sa i përket qasjes në dokumente publike.<br><br>**Transparenca Komunale**<br>Në këtë fushë janë aplikuar 7 tregues me 26 të dhëna të cilat japin informata për publikimin e akteve, planeve, buxhetit, kritereve të ueb-faqeve, qasjen në dokumentet publike, publicitetin e seancave të kuvendit, etj.<br>Sa u përket performancës sipas tregueseve, përqindja më e lartë është në lejimin e qasjes së qytetarëve në dokumentet zyrtare shprehur me 99.61%.<br><br>AIP, deri tash, ka shqiptuar 4 gjoba administrative ndaj institucioneve publike. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | institucioneve publike dhe zyrtarëve përgjegjës, të cilët nuk e kanë respektuar afatin kohor sipas dispozitave të këtij ligji. | |
| I.3.2 | Agjencia për Informim dhe Privatësi të organizon dhe mbanë konferenca, seminare dhe trajnime për zyrtarët publik përgjegjës, shoqërinë civile dhe publikun e gjerë lidhur me promovimin dhe ngritjen e kapaciteteve lidhur me realizimin e të drejtës për qasje në dokumente publike. | Në vazhdi mësi | Buxheti Donatorët | Agjencia për Informim dhe Privatësi – AIP<br>ZKM-ZQM | Numri i aktiviteteve të organizuara qoftë (konferenca, seminare dhe trajnime),<br><br>Të paktën 40 zyrtarë të trajnuar | Agjencia, gjatë periudhës për të cilin po raportohet, përmes trajnimeve nga personeli profesional i saj, ka investuar në rrjetin e zyrtarëve përgjegjës për qasje në dokumente publike të të gjitha institucioneve të shtetit.<br>AIP ka angazhuar drejtorin e departamentit për qasjen në dokumente publike që të zhvillojë një cikël trajnimesh me të gjithë zyrtarët përgjegjës për qasje në dokumente publike të të gjitha institucioneve publike, në saje të të cilit, theks i veçantë i është vënë çështjes së raportimit vjetor pranë AIP-së. Në kuadër të kësaj fushate janë trajnuar afër njëqindepesëdhjetë (150) zyrtarë publikë për zbatimin në praktikë të Ligjit për Qasje në Dokumente Publike. AIP vazhdon të trajnojë zyrtarët publikë, sipas kërkesës së institucioneve publike [veçanërisht të komunave] dhe sipas planit vjetor.<br>Realizimi i projektit për shënimin e **Ditës Ndërkombëtare për Qasje Universale në Informacione,** i përcjellë me aktivitete të karakterit informues dhe promovues përgjatë një jave në shtatë komunat më të mëdha të Kosovës, që kanë përfshirë:<br>• hulumtim statistikor me qytetarë e shtatë regjioneve për njohuritë e tyre për të drejtën e tyre për qasje në dokumente publike;<br>• një tryezë diskutimi me të ftuar nga institucionet publike, shoqëria civile, gazetaria dhe organizata ndërkombëtare;<br>Ka vazhduar ,Promovimi i së drejtës për qasje dhe njoftimi i drejtpërdrejtë i qytetarëve për procedurat e realizimit të së drejtës së tyre për qasje në dokumente publike, përmes paraqitjeve në emisione televizive, debate, tryeza..<br>Aktivitetet promovues janë pjesë e panadashme e punës së Agjencisë. |
| I.3.3 | Institucioni i Avokatit të | Në vazhdi mësi | Buxheti i Institucio nit të | Institucioni i Avokatit të Popullit | Numri i kërkesave - ankesave të | Avokati i Popullit lidhur me pretendimin për mohim të së drejtës për qasje në dokumente publike, gjatë vitit 2021 ka pranuar gjithsej 44 ankesa, prej të cilave 37 janë hapur për hetim, ndërsa 7 ankesa janë shpallur të |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | Populllit si organ i pavarur për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut, i ndihmon qytetarët në realizimin e të drejtës për qasje në dokumentet publike sipas Kushtetutës, këtij ligji, dhe ligjet përkatëse që rregullojnë fushëveprimin dhe përgjegjësitë e Avokatit të Popullit. | | Avokatit të Popullit | Agjencia për Informim dhe Privatësi – AIP ZKM-ZQM | parashtruara lidhur me realizimin e të drejtës për qasje në dokumente publike<br><br>Numri i rekomandime ve të adresuara dhe zbatuara lidhur me respektimin dhe realizimin e të drejtës për qasje në dokumente publike | papranueshme. Gjithashtu, Avokati i Popullit gjatë viti 2021, ka hapur 1 rast sipas detyrës zyrtare ex.officio.<br><br>Avokati i Popullit lidhur me pretendimin për mohim të së drejtës për qasje në dokumente publike, gjatë vitit 2022 ka pranuar gjithsej 14 ankesa, prej të cilave 3 janë hapur për hetim, ndërsa 11 ankesa janë shpallur të papranueshme.<br><br>Gjatë vitit 2021, Avokati i Popullit i ka adresuar 15 rekomandime lidhur me realizimin e të drejtës për qasje në dokumente publike, nga të cilat 10 rekomandime janë zbatuar, ndërsa 5 rekomandime janë të pa zbatuara.<br><br>Gjatë vitit 2022, Avokati i Popullit ka adresuar 1 rekomandim lidhur me realizimin e të drejtës për qasje në dokumente publike, rekomandimi është i pa zbatuar.<br><br>**(Gjatë vitit 2022-vrehet se ka ra numri i ankesave** për mohim të së drejtës për qasje në dokumente publike **dhe rekomandimeve** lidhur me realizimin e të drejtës për qasje në dokumente publike **,në krahasim me vitin paraprak 2021)** |
| **I.4** | **Objektivi specifik: Zbatimi efektiv i të drejtave të njeriut siç garantohet nga korniza kushtetuese dhe legjislative e Kosovës dhe instrumentet direkt të zbatueshme ndërkombëtare dhe rajonale për të drejtat e njeriut**<br>Progresi në zbatim | | | | | |
| I.4.1 | Institucionet kompetente për monitorimin e zbatimit të ligjeve për të drejtat e njeriut, mbrojtjen nga diskriminimi dhe minoriteteve të raportojnë dhe hartojnë raporte vjetore mbi zbatimin e ligjeve | Në vazhdi mësi | Buxheti i Kosovës | ZQM/ZKM ABGJ ZÇK Komisionari për Gjuhët Ministritë Komunat IAP Inspektorati i Punës | Raportet mbi monitorimin e zbatimit të ligjeve të hartuara dhe publikuara | **Me datë 25 Nëntor 2022 është mbajt ;**<br>Konferenca për lansimin e Raportit Vjetor mbi Zbatimin e LIGJI NR. 05/L -021 PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI për Vitin 2021<br>Gjithashtu është hartu Raporti Vjetor për Zbatimin e Ligjit nr. 06/l-084 për mbrojtjen e fëmijës për Vitin 2021<br>Hulumtimi mbi PREZANTIMIN E GRAVE NË MEDIAT E SHKRUARA 2016 – 2019-publikuar në vitin 2021.Hulumtimi ka dal si rezultat i nevojës për monitorim periodik përmes realizmit të hulumtimeve periodike, bazuar nga kërkesat që burojnë nga korniza ligjore respektivisht të Ligjit për Barazi Gjinore L 05/20<br>Zyra e Komisonerit për Gjuhët në vazhdimësi monitoron dhe harton raporte për zbatimn e Ligjit LIGJI NR. 02/L-37 PËR PËRDORIMIN E GJUHËVE. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| I.4.2 | Të themelohet Njësia Qendrore për përkthim dhe harmonizim të legjislacionit drejt një legjislacioni të harmonizuar shumëgjuhësh | 2022 | Buxheti i Kosovës Donatorët | Zyra e Komisionerit për Gjuhët | Është themeluar Njësia Qendrore për përkthim dhe harmonizimin e legjislacionit në kuadër të Zyrës së Komisionerit për Gjuhët, e cila do të përmirësojë praktikën e përkthimit në procesin legjislativ dhe të fusë një proces të redaktimit, lekturës dhe harmonizimin gjuhësor, me qëllim të harmonizimit të legjislacionit shumëgjuhësh me standarde të larta. | Është krijuar Grupi Punues për formimin e Njësisë, me vendim të Kryeministrit më 08.11.2022 dhe deri më tani janë mbajtur dy punëtori dhe një vizitë studimore, në Qendrën e Shërbimeve Gjuhësore në Kancelarinë Federale Zvicerane dhe në MPJ të Zvicrës, në Bern.<br>Deri më tani janë harxhuar 9.000 euro ,nga shuma e përgjithshme që është paraparë për vitin 2022 (30.000) |
| I.4.3 | Ngritja e kapaciteteve të zyrtarëve përgjegjës për procesin e përafrimit, filtrimit dhe harmonizimit të | Në vazhdi mësi | Buxheti i Kosovës | Ministria përkatëse ZL/ZKM IKAP | Numri i trajnimeve të mbajtura dhe zyrtarëve të trajnuar<br><br>Raporte të publikuara | Është miratuar në Qeveri “Kalendari i Përkthimit me acquis të BE-së 2021.” Raporti i Progresit 2021 për Kosovë përcakton se legjsilacioni i Kosovës pjesërisht transpozon acquis të BE-së për fushat përkatëse. Tanspozimin e direktivave përcaktohet në PKZMSA (2021-2025) sipas kapitujve të acquis, dhe matricës së masave legjislative. Raportet për zbatueshmërinë e tyre janë të përcaktuara në raportet-tremujore të zbatimit të PKZMSA-së (raportet janë të gatshme nga DKPSA-DIE/ZKM). |

<table>
<tr><td></td><td>legjislacionit vendor me kërkesat e BE-së dhe acquis communautaire.</td><td></td><td></td><td></td><td>mbi direktivat e BE-se të transpozuara në Kosovë, dhe raporte mbi nivelin e zbatueshmeris e së tyre.</td><td>Janë mbajtur trajnime nga IKAP për “Teknikat e përafrimit të legjislacionit të Kosovës me acquis të BE-së.”<br>Të dhënat për trajnimet për përafrim të legjislacionit për vitin 2021 jane si në vijim:<br>Trajnimet janë mbajtur në periudhen prill-shtator, janë mbajtur 3 trajnime me nga tri dite (gjithsej 9 dite trajnim), jane trajnuar 28 pjesemarres dhe jane certifikuar 27 pjesemarres.<br><br>Janë organizuar trajnime për procesin e përafrimit, filtrimit dhe harmonizimit të legjislacionit vendor me kërkesat e BE-së dhe acquis communautaire.<br>Viti 2022<table><tr><th>Ditë</th><th>Pjesemarres</th><th>Certifikuar per pjesëmarrje</th></tr><tr><td>12</td><td>57</td><td>51</td></tr></table></td></tr>
<tr><td>I.4.4</td><td>Të bëhet vlerësimi ex-post i ligjeve[1], konkretisht të bëhet vlerësimi ex-post i Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi</td><td>2022</td><td>Buxheti i Kosovës<br>Donatorët</td><td>ZL/ZKM<br>ZQM/ZKM<br>Ministritë<br>Komunat<br>OSBE<br>BE<br>KE</td><td>Raporti i vlerësimit ex-post të Ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi i hartuar dhe publikuar</td><td>Me vendimin nr.139/2022 të nxjerr nga zv.Sekretari i Përgjithëshem i Zyrës së Kryeministrit, është themeluar grupi punues për hartimin e Raportit të vlerësimi ex-post të Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi,Gjatë vitit 2023 ka filluar punën grupi punues për vlerësimin ex-post të Ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi, i cili do të del me raport vlerësues lidhur me veprimet pasuese që do ti ndërrmer Qeveria lidhur me Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi.</td></tr>
<tr><td>1.4.5</td><td>Zyra ligjore e Kryeministrit të organizon, promovon dhe siguron mbajtjen e trajnimeve për zyrtarët e departamenteve ligjore dhe fushave përkatëse lidhur me zbatimin e</td><td>Në vazhdi mësi</td><td>Buxheti i Kosovës</td><td>ZL/ZKM<br>Ministritë<br>IKAP</td><td>Janë mbajt trajnimet për zyrtarët e departamenteve ligjore dhe fushave përkatëse lidhur me zbatimin e vlerësimit ex-post</td><td>Zyra Ligjore e ZKM-së, në bashkëpunim me IKAP-in gjatë vitit vitit 2021 ka mbajtur gjithsej 3 trajnime për vlerësimin ex-post të legjislacionit. Gjithashtu për vitin 2022 jaë paraparë edhe 3 trajnime të relalizohen sipas PSO-së deri në fund të vitit 2022.<br>Janë organizuar: 8 ditë trajnim 4 grupe, 38 pjesemarres të nivelit qendror dhe lokal<br><br>Trajnimi me temë “Vlerësimi Ex-ante dhe Ex-Post i legjislacionit”</td></tr>
</table>

[1]Vlerësimi ex-post shihet si shumë i rëndësishëm në sigurimin e zbatimit të legjislacionit primar e sekondar në mënyrë efektive dhe që legjislacionit ti bëhet rishqyrtimi i duhur, gjithashtu është proces i vetëvlerësimit i bërë nga qeveria në politikat e veta dhe rezultatet

<table>
<tr><td></td><td>vlerësimit ex-post në bashkëpunim me IKAP-in</td><td></td><td></td><td></td><td>Të paktën 50-të zyrtarë të trajnuar</td><td><table><tr><td>Ditë</td><td>Pjesemarres</td><td>Certifikuar per pjesëmarrje</td></tr><tr><td>8</td><td>38</td><td>33</td></tr></table>Trajnimi me temë “Vlerësimi Ex-ante dhe Ex-Post i legjislacionit”<table><tr><td>Ditë</td><td>Pjesemarres</td><td>Certifikuar per pjesëmarrje</td></tr><tr><td>6</td><td>33</td><td>33</td></tr></table></td></tr>
<tr><td>1.4.6</td><td>Raportimi i vlerësimit sistematik i ligjshmërisë të akteve të komunave në aspektin e sigurimit të përputhmërisë me aktet dhe politikat e nivelit qendror të qeverisjes</td><td>2021<br>2023</td><td>Buxheti i Kosovës, Buxheti i paraparë në kuadër të Strategjisë Sektoriale për Vetëqeverisje Lokale 2016-2026</td><td>MAPL<br>Komunat</td><td>Sistemi i vlerësimit të ligjshmërisë së akteve të komunave me ministritë e linjës, i përfunduar dhe funksional</td><td>Me qëllim të lehtësimit të mbikëqyrjes dhe krijimit të një sistemi më efikas në këtë drejtim, për të realizuar shqyrtimin e ligjshmërisë së akteve komunale është miratuar Rregullorja (QKR) Nr-06/2021, për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores QRK Nr.10.2019 për shqyrtimin administrativ të Akteve të Komunave.<br>Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave përmes Divizionit të Monitorimit të komunave në përputhje me përgjegjësitë ligjore të përcaktuara më Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, përkatësisht në nenin 86, ka mbikëqyrë veprimtarinë e Komunave të Republikës së Kosovës dhe ka hartuar Raportin Janar-Dhjetor 2021, lidhur me vlerësimin e ligjshmërisë së akteve të kuvendeve të komunave për këtë periudhë. Gjatë kësaj periudhe, komunikimi mes komunave dhe organit mbikëqyrës, përkatësisht Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, në përgjithësi ka qenë i rregullt, dërgimi i akteve të kuvendeve të komunave është bërë në afatin e përcaktuar ligjor brenda 7 dite nga miratimi i akteve në kuvendin e komunës.</td></tr>
<tr><td>II.</td><td colspan="6">Objektivi strategjik: Mbrojtja dhe promovimi i të drejtave të njeriut</td></tr>
<tr><td>II.1</td><td colspan="6">Objektivi specifik: Fuqizimi i sistemit kombëtar për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut (SKMPDNJ)<br>Progresi në zbatim</td></tr>
<tr><td>II.1.1</td><td>Monitorimi i procesit të zbatimit të rekomandimeve të</td><td>2021-<br>2023</td><td>Buxheti i Kosovës</td><td>ZKM/ZQM<br>Ministrit<br>Komunat</td><td>Raporti i monitorimit të zbatimit të rekomandime</td><td>Me qëllim të prioritizimit të procesit të zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit, Kryeministri i Republikës së Kosovës z.Albin Kurti iu drejtua me një letër zyrtare ministrive të linjës që të kenë prioritet shqyrtimin e secilit rekomandim që është adresuar tani dhe atyre që do të</td></tr>
</table>

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | IAP adresuar Ministrive dhe Komunave | | | Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP) ABGJ | ve të IAP adresuar Ministrive dhe Komunave i hartuar | adresohen nga Institucioni i Avokatit të Popullit, me synim ngritjen e nivelit të zbatimit të rekomandimeve dhe respektimin e afatit ligjor prej 30 ditësh për të dhënë të gjitha përgjigjet e kërkuara nga Avokati i Popullit.Zyra për Qeverisje të Mirë ne vazhdimësi monitoron dhe harton raporte lidhur me situatën e zbatimit të rekomandimeve të IAP adresuar Ministrive dhe Komunave . |
| **II.1.2** | Hartimi i një dokumenti (udhëzuesi drejtuar autoriteteve në nivelin qendror dhe lokal të qeverisjes lidhur me sigurimin e përgjigjeve të shpejta dhe brenda afatit ligjor për të gjitha kërkesat dhe rekomandimet e adresuara nga Avokati i Popullit | 2021 | Financimi i donatorëve | **ZKM/ZQM** Komisioni Parlamentar për të drejtat e njeriut Ministritë Komunat Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP | Është hartuar udhëzuesi për monitorimin e zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit<br><br>Sistemi elektronik për monitorimin e zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit (në nivelin lokal dhe qendror), i funksionalizuar dhe gjeneron të dhëna<br><br>Autoritetet në nivel qendror dhe lokal të qeverisjes respektojnë afatin ligjor për kthim të përgjigjeve brenda afatit | Udhëzuesi për monitorimin e zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit është hartuar.<br><br>Mbi bazën e Udhëzuesit funksionon sistemi ku evidentohen të gjitha rekomandimet të cilat institucioni i Avokatit të Popullit i adreson te institucionet ,nvarësisht prej fushës dhe natyrës së të drejtave të cilat i përmban rekomandimi.<br><br>Bazuar në obligimet ligjore në baze të Ligjit nr.05\L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Zyra e Kryeministrit/Zyra për Qeverisje të Mirë monitoron në mënyrë të vazhdueshëm zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit<br>Gjatë viti **2022** janë adresuar gjithsej 109 rekomandime të Avokatit të Popullit në institucionet e nivelit qenderor dhe lokal dhe si rrjedhojë kemi rezultatet si vijon:<br>Statusi I procesit te zbatimit te rekomandimeve |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | ligjor për kërkesat dhe rekomandimet e adresuara nga Avokati i Popullit | **Përgjigje brenda afatit**<br>55<br>50.93%<br>**Përgjigje jashtë afatit**<br>15<br>13.89%<br>**S'ka përgjigje**<br>30<br>27.78%<br>**Implementuar**<br>26<br>24.07%<br>**Në pritje për implementim**<br>79<br>73.15%<br>**Nuk janë implementuar**<br>3<br>2.78% |
| II.1.3 | Qeveria të zbaton rekomandimet e Komisoneve Parlamentare, Trupave ndërkombëtare, Avokatit të Popullit, Komisonerit për Gjuhët, Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës, Zyra Kombëtare e Auditimit, Këshillit Konsultativ për | 2021-2023 | Buxheti i Kosovës | ZKM/ZQM Ministritë, Komunat Agjensionet , Institucionet e Drejtësië, si dhe të gjitha institucionet të cilave u adresohen rekomandimet | Numri i rekomandimeve të zbatuara si dhe raportet mbi monitorimin e zbatimit të rekomandimeve të adresuara nga mekanizmat ndërkombëtar dhe vendor | Qeveria e Kosovës është duke i dhënë prioritet zbatimit të rekomandimeve të adresuara nga mekanizmat vendorë dhe ndërkombëtarë. Ne funksion të zbatimit të Rekomandimit të adresuar nga Komisioni Parlamanetar për të Drejtat e Njeriut përmes Kryetarit të Kuvendit të Kosovës, ku rekomandohet që Qeveria pas analizës gjithëpërfshirëse postlegjislative të hartojë Projektligjinë për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr.05/L-021 për mbrojtjen nga Diskriminimi ose eventualisht të hartoj Ligjin e ri, Zv.Sekretari i përgjithshëm i ZKM- ka marrë Vendim Nr.139/2022, për themelimin e grupit punës për hartimin e Raportit të vlerësimit Ex-post të Ligjit Nr.05/L-021 për mbrojtjen nga Diskriminimi.<br><br>Zyra për Qeverisje të Mirë si mekanizëm kryesor për koordinimin e procesit te raportimit karshi trupave të ndryshme ndëkombëtare , ka themeluar Grupin Teknik të Punës për Koordinimin e Zbatimit të Rekomandimeve të Konventës Kornizë për mbrojtjen e Pakicave Kombëtare , |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | Komunitete ,OJQ-ve, lidhur me zbatimin e ligjeve, politikave dhe të drejtave të njeriut. | | | | | Zyra për Qeverisje të Mirë përmes UNMIK-ut ,ka pranuar draft Opinionin e ciklit të 5-te nga Komitetit Këshillues mbi Konventën Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare të Këshillit Evropës..<br><br>Delegacioni nga Komiteti Këshillues mbi Konventën Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare , ka vizituar Kosovën me 04-08. prill.2022.Takimi është organizuar me 08 prill 2022 nga Këshilli i Evropës me koordinim dhe përkrahje të ngushtë të Zyrës për Qeverisje të Mirë.Ky organizim dhe seriozitet është vlerësuar nga delegacioni si takim më i mirë deri me tani i organizuar në mesin e shteteve të vizituara.<br><br>Gjatë muajit mars 2021, Qeveria e Kosovës ka ofruar informacione lidhur me adresimin dhe zbatimin e Rekomandimeve nga Raportuesi Special mbi pakicat; Raportuesi Special për të drejtat e njeriut të personave të zhvendosur brenda vendit; dhe Raportuesin Special për format bashkëkohore të racizmit, diskriminimit racor, ksenofobisë dhe intolerancës përkatëse.<br><br>Gjatë muajit 20 Korrik 2021 , Qeveria e Kosovës ka ofruar informacione lidhur me masat e marra nga autoritetet përkatëse në adresimin dhe zbatimin e rekomandimeve të Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimit ose Ndëshkimit Çnjerëzor ose Degradues. dhe poshtëruese (CPT), në vizitat e mëparshme si dhe në vizitën e fundit. Zyra për Qeverisje të Mirë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit ka udhëhequr dhe koordinuar procesin e dhënies së informacionit nga institucionet përkatëse për adresimin dhe zbatimin e gjetjeve në raportin e hartuar nga Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimit ose Ndëshkimit Çnjerëzor ose Degradues. dhe poshtëruese (CPT), nga vizita e fundit në Kosovë nga të dhënat 6 dhe 16 tetor 2020.<br><br>**Është realizuar me sukses vizita e Z. Fabian Salvioli,** Raportues Special i Kombeve të Bashkuara për promovimin e së vërtetës, drejtësisë, reparacioneve dhe garantimit të mos-përsëritjes. Angazhimi i Qeverisë për adresimin e krimeve të kryera gjatë luftës në Kosovë dhe nismat për drejtësi tranzicionale, ishin tema të takimit të perfaqsuesve te institucioeve te Kosoves me Fabian Salvioli, Raportues Special i Kombeve të Bashkuara për promovimin e së vërtetës, drejtësisë, reparacioneve dhe garantimit të mos-përsëritjes. (Zyra për Qeverisje të Mirë përmes Zyrës për të Drejtat e Njeriut në kuadër të UNMIK-UT e ka kordinuar tëre procesin e Vizitës së Raportuest Specila në Kosove dhe Aranzhimit të takimeve me përfaqsueit e |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | institucioneve relevante. |
| II.1.4 | Krijimi i ekipit të përbashkët për të koordinuar procesin për zbatimit e rekomandimeve të Avokatit të Popullit. | 2021 | Buxheti i Kosovës | **ZKM/ZQM** Institucionit të Avokatit të Popullit (IAP) ABGJ | Ekipi i përbashkët funksional,realizon takime të rregullta , koordinon dhe monitoron procesin e zbatimit të rekomandimeve, adresuar institucioneve në nivelin qendror dhe lokal të qeverisjes. | Ekipi i përbashkët për koordinimin dhe monitorimin e procesit të zbatimit të rekomandimeve, adresuar institucioneve në nivelin qendror dhe lokal të qeverisjes është funksional. Natyra e punës se ekipit fokusohet me tepër në shkëmbim, analizimin dhe krahasimin e të dhënave dhe informatave lidhur me statusin dhe ecurin e tere procesit të zbatimit të Rekomandimeve të Avokatit të Popullit.Bashkëpunim dhe kontaktet me Avokatin e popullit dhe zyrtarët kompetent janë shumë të shpeshta dhe në nivel shumë të mirë profesional dhe kolegial. |
| II.1.5 | Inspektorati i punës ti jap prioritet hetimit dhe trajtimit të ankesave lidhur me rastet e pretenduara të diskriminimit të shkaktuara në sektorin publik dhe privat<br><br>Ngritja e kapaciteve të Inspektoratit të Punës, në raport me diskriminimin, me fokus | Në vazhdimësi | Buxheti është i paraparë në kuadër të Strategjia Sektoriale e MPMS-së 2018-2022<br><br>Plani Kombëtar për Barazi Gjinore | **Inspektorati i Punës** ZKM/ZQM Ministritë Komunat Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP)<br><br>Bashkimi i Sindikatave të Panvarura të Kosovës (BSPK-ja) Bizneset e sektorit privat | Numri i ankesave të pranuara dhe të hetuara lidhur me bazat e diskriminimit në sektorin publik dhe privat, te ndara sipas gjinise dhe etnise;<br><br>Numri i hetimeve ex officio lidhur me hetimin e | **Inspektorati i Punës;** Numri i ankesave të pranuara (799 në sektorin privat dhe 4353 në sektorin publik) gjithsejtë 5152 ankesa të hetuara dhe të trajtuara. Nuk kemi shifër të dhënë sa prej këtyre ankesave kanë qenë mbi bazat e diskriminimit në sektorin publik dhe . privat te ndara sipas gjinisë dhe etnisë;<br>**Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP)-**, **gjatë vitit 2021**, ka pranuar gjithsej 162 ankesa individuale, ku ankuesit pretendojnë se janë viktima të diskriminimit. Nga këto ankesa, për hetim janë hapur 123 raste, ndërsa 39 ankesa janë shpallur të papranueshme.Gjithashtu, Avokati i Popullit gjatë vitit 2021, ka hapur 9 raste me vetiniciativë ex.officio.<br>***Gjinia e ankuesve:***<br>Meshkuj 103<br>Femra 59<br><br>***Përkatësia e ankuesve:***<br>Shqiptar 136; Serb 7; Turq 6; Rom 4; Egjiptas 4; Goran 2; Boshnjak 2; Ashkali 1<br><br>Avokati i Popullit, **gjatë vitit 2022,** ka pranuar gjithsej 132 ankesa |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | diskriminimin në baza gjinore; | | | | rasteve për diskriminim në sektorin publik dhe privat;<br><br>Numri i gjobave të shqiptuara;<br><br># Të paktën 20 Inspektore të trajnuar në trajtimin e rasteve të diskriminimit | individuale, ku ankuesit pretendojnë se janë viktima të diskriminimit. Nga këto ankesa, për hetim janë hapur 88 raste, ndërsa 44 ankesa janë shpallur të papranueshme. Gjithashtu, Avokati i Popullit gjatë vitit 2022, ka hapur 9 raste me vetiniciativë ex.officio.<br><br>Gjinia e ankuesve:<br>Meshkuj 76<br>Femra 56<br>*Gjinia e Përkatësia e ankuesve:*<br>Shqiptar 114; Serb 7; Boshnjak 5; Turq 2; Ashkali 2; Rom 1; Goran 1<br>**Inspektorati i punës** në tërsi deri më tani ka realizuar 3022 inspektime sipas detyrës zyrtare në kuadër të të cilave është trajtuar edhe çështja e diskriminimit. Por nuk kemi të dhëna se ka pasur diskriminim të çfarëdo lloji. Numri i gjobave të shqiptuara është 281. Në mungesë të bazës së të dhënave nuk i kemi të sistemuara sa gjoba janë shqiptuar lidhur me diskriminimin në vend të punës .<br><br>Numri i ankesave të pranuara dhe të trajtuara është 860. Nuk kemi shifër të dhënë sa prej këtyre ankesave sa kanë qenë mbi bazat e diskriminimitnë sektorin publik dheprivat te ndara sipas gjinisë dhe etnisë;<br><br>Inspektorati i punës në tërsi deri më tani ka realizuar 6316 inspektime sipas detyrës zyrtare në kuadër të të cilave është trajtuar edhe çështja e diskriminimit. Por nuk kemi të dhëna se ka pasur diskriminim të çfarëdo lloji.<br><br>Numri i gjobave të shqiptuara është 359. Masa tjera ndëshkuese të shqiptuara janë 2741 vërejtje dhe 88 pezullime të punimeve. Në mungesë të bazës së të dhënave nuk i kemi të sistemuara sa gjoba janë shqiptuar lidhur me diskriminimin në vend të punës .<br><br>Gjatë vitit 2021 janë trajnuar mbi 20 inspektor të punës në trajtimin e rasteve të diskriminimit me bazë gjinore,diskriminimin në punësim. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | me bazë gjinore, diskriminimin në punësim;<br><br># Të paktën 3 (tre) Inspektore gra të rekrutuara | |
| II.1.6 | Të përmirësohen sistemet e menaxhimit të të dhënave. Të regjistrohen ankesat e pranuara, inspektimet e ndërmarra dhe masat disiplinore të filluara, duke i ndarë këto sipas gjinisë së punonjësve, gjinisë së kryerësit të pretenduar | 2022 | Buxheti i Kosovës | **MFPT/ Inspektorati i punës** | Sistemi për evidentimin dhe menagjimin e të dhënave funksionale duke ju referuar diskriminimit me bazë gjinore në lidhje me punën, të kategorizuara sipas llojit të shkeljes, gjinisë së personit që parashtron ankesën dhe personit të cilit i drejtohet ankesa. | Sistemi për evidentimin dhe menaxhimin e të dhënave nuk është funksional. Baza e të dhënave nuk është e instaluar. |
| II.1.7 | Organizimi i forumit për bashkëpunim të strukturuar me | 2021-2023 | Buxheti Donatorët | ZKM/ZQM Institucioni i Avokatit | Konferenca për vlerësimin e situatës së të drejtat e | Gjatë muajit dhjetor në Ditën Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut organizohen aktivitete të ndryshe nga ana e Institucioneve në nivelin qendror dhe lokal të qeverisjes. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | aktorët institucional nga ekzekutivi, legjislativi, gjyqjësori, avokati i popullit, policia dhe organizatat e shoqërisë civile që merren me të drejtat e njeriut. | | | të Popullit (IAP) ABGJ | njeriut dhe shënimit te Ditës Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut e organizuar çdo vit | Dita ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut ,gjate vitit 2021 është shënuar nga Komisioni Qeveritar për personat e zhdukur me një Konferenc-tryezë diskutimi ku kanë marrë pjese akteret relevant vendor e ndërkombëtar për nga KQPZH<br>Gjatë Vitit 2022-Dita Ndërkombëtre për të Drejtat e Njeriut i është kushtuar Të drejtave të personave me aftësi të kufizuara, pasi Viti 2022 ishte shpall Vit i personave me afatësi të kufizuara.<br>Gjithashtu aktivitete për shënimin e Ditës Ndërkombëtre për të Drejtat e Njeriut janë organizuar edhe në komuna. |
| II.1.8 | Të respektohen dhe zbatohen me përpikëri rekomandimet e Mekanizmit Kombëtar kundër Torturës i cili vepron në kuadër të Institucionit të Avokatit të Popullit nga ana e institucioneve kompetente të cilave u është adresua rekomandimi/et. | 2021-2023 | Buxheti Donatorët | Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP)<br>SHKK/MD<br>Mekanizmi t Kombëtar kundër Torturës<br>MSH<br>Departamenti për Shëndetësi në në burgje<br>QKRMT<br>Policia e Kosovës | Numri i kontrolleve dhe inspektimeve të realizuara<br><br>Numri i rekomandimeve të adresuara te institucionet kompetente<br><br>Numri i rekomandimeve të zbatuara nga institucionet të cilave u janë adresuar rekomandimet | Gjatë vitit 2021 Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës (MKP-ja) ka realizuar 62 vizita.<br><br>- 46 rekomandime.<br><br>- Autoritetet kompetente zbatuan 13 rekomandime, 12 rekomandime u zbatuan pjesërisht, ndërsa 21 janë në pritje për implementim. Të gjitha përgjigjet e autoriteteve kompetente ishin pozitive dhe në frymën e bashkëpunimit të ndërsjellë.<br><br>Gjatë vitit 2022, MKP-ja ka realizuar **gjithsej 63 vizita.**<br><br>- **38 rekomandime**<br><br>-Autoritetet kompetente **zbatuan tetë (8) rekomandime, pesë (5) prej tyre u zbatuan pjesërisht ndërsa njëzetepesë (25) janë në pritje për implementim.** Të gjitha përgjigjet e autoriteteve të ishin pozitive dhe në frymën e bashkëpunimit të plotë përpos përgjigjes së Ministrisë së Shëndetësi lidhur me raportin me rekomandime për vizitën në Institutin e Psikiatrisë Forenzike.<br><br>Departameti për Shëndetsinë në burgje:<br><br>Gjatë vitit 2022, në mënyrë të pandërprerë në baza ditore kanë bërë kërkesa dhe kanë kërkuar sqarime të cilave iu kemi përgjigjur brenda ditës, me njoftime apo raporte të veçanta për persona apo çështje. Asnjë përgjigje nuk ka mbetur pa u kthyer. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | Po ashtu çdo lëndim trupor i evidentuar është raportuar të MKPT të IAP, sipas PSV-ve të DShB.<br>MKPT i IAP ka bërë tri (3) inspektime të finalizuara me Raporte përfundimtare.<br>1. Vizita e parë me 19.04.2022 në Dubravë me një Rekomandim;<br>2. Vizita e dytë me 22.07.2022 në Lipjan me asnjë Rekomandim;<br>3. Vizita e trete në Pejë, me 21.11.2022 me asnjë Rekomandim për DShB.<br><br>Nga këto Raporte, kemi pasur një rekomandim, për asgjësimin e barërave me afat të skaduar. Këtë rekomandim e kemi futur në planin e prokurimit, kemi emëruar komisionin për specifika, kemi paraparë buxhet adekuat dhe planifikohet që të shpallet tenderi për asgjësim në mars të këtij viti. Nuk ka pasur të tjera rekomandime për DShB gjatë vitit 2022.<br>Me datë 10.03.2022 kemi marrë një shkresë ex officio për tu përgjigjur për një çështje dhe kemi kthyer përgjigjen e kërkuar më datë 15.03.2022.<br><br>Numri i rekomandimeve të adresuara te institucionet kompetente<br><br>Një Rekomandim i adresuar<br><br>Numri i rekomandimeve të zbatuara nga institucionet të cilave u janë adresuar rekomandimet<br><br>Një Rekomandim i adresuar dhe në proces të zbatimit gjatë vitit 2023 dhe i paraparë të zbatohet me kontratë për tri vite. |
| II.1.9 | Monitorimi në mënyrë sistemnatike i mbrojtjes, respektimit dhe zbatimit të drejtave të njeriut në qendrat e mbajtjes për të huajt, Qendra e | Në vazhdi mësi | Buxheti i Kosovës | IAP/<br>MKKT<br>MPBAP<br>QKRMT<br>Organizata t Ndërkomb ëtare | Numri i vizitave të realizuara<br><br>Raportet mbi monitorimin e situatës në qendrat e mbajtjes për të huajt të | Gjatë vitit 2021, MKP-së e ka vizituar **3 herë** Qendrën për Azilkërkues në Magurë, **2 herë** Qendrën për Azilkërkues në Vranidoll, **1 herë** Qendrën për Azilkërkues në Mitrovicë, [2] dhe **1 herë e** ka vizituar Qendrën e Mbajtjes për të Huaj në Vranidoll.<br><br>Të gjithë azilkërkuesit janë shprehur në favor të një trajtimi shumë të mirë dhe human nga zyrtarët e MPB dhe nga Policia e Kosovës. Përveç kësaj, MKP-ja ka vërejtur komunikim shumë miqësor dhe interaktiv ndërmjet azilkërkuesve dhe zyrtarëve policorë dhe atyre të MPB. Për më tepër, gjeni |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | Azilit në Magure dhe Vranidoll, kushtet e të cilave duhet domosdoshmërisht të monitorohen ngase mund të afektojnë të drejtat bazike të personave te akomoduar në ato qendra. | | | | hartuara dhe të qasshme | raportin e publikuar për Qendrat për Azilkërkues, i publikuar më 23 shkurt 2021[3] dhe Raportin për Qendrën e Mbajtjes për të Huaj në Vranidoll, i publikuar më 13 prill 2021[4].<br><br>Ekipi i MKP-së ka realizuar **2 vizita** në Qendrën e Azilkërkuesve në Magure, 1 vizitë në Qendrën për Azilkërkues në Vranidoll, 1 vizitë në Qendrën e Përkohëshme të Pritjes për Migrant dhe 2 vizita në Qendrën e Mbajtës për të Huaj në Vranidoll.<br><br>Të gjithë azilkërkuesit janë shprehur në favor të një trajtimi shumë të mirë dhe human nga zyrtarët e Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe nga Policia e Kosovës. Gjatë vitit 2022<br><br>Avokati i Popullit lidhur me vizitën e MKP-së në Qendrën e Mbajtjes për të Huaj ka publikuar raport me rekomandim më 25 korrik 2022.[5] |
| II.1.10 | Ngritja e kapaciteteve të gjyqtarëve dhe prokurorëve në trajtimin e rasteve kur në procedurë penale përfshihen kryerësit me çrregullime mendore.<br><br>Ngritja e kapaciteteve të gjyqtarëve dhe prokuroreve në trajtimin e rasteve te dhunës në baza | 2021-2023 | Buxheti i Kosovës | Akademia e Drejtësisë KGJK KPK | Numri i trajnimeve të mbajtura;<br><br>Të paktën 60 –të gjyqtarë dhe prokurorë të trajnuar,<br><br>Trajtimi i barabartë dhe pa diskriminim i personave me çrregullime mendore, në funksion të respektimit të integritetit | Këshilli Gjygjësor i Kosovës dhe Akademia e Drejtësisë **;**Janë mbajt 2 trajnime per procedurën penale ku përfshihen kryesit me çrregullime mendore:<br>02.03.2021-kanë marrë pjesë 44 gjyqtarë dhe 34 prokurorë<br>10.11.2021-kanë marrë pjesë 37 gjyqtarë dhe 22 prokurorë<br>Totali i gjyqtarëve dhe prokurorëve të trajunuar janë 81 gjyqtarë dhe 56 prokurorë<br>4 trajnime si dhe 1 Trajnim i Trajnuesve **për dhunën në familje**<br>11.02.2021<br>Kanë marrë pjesë 36 gjyqtare dhe 15 prokurore<br>01.06.2021 kanë marrë pjesë 55 gjyqtarë dhe 4 prokurorë<br>07-08.09.2021<br>Kanë marrë pjesë 45 gjyqtarë dhe 6 prokurorë<br>27-28.10.2021- kanë marrë pjesë 6 gjyqtarë dhe 3 prokuror<br>18-20.05.2021 kanë marrë pjesë 10 trajnues ( 5 nga radhët e gjyqtarëve dhe 5 nga radhët e prokurorëve |

[3] https://oik-rks.org/2021/02/23/raport-i-mekanizmit-kombetar-per-parandalimin-e-tortures-per-vizitat-ne-qendrat-e-azilkerkuesve/
[4] https://oik-rks.org/2021/04/29/raport-i-mkpt-per-viziten-ne-qendren-e-mbajtjes-per-te-huajt-ne-vranidoll/
[5] Shih Raportin e Avokatit të Popullit për Qendrën e Mbajtjes për të Huaj në Vranidoll, https://oik-rks.org/2022/07/26/raport-i-mkpt-se-per-viziten-ne-qendren-e-mbajtjes-per-te-huaj-ne-vranidoll/

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | gjinore, dhunës në familje dhe ngacmimit seksual me një qasje të përqendruar nga viktima; | | | | fizik dhe dinjitetit njerëzor | |
| II.1.1 1 | Nga menaxhmenti i burgjeve, të merren masa për të rritur besimin e të burgosurve në sistemin e ankesave, si dhe për të siguruar dhe garantuar qëndrueshmërinë e sistemit të ankesave . | 2021-2023 | Buxheti i Kosovës | SHKK / MD Inspektorat i i MD për SHKK | Trajtimi i ankesave të të burgosurve bëhet mbrenda afatit kohor duke ruajtur kofidencialintetin dhe siguruar qëndrueshmërinë e sistemit të ankesave<br><br>Numri i ankesave të pranuara dhe shqyrtuara, të ndara sipas gjinise;<br><br>Monitorimi i punës së menaxhmentit brenda burxheve, dhe raportimi në gjetjet; | Numri i ankesave në nivel të SHKK-së (Shkalla e parë dhe e dytë) që janë shqyrtuar gjatë vitit 2021 si dhe deri në muajin gusht 2022 është:<br>144 ankesa nga të burosurit meshkuj madhorë, 9 ankesa nga të miturit dhe 7 ankesa nga të burgosurat femra. |
| II.1.1 2 | Të sigurohen dhe zhvillohen aktivitete kulturore, sportive | Në vazhdi mësi | Buxheti i Kosovës | SHKK/MD OJQ dhe Qendrat per pune | Janë zhvilluar programet dhe aktivitete kultorore, | Aktivitetete kulturore, sportive, programe të rehabilitimit dhe risocializimit të realizuara gjatë vitit 2021 dhe 2022 janë 27 në total. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | dhe programe për rehabilitim dhe risocializimin e të burgosurve | | | sociale Komunat Drejtorit e Arsimit | sportive për rehabilitim dhe risocializim të të burgosurve<br><br>Numri i aktiviteteve të realizuara | |
| II.1.13 | Institucionet kompetente të nxjerrin të gjitha aktet nënligjore të nevojshme për zbatimin e ligjit për shëndetin mendor dhe për të siguruar që vendosja dhe trajtimi i personave me aftësi të kufizuara mendore të jetë në përputhje me atë ligj dhe standardet ndërkombëtare. | 2021-2022 | Buxheti i Kosovës | MSH SHKK/MD Departamenti për Shëndetësi në në burgje | Janë hartuar aktet nënligjore për zbatimin e Ligjit Nr.05/L-025 për shëndetin mendor Është bërë vendosja dhe trajtimi i personave me aftësi të kufizuara mendore në përputhje me ligjin dhe standardet ndërkombëtare. | Janë miratuar aktet si në vijim: Udhëzuesi për menaxhimin e të burgosurve me çrregullime mendore (19.08.2022) . Me qëllimin e avancimit të menaxhimit sa më efikas të të burgosurve me çrregullime të shëndetit mendor, Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues, , ka miratuar Udhëzuesin për Menaxhimin e të Burgosurve me Çrregullime të Shëndetit Mendore gjatë mbajtjes në institucionet korrektuese.<br><br>Me këtë udhëzues përcaktohen dhe sqarohen disa nga procedurat e menaxhimit të të burgosurve me çrregullime të shëndetit mendor. si dhe Rregulla e brendshme për procedurat dhe masat e sigurisë për mbrojtjen e të dhënave personale (19.05.2022).<br>Gjithashtu është hartuar-Koncept dokumenti për shëndet mendore<br>Është aprovuar Plani i Veprimit për shëndetë mendore gjatë dhe pas pandemis COVID 19/ në 2021;<br>Është aprovue Udhërrëfyesi klinik ‘’ trajtimi i alkoolit dhe drogave tjera;<br>Udhërrefyesi Klinik trajtimi i sjelljeve suicidale;<br>Udhërrefyesi Klinik , trajtimi i depresionit;<br>Udhërrefyesi trajtimi i ankthit;<br>Udhezuesi për intervenime promovuese dhe parandaluese në fushën e shëndetit mendore të adoloshenteve. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| II.1.1 4 | Të organizohen programe sistematike të trajnimit në protokollin e Stambollit për të gjithë **profesionistët shëndetësorë** që mund të thirren për të ekzaminuar personat e privuar nga liria, në mënyrë që të forcojnë të kuptuarit e tyre potencial dhe kufizime të ekzaminimit mjekësor në identifikimin, interpretimin dhe dokumentimin e shenjave të torturës dhe formave të tjera të trajtimit të keq | 2021-2023 | Buxheti i Kosovës Donatorët | **MSH**<br>AD<br>MD<br>KGJK<br>KPK<br>PK<br>Oda e Avokatëve të Kosovës<br>Departamenti për Shëndetësi në në burgje (DSHB) | Numri i trajnimeve të mbajtura dhe zyrtarëve të trajnuar<br><br>Të paktën tre sesione informuese të mbajtuara<br><br>Të paktën 60-të profesionist shëndetsorë të trajnuar | Departamenti Shëndetësor i Burgjeve që nga 2017 ka aprovu PSV-të hamonizuara me KE.<br><br>Në PSV të DSHB janë të integruar parimet e Protokolit të Stambollit, për shëndetësi në burgje, sipas rekomandimeve të eksperteve të KE.<br><br>Që nga 2017 çdo, vit përfshirë edhe 2021 DSHB organizon trajnime me komplet stafit, 125 në total, në zbatimin e PSV - përkatësishtë parimeve të Protokolit të Stambollit.<br><br>2022 për shkak të mungeses se mbështetjes me fonde DSHB nuk ka organizuar trajnim. |
| II.1.1 5 | Të organizohen programe sistematike të trajnimit në protokollin e Stambollit për **avokatët, prokurorët dhe gjyqtarët**, të cilët mund të përfshihen në çështje gjyqësore | Në vazhdi mësi | Buxheti i Kosovës Donatorët | MSH<br>AD<br>KGJK<br>KPK<br>PK<br>Oda e Avokatëve të Kosovës<br>Departamenti për Shëndetësi në në | Numri i trajnimeve të mbajtura dhe zyrtarëve të trajnuar<br><br>Të paktën tre sesione informuese të mbajtuara<br><br>Të paktën 60- | Në trajnimin e datës 15-16 shkurt 2022 - Programi i Specializuar i Trajnimit për dhunën në Familje , është trajtuar edhe Konventa e Stambollit. Këtë trajnim e kanë vijuar 50 gjyqtarë dhe 17 prokuror.<br><br>Të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët pjesëmarrës kanë qenë të shkallës së parë me përjshtim të një (1) prokurori që ka qenë nga Zyra e Prokurorit të Shetit dhe dy (2) gjyqtarëve që ishin nga niveli i Apelit.<br><br>Përveq kësaj, gjatë ditëve të aktivizimit në mbrojtje kundër dhunës në Familje dhe dhunës ndaj grave janë realizuar edhe ; |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | përkatëse, në mënyrë që të forcojnë të kuptuarit e tyre potencial dhe kufizime të ekzaminimit mjekësor në identifikimin, interpretimin dhe dokumentimin e shenjave të torturës dhe formave të tjera të trajtimit të keq | | | burgje | të profesionist të drejtësisë të trajnuar | Tri aktivitete trajnuese me temë: Konventa e Stambollit ( bashkangjitur, agjenda e njejtë për tri aktivitetet) : Forcimi i zbatimit në përfundim të dhunës ndaj grave, dhunës në familje dhe dhunës në baza gjinore. Kjo tematikë është mbështetur nga Qendra Kosovare për Sudime gjinore dhe gjithësejt kanë qenë tri aktivitete trajnuese ku përveq gjyqtarë dhe prokurorë kanë qenë të ftuar edhe profesionistë tjerë ligjor. ( 2 gjyqtarë, 1 prokurorë, 23 bashkëpunëtorë professional dhe zyrtarë ligjor nga gjykatat dhe prokuroritë si dhe 9 pjesëtarë tjerë nga radhët e Policisë së Kosovës dhe Agjencia per ndihmë juridike falas. |
| **II.2** | **Objektivi specifik: Parandalimi, mbrojtja dhe luftimi i diskriminimit** Progresi në zbatim | | | | | |
| II.2.1 | Organizimi i fushatave, tryezave, debateve dhe aktiviteteve tjera promovuese për pakon e ligjeve për të drejtat e njeriut | 2021-2023 | Buxheti Donatorët | ZKM/ ZQM ZL/ZKM ABGJ Ministrit Komunat IAP ZBEK OSBE OJQ-të | Projekte të përshtatura enkas për të promovuar legjislacionin kundër-diskriminimit të zbatuara<br><br>Numri i fushatave dhe tryezave, debateve të organizuara në nivel vendi | Me qëllim të informimit të personave të verbër lidhur me të drejtat të cilat ua garanton pakoja e ligjeve për të drejtat e njeriut,Zyra për qeverisje të mirë ka shtypur dhe publikuar në shkrimin braill; Ligji nr. 05/l -021 për mbrojtjen nga diskriminimi<br>Ligji nr. 05/l-020 për barazi gjinore<br>Ligji nr. 05/l-019 për avokatin e popullit<br>ABGJ ka realizuar video clipin :Parandalimi dhe mbrojtja ndaj diskriminimit “me fokus eliminimin e dhunës ndaj kominitetit LGBTI+ në vlere totale 1.240 euro,i transmetuar në RTK.<br><br>MBPZHR,me qëllim të avancimit të grave në bujqësi rritjes së pjesëmarrj dhe integrimin e grave dhe vajzave të të gjitha komuniteteve në zonat rurale të gjitha proceset janë mbajtur gjashtë takime, tryeza punuese në gjash regjionet e Kosovës, - fokusi ka qenë në Promovimin e Ligjit NR. 05/L -0 për mbrojtjen nga diskriminimi dhe për pakon e ligjeve për të drejtat e njeriut.<br><br>Në 2021 MASHTI ka realizuar aktivitete sensibilizuese kundër trafikimit, dhunës, braktisjes, si dhe prononcime mediatike, trajnime e sesione ku janë promovuar politikat kundër diskriminimit dhe makanizmat për të drejtat e njeriut ( Trajnimet me mësimdhënës të komunave: Fushë Kosovë, |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | Prishtinë, Pejë, Klinë, Istog, 5 emisione televizive, 2 prononcime për radio dhe përgjigje të shumta me shkrim për gazeta të ndryshme. Edhe në 2022 kemi vazhduar me sesione, tryeza, prononcime brenda këtyre temave.<br>Në vitin 2022 MASHTI ka realizuar një varg aktivitetesh sensibilizuese e promovuese dhe në secilat prej tyre i është referuar pakos së ligjeve për të drejtat e njeriut ( gjithsej 20 takime, seanca/tryeza promovuese në fushën e të drejtave të njeriut dhe barazisë gjinore, në komunat: Prishtinë, Prizren, Gjilan, Obiliq, Klinë, Pejë, Vushtrri, Mitrovicë, Gjakovë, Fushë Kosovë, Drenas, Deçan, Podujevë, Dragash dhe Kamenicë.<br><br>Gjate vitit 2022 DDQKSH ka mbajtur 7 tryeza diskutimi lidhur me prezantimin e Ligjit për mbrojtje nga diskriminim si dhe të drejtën e ankesës në linjen e ankesave dhe ne linkun linja falas@rks-gov.net jane mbajtur me profesionistet shëndetësorë me shefat e njësive në QKMF me përkrahjen financiare nga projekti i AQH-**së**;<br>Tryezat kanë përfshirë 50 profesionistë shëndetësor të nivelit: udhëheqës i drejtorisë, shefa të njësive në kuadër të QKMF–ve, kryeinfermierë, koordinator i cilësisë , kërkesa e tyre ka qene që të vazhdohet me këtë temë prezantimin në të gjitha Komunat po të mbahet dhe për stafin e mesëm infermierik.<br>Si dhe 30 zyrtare të OJQ -ve dhe qytetare nga komuniteti rom ashkali dhe egjiptas për tu njoftue lidhur me ekzistimin e linjës së ankesave në MSh dhe se munden me paraqite ankese nëse kanë pakënaqesit lidhur me shërbimet shëndetësore në vend në linjen e ankesave 080017777` |
| II.2.2 | Të organizohen aktivitete vetëdijesuese me qëllim të vetëdijesimit , ndërgjegjësimit dhe edukimit të publikut për rëndësinë e raportimit të rasteve të | 2021-2022 | Buxheti Donatorët | ZKM/ ZQM ABGJ Ministrit Komunat IAP ZBEK OSBE OJQ-të Inspektorat i i Punës | # Numri i fushatave ndërgjegjësue se mbi raportimin e diskriminimit dhe bazat e diskriminimit; | Ka pas aktivitete të shumta të organizuara nga institucionet qendrore dhe locale të qeverisjes, shoqëria civiel dhe Institucioni i Avokatit të Popullit.Në pamundesi me i paraqit të gjitha, i kemi përfshi disa aktivitete të vijim:<br>Ministria e Shëndetsisë ka realizur 8 tryeza diskutimi me profesionistët shëndetësore në QKMF, kanë qenë të përfshirë 100 profesioniste shëndetësore, të nivelit udhëheqës institucioni dhe shefa të njësive për zbatimin e ligjit për mbrojtje nga diskrimimi dhe linjen e ankesave për qyetarët.<br>**Ministria e Mbrojtjes:** Në të gjitha kazermat (7 kazerma) e FSK, përmes prezantimeve është promovuar pakoja ligjore për të drejtat e njeriut me |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | diskriminimit se si të paraqesin siç duhet ankesën mbi bazat e diskriminimit, dhe si të raportojnë në mënyrë adekuate diskriminimin | | | | | qëllim të promovimit të legjislacionit për mbrojtje nga diskriminimi.<br>**MBPZH**- Në takimet në gjashtë regjione është bërë vetëdijesimi, ndërgjegjësimit dhe edukimi i publikut për rëndësinë e raportimit të rasteve të diskriminimit se si të paraqesin siç duhet ankesën mbi bazat e diskriminimit; NjDNJ&MD në koordinim me OJQ Eco-Kosova Women, Hanikosin, PePeCo, Caritas-in ka zhvilluar aktivitete për fuqizimin e grave në zonat e thella rurale, vajzave, si dhe personat me aftësi të kufizuara.<br><br>Përgatitja dhe shpërndarja e fletpalosjeve tek qytetarët dhe bashkëbisedimi me ta.<br>Sa i përket takimeve, trajnimeve, fushatave ndërgjegjësuese në mbrojtje nga diskriminimi janë 18 komuna të cilat kanë raportuar: Lipjan, Ferizaj, Gjakovë, Gjilan, Gllogoc, Kamenicë, Malishevë, Mitrovica e Jugut, Novobërdë, Obiliq, Podujevë, Prishtinë, Prizren, Pejë, Shtime, Skenderaj, Vushtrri dhe Gracanicë, ndërsa, komunat tjera janë arsyetuar për vështirësitë që ka krijuar pandemia COVID-19 në pamundësi të organizimeve të aktiviteteve në këtë fushë.<br>Viti 2022 janar –qershor , Komunat kanë vazhduar aktivitetet e tyre në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, ku në 23 komuna janë zhvilluar aktivitete për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut si: Fushata vetëdijësuese për promovimin e Ligjit për Barazi Gjinore dhe Ligjit kundër diskriminimit, ndërgjegjësimi i qytetarëve për të drejtat e tyre dhe qasje në shërbime, koordinimi i punës së Mekanizmit Koordinues Komunal Kundër Dhunës në Familje, vizita dhe ligjërata në shkolla dhe në viset rurale, organizim i tryezave të rrumbullakëta, bashkëpunimi i organizatave ndërkombëtare dhe vendore për Barazinë Gjinore etj. Në 11 komuna (Klinë, Mitrovicë Jugore, Istog, Fushë Kosovë, Skenderaj, Gjakovë, Kaçanik, Malishevë, Obiliq, Vushtrri, Ranillug) janë ndarë mjete buxhetore me shumë prej **62,811.00 euro** për zhvillimin e aktiviteteve në fushën e të drejtave të njeriut ndërsa në komunat të tjera është raportuar që buxhet të veçant komuna nuk ka ndarë.<br>**Institucioni i Avokatit të Popullit**-më 1 mars 2022 ka hapur fushata *“Barazi për të gjithë’’*. Gjatë fushatës janë mbajtur 11 tryeza të diskutimit me përfaqësues të shoqërisë civile, aktivistë të të drejtave të njeriut dhe përfaqësues të institucioneve publike lokale. Qëllimi i këtyre tryezave ka qenë: rritja e ndërgjegjësimit të publikut për të drejtat e njeriut dhe liritë themelore; informim mbi rolin dhe mandatin e IAP-së; fuqizimi i bashkëpunimit të qytetarëve me institucionet publike dhe identifikimi i problemeve që reflektojnë në të drejtat e njeriut. Fushata ka pasur karakter |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | gjithëpërfshirës, e cila është shtrirë në 11 komuna të ndryshme të Kosovës, duke përfshirë edhe komunat e banuara nga qytetarët e komuniteteve joshumicë dhe atë në Prishtinë, Prizren, Pejë, Gjilan, Ferizaj, Mitrovicë, Gjakovë (dy tryeza), Graçanicë, Kamenicë dhe Suharekë. Një nga këto tryezat është dedikuar veçanërisht për të takuar dhe diskutuar për sfidat dhe problemet me të cilat jetojnë qytetarët e komuniteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian. E poashtu, një tryezë e veçantë është dedikuar për të diskutuar për të drejtat, sfidat dhe vështirësitë me të cilët ballafaqohen personat me nevoja të veçanta në vend. |
| II.2.3 | Promovimi i Politikës kundër Ngacmimit Seksual në organet e administratës publike | 2021-2022 | Buxhet i Kosovës<br>Donatorët<br>BE<br>KE | ZKM/ ZQM<br>ABGJ<br>Ministrit<br>Komunat<br>IAP<br>Qendra Kosovare për Studime Gjinore<br>UN Women Zyra në Kosovë | Numri i fushatave dhe aktiviteteve promovuese të zbatuara | Me qëllim të zbatimit të Politikës kundër ngacmimit seksual në organet e administratës publike të Republikës së Kosovës ,gjatë vitit 2022, ZKM/ZQM me përkrahjen e OSBE – Misioni në Kosovë, ka organizuar gjithsej 5 sesione informuese mbi këtë politikë. Këto sesione informuese janë organizuar në Prishtinë, Mitrovicë, Prizren, Pejë dhe Gjilan. Në këto punëtori kanë marrë pjesë përfaqësues nga shumica dërrmuese e institucioneve komunale të Republikës së Kosovës. Qëllimi i sesioneve informues ishte informimi lidhur me Politikën kundër ngacmimit seksual në organet e administratës publike si dhe veprimet që duhet ndërmarr në parandalim dhe luftim të ngacmimit seksual në organet e administratës publike. Targeti kryesore ishin zyrtarët për mbrojte nga diskriminim, zyrtarët për të drejtat njeriut dhe çështje gjinore ,zyrtarët ligjorë, sektori i personalit në komuna, zyrtarë për integrime si dhe departamentet tjera relevante sikur ai për mërqinjë sociale dhe shëndetësi në nivel lokal të qeverisjes.<br><br>Gjatë vitit 2021, MASHTI së bashku me OSBE ka organizuar 5 sesione informuese me nxënës, ku tema kyçe ishte “Parandalimi i dhunës seksuale në shkollë”. Sesionet janë mbajtur në komunat: Gjakovë, Obiliq, Gjilan, Kamenicë, Viti.<br>MASHTI gjatë vitit 2022 ka realizuar aktivitete promoviese si sesione informuese dy ditore me nxënës të komunave të Gjilanit, Ferizajt, Prishtinës rreth masave identifikuese , parandaluese të ngacmimeve seksuale brenda shkollave dhe parandalimit të ndaj portretizimit negativ dhe seksist të imazhit të grave dhe vajzave në fusha të ndryshme të jetës. Njëkohësisht janë prezantuar edhe doracakët për mësimdhënës të hartuar nga MASHTI "Edukimi seksual dhe shëndeti riprodhues" për klasat 1-5, 6-9, 10-12 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | Numri i rasteve të denocuara për ngacmim seksual | Nuk ka raste të paraqitura dhe të raportuara për ngacmime seksuale. |
| II.2.4 | Parandalimi i diskriminimit në aspektin e përdorimit të gjuhëve përmes aktiviteteve promovuese si dhe për të siguruar mbrojtjen, ruajtjen dhe promovimin e gjuhëve të komuniteteve, gjuha amtare e të cilave nuk është gjuhë zyrtare. | 2021-2023 | Buxheti Donatorët | Zyra për çështje të komunitete ve<br>Zyra e Komisione rit për Gjuhët | Numri i projekteve të mbështetura për promovimin e të drejtave gjuhësore dhe zhvillimin e diversitetit gjuhësor | Zyra e Komisionerit për gjuhët, gjatë vitit 2022 ka bërë dy Thirrje publike dhe përmes këtyre thirrjeve ka ndarë njëqindmijë (100.000) euro, për mbështetje të OJQ-ve që promovojnë gjuhët zyrtare dhe gjuhët e komuniteve që jetojnë në Kosovë. Kanë përfituar 14 OJQ- shtatë (7) nga Thirrja e parë dhe e shtatë(7) nga Thirrja e dytë.<br>• Zyra ka mbështetë dhe ka marrë pjesë në promovimin e gjuhës rome si gjuhë në përdorim zyrtar në Komunën e Prizrenit dhe ka dhënë opinion MAPL, sipas kërkesës së këtij institucioni, për ligjshmërinë e vendimit të Komunës së Prizrenit;<br>• Zyra ka ndarë çmimin “Praktikat më të mira për zbatimin e Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve”, për tri institucione të nivelit qendror; |
| II.2.5 | Parandalimi dhe eliminimi i paragjykimeve dhe gjuhës diskriminuese në përmbajtjen e teksteve shkollore në të gjitha nivelet e arsimit para universitar | 2021-2023 | Buxheti i Kosovës Buxheti i procesit të zhvillimit të teksteve të reja | MASHTI Këshilli i ekspertëve të programev e të teksteve shkollore ABGJ ZKM/ZQ M | Këshilli i ekspertëve të programeve të teksteve shkollore siguron zbatimin e Standardeve për tekste shkollore si dhe eliminimin e elementeve (gjuhës) diskriminuese në tekstet shkollore; | Gjatë vitit 2021, MASHTI ka realizuar 5 sesione informuese me mësimdhënësit e komunave: Obiliq, Skenderaj, Pejë, Prizren, Ferizaj, tema e së cilave ishte “ parandalimi i steriotipeve gjinore në tekstet shkollore” në këtë sesion ishin të pranishëm mësimdhënës të lëndëve: edukatë qytetare, gjuhë shqipe, sociologji dhe psikologji,<br>Janë mbajtuar edhe seanca informuese me 190 recensentët për vlerësimin e dorëshkrimeve për tekstete e reja shkollore 3,8,12, ku një prej pikave të sesionit informues ka qenë edhe respektimi i barazisë gjinore në tekstet e reja shkollore.<br>Duke qenë se tekstet shkollore dhe materialet mësimore duhet të jenë në përputhshmëri me legjislacionin në fuqi dhe dokumentet e mëposhtme:<br><br>1. Ligjin për botimin e teksteve shkollore, mjeteve mësimore, lektyrës shkollore dhe të dokumentacionit pedagogjik https://masht.rks-gov.net/uploads/2015/06/8-lbtmldp-2008-03-l048.pdf<br>2. Kornizën Kurrikulare të Kosovës, http://masht.rks-gov.net/uploads/2017/03/korniza-kurrikulare-finale.pdf<br>3. Kurrikulat Bërthamë:<br>3.1. Për klasën përgatitore dhe arsimin fillor, http://masht.rks- |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | gov.net/uploads/2017/03/kurrikula-bërthamë-1-finale-2.pdf;<br>3.2. Për arsimin e mesëm të ulët: http://masht.rks-gov.net/uploads/2017/03/korniza-bërthamë-2-final.pdf; si dhe<br><br>4. Udhëzimin administrativ nr. 5/2011, Zbatimi i standardeve për tekste shkollore https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=8050 , MASHTI është kujdesur që bredna këtaj kornize ta zhvillojë procesin e hartimit të teksteve të reja gjatë vitit 2022. U janë dhënë udhëzimet dhe formatet e qarta recensnetëve për vlerësimin e dorëshkrimeve, duke sunuar tekste cilësore, por cilësia e tyre varet nga cilësia e autorëve dhe recensnetëve. ( MASHTI vetëm adminsitron procesin në përputhje të legjislacionit në fuqi).<br><br>Tani pas nxjerrjes së testve të reja shkollore, pra brenda vitit 2022, Institucioni i Avokatit të Popullit ka filluar hulumtimin e teksteteve të reja në lidhje me diskimimin, gjuhën e urrejtjes dhe aspekte tjera shoqërore. MASHTI ka bashkëpunuar me IAP, e ka lehtësuar qasjen në tekstet e reja dhe e presim raportin me rekomandime. MASHTI do të vazhdojë me proces të vlerësimit të cilësisë së teksteve në vazhdim duke marrë vlerësimet nga terreni/ shkollat dhe sipas rezultateve do ta orintojë tutje qoftë përmirësimin e x teksteve të caktuara apo nxjerrjen e x teksteve të reja ( pra varësisht nga vëretjet për to). |
| II.2.6 | Aktivitete me shkolla në parandalim të diskriminimit në kontekst të shkollës (parandalim të gjuhës së urrejtjes, dhunës dhe braktisjes së shkollimit) | 2021-2023 | Buxheti i Kosovës/ donatorët<br><br>5000 për vit | MASHTI Këshilli i prindërve Këshilli i nxënësve DKA Shkollat | Numri i aktiviteteve të mbajtura.<br><br>Numri i nxënësve të përfshirë dhe të cilët kanë përfituar nga këto aktivitete, i ndare sipas gjinisë. | MASHTI ka realizuar aktivitete të shumta si:<br><br>• 2 Punëtori me inspektoratin e arsimit për zbatimin e politikave për mbrojtjen e fëmijëve, dhunës në shkolla dhe parandalimit të braktisjes së shkollimit;<br>• 3 Sesione me ekipet komunale dhe shkollore për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes të komunave Gjakovë, Mitrivicë, Pejë, Prishtinë dhe F.Kosovë;<br>• Paraqitja në emisione televizime me temë për dhunën në shkolla, mbrojtje të fëmijëve.<br>• Konferenca ndërkombëtare për Shëndetin, Mirëqenien, edukimin dhe të drejtat e fëmijëvenë kuadër të 1 Qershorit-Ditës ndërkombëtare të fëmijëve;<br>• U realizua shënimi i 12 qershorit-Ditës ndërkombëtare kundër punës s ë fëmijëve, sipas zotimit dhe planifikimit. U mbajt ora mësimore në të gjitha shkollat dhe u realizua webinari ndërinstitucional;<br>• Njëkohësisht u realizuan edhe sesionet me ekipet komunale dhe shkollore për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes ku përfituan komunat: Gjakovë, |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | Mitrivicë, Pejë, Prishtinë dhe F.Kosovë.<br><br>Në vazhdim  në 2022 u themelua Forumi nacional për shkollat miqësore, ku me theks adresohen çështjet e sigurisë dhe mbrojtjes së fëmijëve nga dhuna dhe abuzimi. Gjithashtu u zhvilluar ingomgrafet për zbatimin e Protokollit 21/3013 për parandalim dhe refereim të dhunës në IAP. Inforgafet u hartuan dhe u printuan në katër gjuhë: shqipe, serbe, boshnjake dhe turke.<br>Në vazhdim janë duke u realizuar punëtoritë për rishikimin e dracakëve për funksionimin e ekipeve shkollore dhe komunale për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes së shkollimit dhe pritet të realizohen aktivitete të larmishme në shënim të javës kundër braktisjes, përfshirë shpërblimin e rregullt të shkollave që raportojnë dhunën dhe braktisjen e shkollimit.<br>Gjatë vitit 2022 janë realizuar një varg aktivitete vetëdijësuese, si në vijim:<br>• Janë zhvilluar infografet për zbatimin e protokollit 21/2013 për parandalim dhe referim të dhunës në shkolla (me përkrahje nga Save the Children/ Syri i Vizionit);<br>• Është realizuar fushata e senzibilizimit për zbatimin e Protokollit 21/2013 (Janë shpërndarë në DKA infografet/ posterët që tregojnë sistemin e parandalimit, identifikimit, trajtimit dhe raportimit të dhunës dhe janë mbajtur aktivitete/ tryeza diskutimi në shkolla);<br>• Janë realizuar një mori takimesh në rajone (6 tryeza në komunat: Klinë, Prizren, Pejë, Gjilan, Ferizaj dhe Prishtinë) ku janë diskutuar aspektet braktisjes dhe të dhunës në shkolla, përgjithësisht konteksti i mbrojtjes së fëmijës;<br>• Janë realizuar seancat me nxënës në kundër të Muajit antitrafikim- si fushatë e përvjetshme nacionale (me ç`rast edhe janë shpërndarë materiale sensibilizuese). Seancat janë mbajtur në bashkëpunim me Policinë e Kosovës në komunat: prishtinë, Drenas, Fushë Kosovë, Deçan.<br>• Me vendim të ministres në çdo shkollë është mbajtuar ora e pare mësimore në hapje të 16 ditëve të aktivizmit kundër dhunës në familje si dhe seanca me nxënës në Kamenicë, Gjilan dhe Prishtinë. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | • Janë bërë edhe promovimi i të drejtave të fëmijëve dhe politikave të mbrojtjes përmes prononcimit dhe dhe pjesëmarrjes në emisione televizive për aspektet e dhunës në shkolla, mbrojtjen e fëmijëve dhe braktisjen e shkollimit (5emisione televizive, 2 prononcime për radio dhe 5 përgjigje me shkrim për gazeta të ndryshme).<br><br>Në Komunën e Prishtinës janë realizuar 10 aktivitete lidhur me " **parandalim të diskriminimit në kontekst të shkollës** (parandalim të gjuhës së urrejtjes, dhunës dhe braktisjes së shkollimit)" nga të cilët kanë perfituar mbi 700 nxenes 400 vajza -300 djem.<br>Në Komunën e Lipjanit Aktivitete " parandalim të diskriminimit në kontekst të shkollës (parandalim të gjuhës së urrejtjes, dhunës dhe braktisjes së shkollimit)" nga te cilet kane perfituar mbi 500 nxenes 300 vajza 200 djem<br>Në Komunën e Kamenicës Aktivitete me shkolla në parandalim të diskriminimit në kontekst të shkollës (parandalim të gjuhës së urrejtjes, dhunës dhe braktisjes së shkollimit).NJKDNJ ka organizuar javën kundër brakisjes së shkollimit ku Koordinatorja e NJKDNJ-së ka përgatitë dhe shpërndar broshura me informacione tek qytetarët e grupmoshave të ndryshme e në veçanti tek nxënësit duke bashkëbiseduar me ta. |
| II.2.7 | Parandalimi i diskriminimit mbi bazat e përcaktuara me Ligjin për mbrojtjen nga Diskriminimi përmes monitorimit të procesit gjatë shpalljes së konkurseve për pozita të lira qoftë në sektorin publik apo privat | 2021-2023 | Buxheti i Kosovës | MPBAP Ministrit(Zyrat e burimeve njerëzore, Zyrtarët për mbrojtjen nga Diskriminimi) Komunat (Zyrat e burimeve njerëzore, Zyrtarët | Konkurset për pozita të lira qoftë në sektorin publik apo privat pa elemente diskriminuese dhe përjashtuese;<br><br>Numri i konkurseve të monitoruara;<br><br>Numri i | Institucionet në nivel qendror dhe lokal të qeverisjes janë duke ofruar mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës dhe mirëpresin aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.<br><br>Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre, gjinia më pak e përfaqësuar dhe personat me aftësi të kufizuara inkurajohet të aplikojë për pozitat e shpallura.<br><br>Çdo konkurs për pozita të ndryshme hartohen dhe publikohen në dy gjuhë zyrtare siç është paraparë në Ligjin Nr. 02/l-37 për përdorimin e gjuhëve. Komisionet e vlerësimit krijohen duke respektuar barazin gjinore. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | për mbrojtjen nga Diskriminimi) Institucioni i Avokatit të Popullit ABGJ ZKM/ ZQM OJQ-të | sanksioneve apo masave diciplinore të shqiptuara në kuadër të institucioneve përkatese, për trajtim diskriminuese përmes konkurseve;<br><br>Numri i politikave të miratuara në sektorin publik dhe privat për të parandaluar diskriminimin, sidomos diskriminimin në punësim dhe ngacmimin seksual; | Qeveria ka aprovuar Politkën kundër ngacmimit seksual ne organet e adminstrateës publike, gjithashtu është hartuar Udhëzuesi për zbatimin e e saj. |
| II.2.8 | Hulumtime mbi përceptimin e qytetarëve lidhur me diskriminimin në vendin e punës ose në tregun e punës në Kosovë | 2021 | Financimi i donatorëve | ZKM/ ZQM ABGJ Ministrit Komunat OSBE ZBEK UNDP | Hulumtimi pasqyron parametrat aktual të vetëdijes ,përjetimeve dhe njohurive të qytetarëve mbi diskriminimin si dhe | Hulumtimi , paraqet rezultatet e studimit të kryer për vlerësimin e perceptimeve të qytetarëve lidhur me diskriminimin në vendin e punës në Republikën e Kosovës.<br>Ai synon të paraqesë një masë të nivelit aktual të diskriminimit në Kosovë, me fokus në diskriminimin në vendin e punës ndaj grupeve më të margjinalizuara dhe të rrezikuara, përfshirë, por jo vetëm, gratë, minoritetet, të rinjtë dhe personat LGBTI.<br>Ky publikim është hartuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | legjislacion që e rregullon fushën e mbrojtjes nga diskriminimi. | |
| II.2.9 | Hulumtime mbi përceptimin e shërbyesve civilë lidhur me diskriminimin në vendin<br>e punës ose në tregun e punës në Kosovë | 2021 | Financimi i donatorëve | ZKM/ ZQM<br>ABGJ<br>Ministrit<br>Komunat<br>OJQ-të<br>OSBE<br>ZBEK<br>UNDP | Hulumtimi pasqyron parametrat aktual të vetëdijes, përjetimeve dhe njohurive të nëpunësve civil mbi diskriminimin, mekanizmat referues si dhe legjislacion që e rregullon fushën e mbrojtjes nga diskriminimi. | Vlerësimi i perceptimeve lidhur me diskriminimin në vendin e punës është diçka aktuale në të gjitha vendet, përfshirë vendet e zhvilluara me korniza gjithëpërfshirëse ligjore dhe mekanizma të zbatimit, monitorimit dhe raportimit. Kjo mundëson ndërmarrjen e masave adekuate parandaluese të cilat, nga ana e tyre përmirësojnë cilësinë dhe produktivitetin në punë, duke ndikuar kështu pozitivisht në kapacitetet e një ekonomie për të siguruar rritje ekonomike gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme.<br>Ky raport paraqet rezultatet e studimit të kryer për vlerësimin e perceptimeve të qytetarëve lidhur me diskriminimin në vendin e punës në Republikën e Kosovës. Ai synon të paraqesë një masë të nivelit aktual të diskriminimit në Kosovë, me fokus në diskriminimin në vendin e punës ndaj grupeve më të margjinalizuara dhe të rrezikuara, përfshirë, por jo vetëm, gratë, minoritetet, të rinjtë dhe personat LGBTI. |
| II.2.10 | Marrja e masave afirmative për përmirësimin e situatës së komuniteteve të margjinalizuara duke përfshi (grat nga zonat e thella rurale, fëmit ,personat me aftësi të kufizuara, komunitetet, të | 2021-2023 | Buxheti i Kosovës<br>Donatorët | Ministrit<br>Komunat<br>ZKM/ZQM<br>ABGJ<br>Agjenisonet e Panvarura<br>OSBE | Numri i masave afirmative të propozuara dhe të zbatuara | Me Vendimin e Kryeministrit nr. 6/81 të datës 01.06.2022 është themelua Ekipi ndërinstitucional për nxitjen dhe promovimin e punësimit për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian.<br>Me qëllim të inkurajimit, promovimit dhe koordinimit të veprimeve dhe aktiviteteve për punësimin e pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Republikën e Kosovës, si dhe me qëllim të avancimit të përfshirjes, pjesëmarrjes dhe barazisë së tyre. Duhet theksuar se themelimi i Ekipit **është masë e përkohshme afirmative** për inkurajimin dhe avancimin si dhe për arritjen e kuotës së punësimit të pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Republikën e Kosovës, siç është përcaktuar në Kushtetutë. në ligjin nr. 06/L - 114 për zyrtarët publikë dhe në legjislacionin përkatës në fuqi në Republikën e Kosovës |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | zhvendosurit etj. | | | | Kategoria e grupeve dhe numri i përfituesve si rezultat i zbatimit të masave afirmative | Me qëllim te rritjes së gëzimit të të drejtave pronësore të grave ABGJ i ka propozuar Qeverise vazhdimin e masës afirmative për regjistrimin e pronës ne emër të dy bashkëshorteve pa pagesë . Masa është vazhduar deri në prill të viti 2023.<br>Me këtë qëllim është realizuar videospoti televiziv “ *Vazhdimi i masës afirmative për regjistrimin e pronës se përbashkët ne emër te te dy bashkëshorteve 2022-2023”* i transmetuar në transmetuesin publik. Linku : Udhëzimit Administrativ për regjistrimin e pronës në emër të dy bashkëshortëve 2022 - YouTube<br><br>Eshte aprovue nga Qeveria me propozim të MSh -UA /QRK) Nr. 11/2022 për Caktimin e Listës, Llojeve dhe Pajisjeve Ndihmëse që Ofrohen Falas për Personat Paraplegjik dhe Tetraplegjik që Sherbejnë për Lëvizje, Parandalim dhe Asistim.<br><br>MBPZHR në kritere të vlerësimit për aplikuese gra për përkrahje publike të grandeve, në Programin për Zhvillimin Rural 2020-2021, ka vlerësuar me **dy pikë** më shumë projektet e grave aplikuese për PZHR 2020-2021.<br><br>Gjithësej 52 gra aplikese kanë qenë përfituese si rezultat i zbatimit të kritereve të përcaktuara afirmative.<br><br>**Muaji prill i cili konsiderohet Muaj i regjistrimit falas të komuniteteve RAE,**<br><br>• Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, gajtë periudhës raportuese kanë nënshkruar Memorandum Bashkëpunimi për mbështetje financiare për studentë të komuniteteve egjiptian, ashkali dhe rom të cilët studiojnë në universitetet publike në Kosovë. Qëllimi i këtij Memorandumi është promovimi i edukimit te këto komunitete, nxitja në zhvillim akademik, krijimi i mundësive që studentët të mos i ndërpresin studimet për shkak të kushteve të vështira materiale, si dhe krijimi i brezave të rinj të mësimdhënësve dhe ligjëruesve nga radhët e komuniteteve, duke përfshirë në mënyrë të barabartë gra dhe burra, ku mund të përmendim si lajm të mirë për mësimdhënësen e parë në komunën e Fushë Kosovës në shkollën ‘Selman Riza’ nga komuniteti |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | egjiptian. |
| II.2.11 | Të sigurohet dëmshpërblim adekuat dhe kompensim të viktimave të diskriminimit në proporcion me dëmin e shkaktuar material dhe jo material | 2021-2023 | Buxheti i Kosovës | KGJK<br>KPK | Numri i viktimave të diskriminimit të kompensuar për dëmin e përjetuar material dhe jo material<br><br>Numri i vendimeve të shqiptuara nga gjykatat | Përdoruesi i karrocës F.K, ka paditur Komunën e Prishtinës për mungesën e infrastrukturës së nevojshme për përdoruesit e karrocës. Pas shqyrtimit të rastit, Me vendim, Gjykata themelore e obligon Komunën e Prishtinës që të kompensojë dëmin e shkaktuar jomaterial në vlerë prej 5,500 euro.<br>“Detyrohet e paditura – Komuna e Prishtinës, që paditësit – F.K, për shkak të diskriminimit nga mosveprimi, mungesa e ofrimit të kushteve fizike në hapësirat publike dhe qasjes në objektet publike për personat me aftësi të kufizuara, t’ia kompensojë dëmin e shkaktuar jomaterial në emër të cenimit të dinjitetit në shumë prej 5,500 euro” – thuhet në vendimin e Gjykatës së Prishtinës. |
| II.2.12 | Zhvillimi i kurrikulës trajnuese për mos diskriminimin e cila doli si rezultat i vlerësimit të nevojave trajnuese për gjyqtarë, prokurorë si dhe zyrtarë tjerë që merren me të drejtat e njeriut. Kjo kurrikulë do të zbatohet për tre vitet në vijim 2021-2023 | 2021-2023 | Buxheti i Kosovës, Bugjeti i Akademisë së Drejtësisë | **Akademia e Drejtësisë**<br>KGJK<br>KPK<br>OSBE<br>ZBEK<br>USAID | Do të realizohen së paku 15 trajnime dhe nga këto trajnime së paku 150 gjyqtarë dhe 105 prokurorë të trajnuar me mundësi përfshirje edhe të zyrtareve që merren me të drejtat e njeriut dhe zyrtarëve për barazi gjnore. | Janë realizuar 4 aktivitete trajnuese, 1 prej tyre Trajnim i trajnuesve për mosdiskriminimin.20-21.05.2021 kanë marrë pjesë 23 gjyqtarë<br>11-12.11.2021 kanë marrë pjesë 10 gjyqtarë dhe 5 prokurorë<br>09-10.12.2021 kanë marrë pjesë 30 gjyqtarë<br>08-10.11.2021 trajnimi i trajnuesve kundër diskriminimit në të cilin kanë marrë pjesë 12 gjyqtarë<br>KGJK: Trajnimet janë organizuar nga Akademia e Drejtësisë |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | Numri i zyrtarve të cilët janë trajnuar | |
| II.2.13 | Hetimi i rasteve të mundshme të sulmeve ndaj gazetarëve, të dhunës familjare dhe krimit të urrejtjes, gjuhës së urrejtjes dhe diskriminimit, si dhe rastet që cenojnë të drejtat e personave të komunitetit (LGBTI), me prioritet | Në vazhdi mësi | Buxheti i Kosovës | KGJK<br>KPK<br>AD<br>Policia e Kosovës | Rastet e sulmeve ndaj gazetarëve, të dhunës familjare dhe krimit të urrejtjes, gjuhës së urrejtjes dhe diskriminimit, si dhe rastet që cenojnë të drejtat e personave të komunitetit (LGBTI), janë hetuar dhe shqyrtuar me urgjencë<br><br><br><br><br><br><br>Numri i vendimeve të shqiptuara nga gjykatat | Nga këto raste, ne Prokurorin e shtetit jane proceduar raste si në vijim :<br>- 1 rast është dërguar kundër NN,<br>-10 raste me kallëzim penal kundër 10 të dyshuarve,<br>- 6 raste me raport të veçantë dhe<br>- 3 raste janë bartur në vitin 2022).<br>Gjate vitit 2021 janë raportuar rastet si ne vijim:<br>- 2434 raste të Dhunës familje.<br>- Krimit të urrejtjes, gjuhës së urrejtjes si më poshtë:<br>-14 raste të mundshme ndëretnike prej të cilave :<br>8 raste janë dërguara ne prokurori,<br>1 rast është mbyllur pa elemente të vepres penale dhe<br>5 raste janë nen hetime;<br><br>**Gjate vitit 2021 janë raportuar**<br>Rastet që cenojnë të drejtat e personave të komunitetit (LGBTI), janë hetuar dhe shqyrtuar me urgjencë.<br>- 8 raste ndaj komunitetit LGBTI,<br>- 1 raste është nen hetime.<br>-Policia e Kosovës në vitin 2021 ka hartuar Udhëzuesin "Trajtimi i krimeve të urrejtjes.<br>Po ashtu Policia e Kosovës ka në përdorim që disa vite<br>**PSO Trajtimi policor me rastet e Anetareve të komunitetit LGBT**<br>**Ndërsa në vitin 2022,** është hartuar PSO parandalimi dhe Trajtimi e dhunës në familje.<br><br>2 tranime, 1 për mbrojtjen e gazetarëve dhe 1 Trajnim i Trajnuesve për Lirinë e shprehjes<br><br>17-18.06.2021<br>Kanë marrë pjesë 11 prokurorë, 14 zyrtarë policor<br><br>19-22.10.2021 4 trajnues nga radhët e gjyqtarëve, 3 nga radhët e prokurorëve si dhe 5 avokatë<br><br>Për krimet e urrejtjes janë realizuar 3 trajnime |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | 21-22.042021 kanë marrë pjesë 9 gjyqtarë dhe 5 nga stafi mbështetës i gjykatave dhe prokurorive<br><br>25-26.05.2021 kanë marrë pjesë 8 prokurorë si dhe 12 nga stafi mbështetës i gjykatave dhe prokurorive<br><br>11.11.2021 kanë marrë pjesë 11 gjyqtarë dhe 11 prokurorë<br><br>Për mbrojtjen e komunitetit LGBTI janë realizuar 2 trajnime në të njëjtën datë me 30.11.2021. Në të cilat kanë marrë pjesë 45 gjyqtarë, 13 prokurorë si dhe 5 zyrtarë policorë. |
| II.2.1 4 | Të bëhet mbledhja, analizimi dhe raportimi lidhur me rastet e lidhura me diskriminimin, duke përfshirë rastet e diskriminimit me **bazë gjinore dhe ato të ngacmimit seksual,** në harmoni me kërkesat e Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe ato të Ligjit për Barazinë Gjinore. | Në vazhdi mësi | Buxheti i Kosovës | KGJK<br>KPK<br>ZKM/ZQM<br>ABGJ | Mirëmbajtja dhe raportimi i të dhënave statistikore të kategorizuara sipas gjinisë, lidhur me rastet, procedurat dhe vendimet në rastet e diskriminimit dhe ngacmimit (seksual) | Sa i përket kesaj pike ju njoftojmë se sapo të zhbllokohet sistemi elektronik i lëndëve do t'ua dërgojmë këtë statistikë. ?<br>KGJK/Gjykatat nuk gjenerojnë statistika lidhur me lëndët duke ju referuar kategorive të caktuara të personsve por vetem në bazë të neneve përkatëse që parashihen me Kodin Penal të Kosovës, ashtu që sa i përket rasteve lidhur me Dhunën në Familje, për vitin 2021 kanë qenë 206 lëndë të zgjidhura të kesaj natyre në nivel të 7 Gjykatave të Rregullta të Republikës së Kosovës. |
| II.2.1 5 | Të evidentohen rastet e ankesave të ushtruara në sektorin publik dhe privat mbi bazat e diskriminimit të | Në vazhdi mësi | Buxheti i Kosovës | IAP<br>Ministrit Komunat Inspektorat i i Punës | Numri i ankesave të paraqitura për diskriminim ,si dhe numri i rasteve te iniciuara ex- | Avokati i Popullit, **gjatë vitit 2021**, ka pranuar gjithsej 162 ankesa individuale, ku ankuesit pretendojnë se janë viktima të diskriminimit. Nga këto ankesa, për hetim janë hapur 123 raste, ndërsa 39 ankesa janë shpallur të papranueshme.Gjithashtu, Avokati i Popullit gjatë vitit 2021, ka hapur 9 raste me vetiniciativë ex.officio. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | përcaktuara me Ligjin për mbrojtjen nga Diskriminimi | | | | officio për diskriminim në sektorin publik dhe privat | *Gjinia e ankuesve:*<br>Meshkuj 103<br>Femra 59<br><br>*Përkatësia e ankuesve:*<br>Shqiptar 136; Serb 7; Turq 6; Rom 4; Egjiptas 4; Goran 2; Boshnjak 2; Ashkali 1<br><br>Avokati i Popullit, **gjatë vitit 2022,** ka pranuar gjithsej 132 ankesa individuale, ku ankuesit pretendojnë se janë viktima të diskriminimit. Nga këto ankesa, për hetim janë hapur 88 raste, ndërsa 44 ankesa janë shpallur të papranueshme. Gjithashtu, Avokati i Popullit gjatë vitit 2022, ka hapur 9 raste me vetiniciativë ex.officio.<br><br>Gjinia e ankuesve:<br>Meshkuj 76<br>Femra 56<br>*Gjinia e Përkatësia e ankuesve:*<br>Shqiptar 114; Serb 7; Boshnjak 5; Turq 2; Ashkali 2; Rom 1; Goran 1 |
| II.2.16 | Të vendosen rregullat dhe proceduart për ndryshimin e gjinisë/seksit (shënjuesit të gjinisë) në dokumentet zyrtare | 2022/2023 | Buxheti i Kosovës Donatorët | MPBAP Agjensioni për Regjistrim Civil ZKM/ZQM ABGJ ZBEK KE | Jane hartuar udhëzimet, qartësuar rregullat dhe procedurat për ndryshimin e gjinisë/seksit (shënjuesit të gjinisë) në dokumentet zyrtare | Është hartuar projektligji për Gjendjen Civile, përmes të cilit janë shpjeguar procedurat e ndërrimit të gjinise/seksit.<br>Sipas planit legjislativ për vitin 2023, afati për miratim në Qeveri e kemi deri në qershor 2023. |
| **II.3** | **Objektivi specifik: Krijimi dhe fuqizimi i sistemit të trajnimit për standardet e të drejtave të njeriut;**<br>Progresi në zbatim | | | | | |

<table>
<tr>
<td>II.3.1</td>
<td>Përditësimi i programit të trajnimit për standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe legjislacionit për të drejtat e njeriut dhe komuniteteve</td>
<td>2021</td>
<td>Buxheti i Kosovës<br>Donatorët</td>
<td>IKAP<br>ZKM<br>/ZQM<br>ABGJ<br>Zyra për çështje të komuniteteve<br>Zyra e Komisionerit për Gjuhët<br>AD<br>OSBE</td>
<td>Programi i trajnimit për standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe legjislacionit për të drejtat e njeriut dhe komuniteteve i institucionalizuar<br><br>Programi trajnues i Akademisë së Drejtësisë</td>
<td>Është bërë përditësimi i programit të trajnimit për "Të drejtat e njeriut" dhe për "Të drejtat e komuniteteve".Trajnimet realizohen konform temave të përcaktuara në kuadër të Programit të trajnimit.</td>
</tr>
<tr>
<td>II.3.2</td>
<td>Organizimi i trajnimeve për ngritjen e kapaciteteve të nëpunësve civil mbi referimin interpretimin dhe zbatimin e standardeve ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut dhe legjislacionit për të drejtat e njeriut dhe komuniteteve në punën e tyre të përditshme</td>
<td>2021-2023</td>
<td>Buxheti<br>Donatorët</td>
<td>IKAP<br>ZKM<br>/ZQM<br>ABGJ<br>OSBE<br>KE<br>Këshilli i Evropës</td>
<td>Numri i trajnimeve të mbajtura<br><br>Numri i nëpunësve civil të cilët kanë marre pjese në trajnime , i ndare në baza gjinore;</td>
<td>Viti 2021-Trajnimi me temë "Të drejtat e njeriut në Kosovë" janë organizuar:<br>2 ditë trajnim ;1 grup;6 pjesemarrës nga niveli qendror.<br>Kurse në trajnimin "Të drejtat e komuniteteve në Kosovë" janë organizuar:6 ditë trajnim ;2 grupe;6 pjesëmarrës nga niveli qendror.<br>Trajnimi me temë "Të drejtat e njeriut në Kosovë" është organizuar:<br>Viti 2022
<table>
<tr><td>Ditë</td><td>Pjesemarres</td><td>Certifikuar per pjesëmarrje</td></tr>
<tr><td>2</td><td>14</td><td>14</td></tr>
</table>
Trajnimi me temë "Të drejtat e komuniteteve në Kosovë" është organizuar:
<table>
<tr><td>Ditë</td><td>Pjesemarres</td><td>Certifikuar per pjesëmarrje</td></tr>
<tr><td>2</td><td>9</td><td>9</td></tr>
</table>
Kurse nga niveli lokal eshte organizuar trajnimi "Të drejtat e njeriut, shërbimet sociale dhe familjare"<br>Trajnimi ka zgjatur 2 dite me 1 grup te pjesemarresve dhe jane trajnuar 23</td>
</tr>
</table>

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | nëpunës civil nga niveli lokal<br>MMPHI-së dhe EKW në vitin 2021 kemi filluar takimet per lidhjen e nje memorandum mirkuptimi<br>Qëllimi i këtij Memorandumi të mirëkuptimit ishte të përcaktojë fushat e bashkëpunimit ndërmjet MMPHI-së dhe EKW në lidhje me zbatimin e aktiviteteve nga EKW në kuadër të projektit ‘Rritja e fuqisë dhe pjesëmarrjen e gruasë kosovare në mjedis.<br>Njësia për te Drejtat e Njeriut Barazi Gjinore dhe diskriminim me përkrahjen e ECOKOSWOMEN, OJQ në Kosovëne kete vit ka organizuar dy trajnime per stafin e Ministris me temën: Konceptet gjinore, sfondi i zhvillimit të barazisë gjinore dhe kornizat themelore ndërkombëtare dhe vendore gjinore të aplikueshme në Kosovë dhe vendosja e tyre në kontekstin e mjedisit. Ne keto trajnime kane qene te ftuar 40 vet/a. |
| II.3.3 | Trajnimi i inspektorëve të punës për ngacmimi seksual, përkufizimin e tij ligjor si dhe mënyrën e referimit të rasteve. | 2021-2022 | Buxheti i Kosovës | Inspektorat i i Punës<br>MFPT<br>ABGJ<br>ZKM<br>/ZQM | Numri i trajnimeve të mbajtura<br><br>Numri i inspektorëve të punës të cilët kanë marre pjese në trajnime; | Trajnimi i inspektorëve të punës për ngacmimi seksual, përkufizimin e tij ligjor si dhe mënyrën e referimit të rasteve.<br>Numri i trajnimeve të mbajtura -1 trajnim<br><br>Numri i inspektorëve të punës të cilët kanë marr pjesë në Trajnime –mbi 20 |
| II.3.4 | Raportimi lidhur me numrin e trajnimeve të realizuara për ngritjen e kapaciteteve të gjyqtarëve dhe prokurorëve në fushën e të drejtave të njeriut, veçanërisht me theks të veçantë për praktikën dhe | 2021-2023 | Buxheti i Akademisë së Drejtësisë | Akademia e Drejtësisë<br><br>KGJK<br>KPK | Numri i trajnimeve të mbajtura<br><br>Numri i gjyqtarëve dhe prokurorëve të cilët kanë marre pjese në trajnime | Janë realizuar gjithësejt 14 trajnime në kuadër të cilave janë trajtuar pothuajse të gjitha nenet e KEDNJ-së dhe jurisprudenca e Gjykatës Evropiane për të drejtat e njeriut. Kanë qenë gjithësejt 394 gjyqtarë si dhe 64 prokurorë ( numri prej 394 si dhe 64 nënkupton që 1 person ka mund të marrë pjesë në më shumë se 1 here kur ka pasur trajtim të neneve te ndryshme) |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të drejtat e njeriut (KEDNj) | | | | | |
| II.3.5 | Zhvillimi i programe përkatëse për gjyqtarë, prokurorëve, zyrtarëve të policisë dhe avokatëve ,mbi standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut me fokus në ; **lirinë e shprehjes ,gjuhën e urrejtjes , lirinë e medias dhe për sinjazimin e gazetarve** në përputhje me standardet e Këshillit të Evropës, me një fokus të veçantë në gjyqësorin. | 2021/2022 | E Buxhetuar Donatoret | Akademia e Drejtësisë Akademia e Kosovës për Siguri Publike KGJK KPK OAK Këshilli i Evropës Policia e Kosovës OSBE ZKM/ ZQM | Numri i trajnimeve të mbajtura<br><br>Numri i zyrtarëve të cilët kanë marre pjesë në trajnime<br><br>gjyqtarët, prokurorët, zyrtarët e policisë dhe avokatët ,kanë njohuri të nevojshme mbi standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut me fokus në lirinë e shprehjes, gjuhën e urrejtjes, lirinë e medias dhe për sinjazimin e gazetarve në përputhje me standardet e Këshillit të Evropës | Në kolonën paraprake janë potencuar numri i trajnimeve dhe përfituesve sipas programit të dizajnuar për këtë fushë. Ndërkaq këtu po ofrojmë edhe të dhëna shtesë. Përveq gjyqtarve dhe prokurorëve në trajnimet e Akademisë së Drejtësisë kanë marrë pjesë edhe kategori tjera si avokat shtetëror 1, avokatë 5, bashkëpunëtorë profesional dhe zyrtarë tjerë ligjor nga gjykatat dhe prokuroritë 10, zyrtarë policor 6, këshilltar juridik ligjor 3 si dhe psikolog klinik 2<br><br>Gjithashtu është realizuar edhe 1 Trajnim i Trajnuesve (TiT) - Parandalimi i Torturës - Artikulli III i Konventës së Stambollit<br>Trajnimi është mbajtur me 8-10.09.2021 në kuadër të cilin kanë marrë pjesë 5 gjyqtarë dhe 4 prokurorë si dhe 03 Zyrtar Policor, 02 Këshilltar Juridik/Ligjor, 01 Psikolog Klinik<br><br>Një (1) Trajnimi i Hetimit të Krimit të Urrejtjes me gjithësej 14 pjesmarrës.Krimet e urrejtes si njësi mësimore janë trajtuar në Modulin I të Trajnimin Profesional Polic i Ri gjithësej në këto tema kanë kaluar 197 pjesmarrës<br>Në totali kemi dy (2) trajnime me: 211 pjesmarrës |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| II.3.6 | Trajnimi i zyrtarëve policorë lidhur me përkufizimin e dhunës në baza gjinore dhe ngacmimit seksual sipas ligjeve të Kosovës, atë se çfarë përfshihet në të, si dhe lidhur me mënyrën e trajtimit të këtyre rasteve kur këto raportohen në polici, konform Kodit Penal të Kosovës | 2021/2022 | Buxheti i Kosovës | Akademia e Kosovës për Siguri Publike (AKSP) Policia e Kosovës ZKM/ ZQM ABGJ | Numri i trajnimeve të mbajtura<br><br>Numri i zyrtarëve policor të cilët kanë marre pjesë në trajnime<br><br>Përditësimi i kurseve të trajnimit konform ndryshimeve dhe plotësimeve të Kodit Penal lidhur me dhunën në bazë gjinore dhe ngacmimin seksual, me përqendrim në viktimën. | Ngacmimet seksuale trajtimi i tyre si dhe barazia gjinore si njësi mësimore janë trajtuar në **Trajnimin Profesional Polic i Ri** dhe atë në: **Moduli I** dhe **Modulin VII.** Gjithësej në këto tema kanë kaluar **197 pjesmarrës**<br>Po ashtu AKSP ka Zhvilluar Trajnimin Ngacmimet Seksuale të Zyrtarëve për Zbatim të ligjit<br><br>Në total Një (1) trajnim i mbajtur me gjithësej **197 pjesmarrës**<br><br>Me qëllim të ngritjes së kapaciteteve për parandalimin dhe trajtimin e rasteve të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave ABGJ ka vazhduar me ciklin e trajnimeve për "Procedurat Standarde të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna ne Familje-. **Gjatë muajve janar- shtator 2022 janë realizuar 4 sesione trajnimi dhe janë certifikuar 95 policë të reagimeve të shpejta** në Komunën e Prishtinës, Ferizajt, Gjilanit, Gjakovës ne vlere totale **5,538.60** euro.<br>Jane realizuar sesione trajnuese p♪7r obligimet e nivetlit Qendror ndaj Konventës së Stambollit", për mekanizmat lokal per mbrojtje nga dhuna në familje në Komunat Malisheve, Obiliq, Mamushe, Drenas, Klina dhe Viti ne te cilat ne total kane marre pjese 112 zyrtar. Këto trajnime janë organizuar dhe mbajtur gjatë periudhes korrik-shtator 2022 dhe shuma totale e buxhetit të shpenzuar të ABGJ-se është **1.601.00 euro**<br>ABGJ ka realizuar nje videospot televiziv për parandalimin e diskriminimit bazuar në orientimin seksual i transmetuar në RTK dhe media sociale, buxheti i shpenzuar i ABGJ **1.240.00** https://abgj.rks-gov.net/publikimet/120/video/120 |
| II.3.7 | Përditësimi i moduleve të trajnimit dhe organizimi i trajnimeve për prokurorët dhe gjyqtarët lidhur me ndarjen e pasurisë së përbashkët pas | 2021/2022 | Buxheti Donatorët | Akademia e Drejtësisë ZKM/ ZQM ABGJ KGJK KPK | Moduli i trajnimit i përditësuar konform ndryshimeve dhe plotësimeve të Kodit Penal lidhur me dhunën në bazë gjinore | Për aspektin penal të dhunës në familje u raportua në kolonat paraprake ndërkaq sa i përket ndarjes së pasurisë së përbashkët pas shkurorëzimit, alimentacionin, mbajtjen financiare të bashkëshortit-es si dhe dhunës në familje aspekti civil janë realizuar 7 trajnime<br>28.01.2021 kanë marrë pjesë 31 gjyqtarë dhe 1 prokurorë<br>17-18.03.2021 kanë marrë pjesë 38 gjyqtarë dhe 3 prokurorë<br>23.06.2021 kanë marrë pjesë 17 gjyqtarë<br><br>07-08.09.2021 kanë marrë pjesë 45 gjyqtarë dhe 6 prokurorë<br><br>15.10.2021 kanë marrë pjesë 27 gjyqtarë |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | shkurorëzimit, alimentacionin, mbajtjen financiare të bashkëshortit-es ,krimet në bazë gjinore, veçanërisht, dhunën në familje, dhunën seksuale, ngacmimin seksual, veçanërisht pas ndryshimeve dhe plotësimeve të Kodit Penal; | | | | dhe ngacmimin seksual.<br><br>Numri i trajnimeve të mbajtura<br><br>Numri i gjyqtarëve dhe prokurorëve të cilët kanë marrë pjesë në trajnime | 09.12.2021 kanë marrë pjesë 14 zyrtarë të ndihmës juridike falas<br><br>10.12.2021 kanë marrë pjesë 11 zyrtarë të ndihmës juridike falas |
| **III.** | **Objektivi strategjik: Sigurimi i jetës së shëndetshme dhe promovimi i mirëqenies për të gjithë;** | | | | | |
| **III.1** | **Objektivi specifik: Harmonizimi i kornizës ligjore me Konventën Ekonomike, Sociale dhe Kulturore;** | | | | | Progresi në zbatim |
| III.1.1 | Themelimi dhe Funksionalizimi i plotë i fondit për sigurime shëndetësore dhe qasja në kujdesin shëndetësor | 2023 | Buxheti i Kosovës | **MSH**<br>MFPT<br>Departamenti i Thesarit<br>Banka Qendrore e Kosovës | Janë siguruar burimeve të qëndrueshme dhe të mjaftueshme financiare për sektorin shëndetësor, përmes ofrimit të shërbimeve shëndetësore cilësore të arritshme dhe | Fondi është themeluar me Statutin e Fondit të miraturar në vitin 2016. Funksionalizimi i plotë i Fondit pason pas Plotësim/ndryshimit të Ligjit për Sigurim Shëndetësor i cili është në proces. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | të përballueshme për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës. | |
| III.1.2 | Nisja e mbledhjes së premiumeve, si dhe rimbursimi i barnave jashtëspitalore si shërbim i parë i fondit për sigurime shëndetësore<br><br>Mbledhja e premiumeve të sigurimeve shëndetësore nga qytetarët, mbulimi i kostos së premiumeve për kategoritë sociale nga buxheti i Kosovës. | 2022 | Buxheti i Kosovës | MSH<br>MFPT<br>Departamenti i Thesarit<br>Banka Qendrore e Kosovës | Është funksionalizu procesi i mbledhjes së premiumeve dhe dhe rimbursimi i barnave jashtëspitalore si shërbim i parë i fondit për sigurime shëndetësore | Aktivitetet e parapara në Plan fillojnë së zbatuari pas përfundimit të Plotësim/ndryshimit të Ligjit për Sigurim Shëndetësor i cili është në proces. |
| III.1.3 | Organizimi i fushatave për informim publik dhe projekteve tjera të promovimit dhe edukimit shëndetësor me qëllim të rritjes së shkallës së vetëdijes publike | 2021/2022 | Buxheti i Kosovës | MSH | Numri i fushatave të mbajtura dhe aktiviteteve promovuese të realizuara | Me qëllim të senzibilizimit të grave dhe vajzave për rëndësinë e kontrolleve parandaluese për sëmundjet me rrezik të lartë ABGJ ka realizuar videospotin mbi rëndësinë e kontrolleve te rregullta shëndetësorë për sëmundjet specifike” Parandalimi i kancerit të mitrës në shumen totale 1,240 .00 euro” https://abgj.rks-gov.net/publikimet/120/video/120;https://www.youtube.com/watch?v=lSvixnVGawM. te dyja te transmetuara ne RTK.<br>IKSHPK ka raportuar se janë realizuar fushatë BASHKË kundër Covid 19.<br>Shënimi i ditëve botërore: E Shëndetit, Kundër Duhanit, Tuberkulozit, Kundër substancave narkotike, e Zemrës, Hipertensionit, Diabetit dhe HIV/AIDS<br>Shënimi |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | dhe pajtueshmërisë me standardet shëndetësore; | | | | | Shënimi i Ditëve Botërore të Shëndetit: Tuberkulozit, Kundër Duhanit, Kundër substancave narkotike, e Zemrës, Hipertensionit, Diabetit dhe HIV/AIDS, Kancerit të qafës së mitrës, Kancerit të prostatës.<br>Mbajtëja e ligjeratave në shkolla me tema nga pakoja bazike e SSSH.<br>Përpilimi dhe aprovimi i materialeve edukative shëndetësore: Fletëpalosje, broshura, postera, video mesazhe.<br>Përpilimi i materialit edukative shëndetësore për **personat e verbër** në bashkëpunim me AQH. |
| III.1. 4 | Rishikimi dhe plotësim-ndryshimi i kornizës ligjore për Skemën e Ndihmës Sociale | 2020/2021 | Donatorët Buxheti është i paraparë në kuadër të Strategjis ë Sektoriale e MPMS (2018-2022) | Departamenti i Politikave Sociale dhe Familjare (DPSF)<br><br>Departamenti Ligjor i MFPT,<br><br>ZKM, Komunat | Ligjit nr. 2003/15 për Skemën e Ndihmës Sociale i harmonizuar dhe aprovuar | Gajtë vitit 2021 , është themeluar grupi Punues për hartimin e Projekt Ligjit të Skemës se Ndihmës Sociale,pocesi lidhur me pergatijen e këtij projekt ligji është planifikuar në kuadër të ratifikimit të Marrveshjes me B.Boterore për Projektin e Reformes së Skemës së Ndihmës Sociale. Gjatë vitit 2022 është punuar në përgatitjen e Projekligjit për Skemën e Ndihmë Sociale, i cili projekligj është planifikuar të finalizohet dhe aprovohet gjatë vitit 2023. Finalizimi i këtij projeklgji ndërlidhet edhe me fillimin e zbatimit të Projektit të Reformës së Skemës së Ndihmave Sociale, i planifikuar të financohet nga Banka Botërore, i cili projekt ende nuk ka filluar të zbatohet, si rezultat i mos ratifikimit të Marrëveshjes Financiare, e cila deri me tani është proceduar dy(2) herë në Kuvendin e Kosovës. |
| III.1. 5 | Ministria e Financave ,Punës dhe Transfereve në bashkëpunim me institucionet komeptenet dhe Organizatat e Shoqërisë Civile ta harmonizojnë Ligjin e Punës me Direktivat e BE-së | 2021/2022 | Buxheti i Kosovës Donatorët | MFPT | Ligji i punës është harmonizuar me Direktivat e BE-së dhe është aprovuar | Nuk janë ofruar informacione lidhur me kete aktivitet |
| III.1. 6 | Të ofrohet përkrahja ligjore dhe institucionale | 2021/2022 | Buxhet i Kosovës | MFPT Qendrat për Aftësim | Numri i personave me aftësi të kufizuara të | Në vitin 2022 janë ofruar shërbime për PAK ;<br>këshillim në karrierë 179 persona , këshillim në Punësim 110 persona dhe këshillim Intensiv 41 PAK<br>Sa i përket zgjerimit të profileve për aftësim dhe riaftësim profesional sipas |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | për aftësimin, riaftësimin, nxitjen dhe përgatitjen profesionale për punësim të përshtatshëm për personat me aftësi të kufizuar | | | Profesional (QAP-të) Qendrat për aftësimin, riaftësimin dhe punësim në Kosovë (QRPK) | cilët kanë përfituar nga zbatimi i këtij ligji<br><br>Çdo punëdhënës është i obliguar të punësoj një person me aftësi të kufizuara në çdo pesëdhjetë (50) punëtor. | kërkesave të tregut të punës, është bërë funksionalizimi i 12 profileve ekzistuese të QAP-ve që po kërkohen më së shumti në tregun e punës. Profilet që janë funksionalizuar/hapur janë:<br>Ndërtimtari në QAP-Prishtinë dhe Prizren; Kuzhinë në QAP Gjilan dhe Gjakovë; Parukeri/Grimere në QAP Gjakovë dhe Mitrovicë; Rrobaqepësinë QAP Gjilan, Gjakove dhe Prizren; Zdrukthëtari në QAP-Ferizaj; Saldim në QAP- Prizren; Furrtari në QAP- Prizren.<br>Në kuadër te fushatave vetëdijësuese për punësimin e PAK në sektorin publik dhe privat, janë mbajtur panairet e Punës, ku janë pasqyruar edhe shërbimet qe ofrohen nga ZP dhe QAP për PAK.<br>Trajnimi i PAK në Qendrat e Aftësimit Profesional- Gjatë vitit 2022 në kuadër të QAP-ve kanë qenë të përfshirë në trajnime 35 Persona me Aftësi të Kufizuar. Ne kuadër të kurrikulave të adaptuara për personat me aftësi të kufizuara, sa i përket rishikimit dhe zhvillimit të kurikulave të reja në kuadër të QAP-ve me mbështetjen e projektit EYE janë zhvilluar kurrikulat dhe paketat mësimore duke u bazuar në Standardet e profesionit në kualifikimet : Nëpunës i Kontabilitet, Murator, zdrukthëtari dhe instalime elektrik ( këto kurrikula përdoren edhe nga PAK)<br>Sa i përket adaptimit të punëtorive me pajisje për nevojat e personave me aftësi të kufizuar. Me mbështetjen e Save the Children ne kuadër te QAP janë bërë rregullimi i nyejve sanitare për qasje me të mirë të PAK.<br>Trajnimi i trajnerëve te QAP për implementimin e kurrikules së adaptuar për PAK, gjatë hartimit të këtyre kurrikulave njëkohësisht është bërë edhe trajnimi i trajnerëve të QAP rreth implementimit të kurrikulave për PAK<br><br>Numri i PAK ne ndërmjetësim në punësim te rregullt 9 persona sa i përket vitit 2022.<br>Sa i përket përfshirjes së PAK në punësim përmes Masave Aktive të Tregut të Punës, Numri i PAK në MATP 2 persona. |
| III.1. 7 | *Konfrom Ligjit nr. 04/l – 092 për personat e verbër ,të gjithë personat e verbët të lirohen nga nga çdo lloj takse dhe tatimi të drejtpërdrejtë,* | Në vazhdi mësi | Buxheti i Kosovës | Komunat MFPT Departmenti i Tatimit në Pronë (DPT) ZKM/ZQM | Numri i përfituesve (versonave të verbër ), të cilët/at janë liruar nga pagesa e tatimit në | Komuna e Prishtinës, deri më tani ka liruar vetme një (1) rast të dhe atë ne bazë të vendimit të MFPT-së DTP-së.Tani e tutje, çdo kërkesë e parashtruar individualisht nga persona të verbër me kriteret e përcaktuar në opinionin ligjor , komuna e Prishtinës do ti liroj nga detyrime tatimore për pronat e paluajtshme, duke i shqyrtuar dhe vendosur kërkesat edhe në mënyrë prapaveprues.<br>Ka filluar të zbatohet lirimi i personave të verbër nga pagesa e tatimit në pronë, ndërsa sa i përket numrit të përfituesve duhet inforamata duhet të |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | *duke përfshi edhe tatimin në pronë.* | | | | pronë | sigurohet nga komunat përkatëse. Të gjitha komunat e Kosovës që në përputhje me kushtet e përcaktuara nga Gjykata të lirojnë të gjithë tatimpaguesit që janë pronarë ose posedues dhe që i takojnë kategorisë së personave të verbër për të gjitha pronat e paluajtshme sipas kërkesës individuale të secilit për vitet tatimore 2013 e tutje, pasi që Ligji për Personat e Verbër ka hyrë në fuqi më 1 janar 2013.<br>**DTP ju ka përcjellur njoftim komunave që të fillojnë zbatimin e lirimit nga ngarkesa e tatimit në pronë personat e verbër, ku ka filluar edhe te zbatohet nga komunat, mirëpo sa i përket numrit të personave secila komune e ka evidencën e vet varësisht nga rastet individuale qe janë lajmëruar nepër komuna.** |
| III.1. 8 | Hartimi i Ligjit Gjithëpërfshirës për personat me aftësi të kufizuara | 2020/2021 | Buxheti i Kosovës | MFPT Departamenti i Pensioneve | Ligji Gjithëpërfshirës për personat me aftësi të kufizuara i aprovuar | Ligji Gjithëpërfshirës për personat me aftësi të kufizuara ende është në proces të hartimit. |
| III.1. 9 | Raportimi mbi mbështetjen me grante për OJQ-të e licencuara për ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare | 2021-2023 | Buxheti i paraparë në kuadër të buxhetit të MPMS | **MFPT** | Numri i organizatave të licencuara të cilat kanë marrë subvencione, për ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare | Si pjesë e zbatimit të programeve të mbështetjes së sektorit joqeveritar të licencuar në ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare për vitin 2021, MFPT/DPSF ka ofruar mbështetje përmes thirrjes publike për ( 39) OJQ të licencuara, ku shuma e mbështetjes nga fondet e vitit 2021 për OJQ-të e licencuara ka qenë 900,000.00 euro. Po ashtu si pjesë e bashkëpunimit me Zyren e BE-se dhe partneret implementues Save the Children dhe UNDP, janë ofruar mbështetje për rreth 40 OJQ në financim të projekteve për zbatimin e programeve dhe ngritjen e kapaciteteteve dhe infrastrukturës së sektorit joqeveritar të licencuar.<br><br>MPFT gjatë viit 2022,ka realizuar mbështetjen përmes thirrjes publike për 43 OJQ të licencuara në vlerë prej **1.000.000** milion euoro për ofrimin e shërbimeve soiciale dhe familajre për vitin 2022. Po ashtu me Vendim të Qeverisë së Kosovës është aprovuar ndarja e mjeteve finaciare në vlerë prej **500,000.00** euro për 43 OJQ-të cilat ofrojnë shërbim sociale dhe strehimoreve, për të vazhduar ofrimin e shërbimeve deri në realizimin e thirrjes publike për vitin 2023. |
| III.1. 10 | Të krijohet granti specifik për | 2021-2022 | Buxheti i Kosovës | Qeveria e Kosovës MFPT | Granti specifik për shërbime | Grupi Punues për përgatitje të formulës se Financimit për Shërbime Sociale pritet të themelohet, pasi ky proces do të varet edhe nga procesi i aprovimit të Ligjit të Financave Lokale , që është pjese e planit legjislativ për vitin |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | shërbime sociale dhe familjare | | Sa i përket buxhetit për grand specifik, ende nuk ka kaluar ligji, komunat janë duke funksionuar nga grandi i përgjithshëm. | Asociacion i i Komunave të Kosovës (AKK) | sociale dhe familjare i përcaktuar dhe funksionalizuar | 2022. |
| III.1.11 | Organizimi i fushatave për informim publik dhe projekteve tjera promovuese me qëllim të informimit të qytetarëve se ku mund të marrin shërbime dhe çfarë lloj shërbime sociale dhe familjare ofrohen | Në vazhdimësi | Buxheti i Kosovës Donatorët | MFPT Departamenti për politika sociale dhe familjare | Numri i fushatave dhe aktiviteteve promovuese të realizuara<br><br>Niveli i gjithëpërfshirjes së fushatave dhe aktiviteteve promovuese, me fokus në zonat rurale dhe grupet e margjinalizuara; | Në vazhdimësi, bëhet ,Informimi i komuniteteve përmes bisedave, takimeve komunitare , fletushkave, udhëzuesve mbi të drejtat themelore ne fushën e mirëqenies sociale. |
| **III.2** | **Objektivi specifik: Ngritja e kapaciteteve dhe vetëdijes shoqërore dhe institucionale për mbrojtjen e mjedisit**<br>Progresi në zbatim | | | | | |
| III.2.1 | Qeveria e Kosovës të inicoj | 2022 | Buxheti i Kosovës Donatorët | MMPHI Ministrit ZPS (Zyra | Me vendim të Qeverisë është | Nuk ka pas ndonjë iniciativ për realizimin e këtij aktiviteti. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | formimin e një trupe ndër-institucionale që do ti koordinonte proceset që ndërlidhen me implementimin e “Agjendës së Gjelbër” | | | për Planifikim Strategjik)<br>Komunat<br>ZKM/ZQM<br>BE<br>KE | themeluar trupa ndërinstitucionale që do ti koordinonte proceset që ndërlidhen me implementimin e “Agjendës së Gjelbër”<br><br>Trupa ndërinstitucionale ka hartuar Planin Kombëtar për zbatimin e “Agjendës së Gjelbër” | |
| III.2.2 | Projekte vetëdijesuese dhe fushata avokimi për të rinjtë lidhur me mbrojtjen e mjedisit (mbrojtjen e florës dhe faunës ) | 2021-2022 | Buxheti i Kosovës<br>Donatorët | MMPHI<br>MAPL<br>MBPZHR/Agjencioni i Pylltarisë<br>MASHTI<br>MKRS<br>Komunat | Ngritja e vetëdijes dhe ndërgjegjësimit të të rinjve për çështjet mjedisore përmes aktiviteteve të angazhimit qytetar.<br><br>Numri i projekteve dhe fushatave avokuese të organizuara me të rinjtë dhe për të rinjtë | Lidhur me këtë masë ka pas takime te ndryshme të organizuara nga niveli qendror dhe lokal i qeverisjes.<br>MASHTI, Me rastin e Ditën ndërkombëtare të fëmijës, në Koordinim mem Save the Chidren dhe organizatën e fëmijëve ROR, kemi mbajtuar aktivitetin ndërgjegjësues për Mbrojtjen e ambientit dhe kushtete klimatike, ku përveç diksutimeve në relacion MASHTI-ROR dhe Save the Chidren, pati edhe një **ekspozitë të punimeve creative të nxënësve me mjete të ricikluara.**<br><br>Tutje 9 Dhjetor 2022 u mbajt edhe një tryezë diskutimi me ROR-MASHTI-MMPHI, prej nga doli ideja e një fushate për Mbrojtjen e mjedisit dhe trajtimin e duhur të kësaj teme në shkollat tona.<br>MMPHI në vitin 2021 ka mbajte ligjërata për Edukim dhe Ndërgjegjësim Mjedisor në institucionet arsimore fillore. Qëllimi i edukimit, informimit dhe pjesëmarrjes publike është të ndihmojë në arritjen e objektivave të Strategjisë për Mbrojtjen e Mjedisit dhe strategjive tjera sektoriale. Pra, të inkurajojë dhe zhvillojë format e edukimit në të gjitha nivelet institucionale dhe jo-institucionale për të gjitha grupet e qytetarëve pa asnje diskriminim në mbrojtjen e mjedisit.<br>**Komuna e Prishtinës:** ka realizuar 5 projekte të cilat në vete kanë pasur |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | edhe fushata vetëdijesuese me qytetaret e Komunes së Prishtines lidhur me mbrojtjen e mjedisit<br>**Komuna e Kamenices;** Mbajtja e ligjëratave në shkolla lidhur me mbrojtjen e ambientit (florës dhe faunës).Mbajtja e takimeve me KL dhe organizimi i aksioneve për pastrimin e ambientit<br>Pastrimi i deponive ilegale dhe vetëdijesimi i qytetarëve.Ngritja e vetëdijes te të rinjtë për ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit.Buxheti nga Drejtoria e Shërbimeve publike, Ambientit dhe Inspektoratit<br>**Komuna e Dragashit**; gjatë vitit 2021 ka organizuar fushatë vetëdijësuese dhe ndërgjegjsuese me nxënsat e disa shkollave të Komunës së Dragashit, po ashtu ka pasur aktivitete të ndryshme në ditet boterore që ndërlidhen me ambijent.<br>Komuna ka mbeshtetur OJQ-të Lokale, të cilat kanë zhvilluar aktivitete te ndryshme. OJQ-të Avoko dhe Shea Ambijenti. |
| III.2.3 | Organizimi i fushatave për informim publik dhe projektet e tjera të promovimit dhe edukimit të popullatës për mjedis të shëndetshëm dhe të sigurtë | 2021-2022 | Buxheti i Kosovës Donatorët | MMPHI MBPZHR Komunat Ministrit OJQ-të Komisioni Evropian | Numri i fushatave dhe aktiviteteve promovuse të realizuara sa i përket sigurimit të një ambienti të shëndetshëm dhe të sigurtë për qytetarët | MMPHI ditën Botërore e Ujërave 22 Mars 2021 e ka shënuar përmes aktiviteteve online nën moton botërore bashkohuni në bisedën e #WorldWaterDay. Çfarë do të thotë Uji për ju?<br>Dita Botërore e Tokës 22 Prill 2021 është publikuar viedeo dhe janë shpërndar materiale promovuese për këte ditë.<br>Dita Botërore e Biodiversitetit 22 Maj 2021- Janë shpërndarë materiale promovuese T- shirt, poster, roll up, fletëpalosje, baner, pin buton, qanta të biodegradueshme.<br><br>Dita Botërore e Mjedisit 05 Qershor 2021- Video promovuese me rastin e shënimit të DBM 5 Qershor 2021 Video përmbledhëse nga Kampanja me ligjërata për edukim dhe ndërgjegjësim mjedisor<br>Shpërndarja e materialeve promovuese Fletëpalosje, poster, Roll up, pllakate, T-shirt, çanta të biodegradueshme, pin buton mesazhe sensibilizuesese dhe materiale për realizimin e aktiviteteve të pastrimit<br>Dita Botërore pa Makina" 22 shtator 2021- Në kuadër të agjendës për shënimin e 22 Shtatorit "Dita Botërore pa Makina", MMPHI në bashkëpunim me 10 Komunat si: Peja, Klina, Gjakova, Prizreni, Gjilani, Hani i Elezit, Shtërpca, Suhareka, Malisheva, Prishtina ka realizuar Javën Evropiane të lëvizshmërisë me aktivitete të defilimit me biçikleta dhe aktivitete të ndryshme.<br>Me moton "Të sigurt dhe të shëndetshëm, me mobilitet të qëndrueshëm",<br>Dita Ndërkombëtare e Ecjes së Lirë në Natyrë 15 tetor 2021- Manifestimi qendror është shënuar në peizazhin e mbrojtur " Gërmia" Prishtinë , me |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | ekspozitë të punimeve të nxënësve të shkollës fillore " Iliria" dhe ecje të lire në shtigjet e peizazhit të mbrojtur "Gërmia<br>Janë mbajtur 5 fushata vetëdijësuese dhe aktivitete Mjedisore të cilat janë implementuar nga sektori i mbrojtjes së mjedisit për qytetarët e Komunës së Prishtinës<br>**Komuna e Dragashit**, ka shënuar 22 Marsin: Dita Ndërkombëtare e Mbrojtjes së Ujit- Komuna e Dragashit dhe Hidroregjioni Jugor,<br>22 Prill: Dita Ndërkombëtare e Tokës, Komuna e Dragashit- Ojq Ambienti<br><br>05 Qershor: Dita Botërore e Mjedisit, Komuna e Dragashit- Ojq Ambienti<br>22 Shtator: Dita Botërore e Qyteteve të Pastra. Komuna e Dragashit- Ojq Ambienti |
| III.2. 4 | Të përmirësohet dhe përditësohet në vazhdimësi sistemi i informimit të publikut, i cili njëherësh do të ishte masë parandaluese e ndikimit të ndotjes së ajrit në shëndetin dhe jetën e njeriut. | 2021-2022 | Buxheti i Kosovës | MMPHI Agjencioni për mbrojtjen e Mjedisit Policia e Kosovës | Sistemi i informimit për qeshjet e mjedisit funksional ,transparent dhe informon me kohe qytetarët lidhur me çështjet mjedisore | MMPH-Në kuadër të procesit të ngritjes së Sistemit Informativ Mjedisor, është zhvilluar portali për Cilësinë e ajrit (Air Quality Kosova https://airqualitykosova.rks-gov.net/en/about-air-quality-portal/). Po ashtu është zhvilluar edhe Sistemi Informativ për Raportim për Mbeturina, dhe është në proces të funksionalizimiti regjistri për Kemikate dhe mbeturina te rrezikshme.<br>Për nevoja të informimit të publikut po ashtu është në dispozicion edhe ueb faqja e Agjencionit per Mbrojtjen e Mjedisit te Kosoves (www.ammk-rks.net ) dhe ueb faqja e Institutit Hidrometeorologjik i Kosovës (https://ihmk-rks.net/). Në të dy këto ueb faqe ofrohen informata për gjendjen e mjedisit dhe në menyre specifike për gjendjen e ajrit, ujerave, tokës, mbeturinave dhe biodivesitetit.<br>Aktualisht është duke u punuar në rishikimin e programit për menaxhimin e Sistemit Informativ Mjedisor.<br><br>**Komuna e Prizerenit –ka bër**ë vendosjen e (sensoreve ) në 7 stacione për matjen e qualitetit të ajrit ne Komunën e Prizreni,, të cilat kanë linkun me qasje per te gjithe:<br>• Recan<br>• Lutogllave<br>• Pirane<br>• Gjonaj<br>• Zhur (Vlashnje) |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | • Motrat Qiriazi (Kurille)<br>• Remzi Ademaj<br>Komuna ka hartuar Planin Master për Menaxhimin e mbeturinave për vitin 2018-2023, dhe -Rregulloren Komunale për MMN |
| III.2. 5 | Të fuqizohen kapacitetet e prokurorëve dhe gjykatësve dhe Policisë së Kosovës me trajnime lidhur me trajtimin e lëndëve që dalin nga kapitulli XXVIII i Kodit Penal | 2021-2022 | Buxheti i Kosovës Donatorët | Akademia e Drejtësisë Akademia për Siguri Publike Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës Policia e Kosovës | Numri i trajnimeve të realizuara dhe numri i zyrtarëve të trajnuar nga gjygjesori, prokuroria dhe policia lidhur me veprat penale që i dedikohen mjedisit | Programi trajnues për vitin 2021 nuk ka pasur trajnime sa i përket veprave penale kundër mjedisit. Kjo tematikë është trajtuar në programin aktual trajnues për vitin 2022.<br>14.04.2022<br>Përfitues të këtij trajnimi ishin 3 nga Gjykatat Themelore, 4 prokuror nga Prokuroritë Themelore, 5 inspektor nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor si dhe 3 zyrtarë policor<br><br>14.04.2022<br>Përfitues të këtij trajnimi ishin 4 nga Gjykatat Themelore, 1 prokuror nga Prokuroritë Themelore, 5 inspektor nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor si dhe 2 zyrtarë policor.<br><br>**Akademia e Kosovës për Siguri Publike**; Në Trajnimin Profesional Polic i Ri konkretisht në Moduli VII, janë trajtuar veprat që parashihet në Kapitullin XXVIII i Kodit Penal. Në këtë modul kanë kaluar 197 pjesmarrës .Në total Një (1) Trajnim me gjithësej 197 pjesmarrës Policia e Kosovës;<br>Është mbajtur një 1 trajnim të cilin e kanë ndjekur 17 pjesëmarrës nga Policia e Kosovës. |
| III.2. 6 | Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës ta vendosin bazën e të dhënave lidhur me trajtimin e lëndëve kundër mjedisit. | 2021-2022 | Buxheti i Kosovës Donatorët | Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës | Baza e të dhënave lidhur me trajtimin e lëndëve kundër mjedisit e funksionalizuar | Nuk janë ofruar informacione lidhur me kete aktivitet. |
| III.2. | Në bashkëpunim dhe koordinim të ngushtë me | 2021-2023 | Buxheti i Kosovës Donatorët | **MMPHI** MBPZHR/ Komunat | Numri i Komunave të cilat kanë | Komunat mbeten të përkushtuara në ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit si dhe në sistemin e menaxhimit të mbeturinave.Me qëllim të zbatimit Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit, deri më tani **27 komuna** kanë hartuar planin për |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 7 | ministrinë, Komunat duhet të hartojnë planin për mbrojtje të mjedisit dhe zhvillim të qëndrueshëm brenda territorit të komunës. | | | MAPL | hartuar dhe aprovuar planin për mbrojtje të mjedisit dhe zhvillim të qëndrueshëm brenda territorit të komunës. | menaxhimin e mbeturinave komunale ndërsa **11 komuna** (Gjilan, Vushtrri, Malishevë, Ranillug, Zubin Potok, Graçanicë, Leposaviq, Mitrovica e Veriut, Partesh, Zveçan, Klinë) ende nuk kanë hartuar këtë plan. Komunat në vazhdimësi hasin sfida për zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit dhe zbatimin e Planit të menaxhimit të mbeturinave komunale për **shkaqe të fondeve të pamjaftueshme**, mosvetëdijesimit të qytetarëve, mungeses së pagesave nga ana e qytetarëve, numrit të vogël të inspektimeve, mungeses së ndërmarrjeve, stafit jo adekuat për laminë përkatëse, mungeses së pajisjeve të mjaftueshme teknike për kompaninë që menaxhon me mbeturinat etj |
| III.2. 8 | Në bashkëpunim dhe koordinim të ngushtë me ministrin, Komunat duhet të hartojnë Programet lokale për mbrojtjen e ajrit nga ndotja dhe menaxhimin e cilësisë së ajrit përbrenda komunave në harmoni me Strategjinë kosovare të mbrojtjës së ajrit nga ndotja. | 2021-2023 | Buxheti I Kosovës Donatorët | MMPHI Komunat MAPL | Numri i Komunave të cilat kanë hartuar dhe aprovuar programet dhe masat për parandalimin apo uljen e nivelit të ndotjes së ajrit<br><br>Numri i aktiviteteve për zbatimin e programeve per parandalimin dhe uljen e nivelit të ndotjes së ajrit | Sipas informacioneve të siguruara nga MAPL , Hartimi i planit të veprimit për cilësinë e ajrit mbetet sfidë e theksuar e komunave, ku vetëm 1 komuna (Gllogoc) ka hartuar këtë plan. |
| III.2. 8.1 | Institucionet kompetente konform legjislacionit në | Në vazhdi mësi | Buxheti i Kosovës Donatorët | Agjencia e Ushqimit dhe Veterinaris ë se | Numri i kontrolleve dhe masave parandaluese me qëllim të | Nga inspektorët e Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë janë realizuar kontrolle në 55.580 dërgesa të importit në venbdkalime kufitare;<br>Janë kryer 18.836 kontrolle brenda teritorit të Republikës së Kosovën në subjekte ushqimore,subjekte publike, shëndetsore dhe ferma. Janë analizuar 2484 mostra të ndryshme; |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | fuqi t`i ndërrmarin veprimet e nevojshme për sigurimin e sigurisë shëndetësore të ushqimit dhe mbrojtjen e shëndetit publik dhe Konsumatorit | | | Kosovës (AUVK) Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKSHP) MBPZHR MSH Ministria e Industrisë Ndërmarrësisë dhe Tregëtisë Departamenti për mbrojtjen e Konsumatorit Policia e Kosovës | parandalimit të cenimit të shëndetit publik dhe konsumatorëve nga ushqimet (produktet vendore), dhe ato të importuara<br><br>Numri i masave të shqiptuara ndaj atyre që e cenojnë sigurisë shëndetësore të ushqimit dhe mbrojtjen e shëndetit publik dhe Konsumatorit | Janë inicuar procedura kundëvajtëse për 188 subjekte të ndryshme.<br>Janë asgjësuar 1,921,075.87 kg/lit të produkteve të ndryshme ushqimore. |
| III.2.8.2 | Të bëhen hulumtime të vazhdueshme mbi ndikimin e faktorëve mjedisor në shëndetin e popullsisë në burra dhe gra. | 2021/2022 | Buxheti Kosovës Donatorët | Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKSHPK) | Analiza Gjinore e perpiluar mbi ndikimin e faktoreve mjedisore në burra dhe gra;<br><br>Janë ndërrmarë hulumtimet dhe janë propozuar masat mbrojtëse për parandalimin | Nuk janë ofruar informacione |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | e efekteve të dëmshme të faktorve të mjedisit në shëndetin e popullsisë | |
| III.2. 8.3 | Përcaktimi i kushteve mikroklimatike në ambientet shkollore | 2020 | Donatorët OBSH | Instituti Kombëtar i Shëndetësi së Publike të Kosovës (IKSHP) MASHTI | Për here të pare në Kosovë do të zhvillohet metodologjia e punës në mjediset shkollore dhe do të analizohen parametrat kimik me ndikim në shendetin e fëmijeve në Institucionet Publike | Nuk janë ofruar informacione |
| III.2. 8.4 | Menaxhimi i informatave mbi kualitetin e ajrit, ndryshimet e sjelljes dhe shërbimet e komunikimit | 2021-2022 | Donatorët Millenium Challenge Corporati-on dhe Millenium Foundation Kosovo | Instituti Kombëtar i Shëndetësi së Publike të Kosovës (IKSHP) | Zhvillimi i këshillave shendetesore si pasojë e mjedisit të ndotur, të dizajnoj kampanjën, trajnime, punëtori për Qeverine, Institucionet, shoqërinë civile, OJQ, | Nuk janë ofruar informacione |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | gazetarët. Asistencë IKSHPK-se, mbi informimin e publikut, grumbullimin dhe interpretimin e informatave ekologjike dhe shëndetësore për grupet vulnerabile te popullatës. Analiza statistikore e të dhënave të morbiditetit dhe mortalitetit që vijnë si pasojë e aerondotjes. | |
| III.2. 9 | *Sigurimi i kontrollit të vazhdueshëm të kualitetit të ujit për pije, duke përfshirë zonat e mbrojtura ujore sanitare* | 2021-2023 | Buxheti i Kosovës Donatorët | Instituti Kombëtar i Shëndetësi së Publike të Kosovës (IKSHP)/ Qendra e ujit | Numri i kontrolleve të realizuara si dhe rekomandime ve të ardresuara dhe të zbatuara nga institucionet kompetente | Nuk janë ofruar informacione |
| **III.3** | **Objektivi specifik: Garantimi i të drejtave të punëtorëve në përputhje me standardet ndërkombëtare;** Progresi në zbatim | | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| III.3. 1 | Të rritet numri i inspektimeve dhe inspektorëve, për monitorim rigoroz të zbatimit të Ligjit të Punës dhe Ligjit për Mbrojtjen dhe Sigurinë në Punë apo për plotësim-ndryshim të ligjeve të cilat sigurojnë mbrojtjen dhe sigurinë në punë. | 2021/2022 | Buxheti i Kosovës | **MFPT Inspektorati i Punës** Këshilli Nacional për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë | Numri i inspektorëve shtesë të angazhuar në kuadër të Inspektoratit të Punës si dhe,<br><br>Numri i inspektimeve dhe gjobave të shqiptuara<br><br>I punësuari ka të drejtë në sigurinë në punë, mbrojtje të shëndetit dhe në ambientin e përshtatshëm të punës, në përputhje me këtë ligj dhe Ligjin për siguri në punë, mbrojtje të shëndetit të punësuarve dhe mbrojtjen e ambientit të punës. | Numri i inspektorëve të angazhuar në kuadër të Inspektoratit të Punës është për dy ma pak nga 39 sa ishin tani janë 37.<br><br>Numri i inspektimeve dhe gjobave të shqiptuara 281 në tërsi. Nuk kemi të dhëna të ndara për lëmi, sektor, apo për shkelje të veçanta të dispozitave të caktuara shqiptimin e masës së gjobës. |
| III.3. 2 | Fuqizimi i kapaciteteve institucionale në Inspektoratin e | Në vazhdi mësi | Buxheti i Kosovës | MFPT Inspektorat i i Punës | Rritja e numrit të inspektimeve në sektorët | Edhe pse gjatë vitit 2022 i kemi rekrutuar 8 inspektor përsëri e kemi numrin e njëjtë të inspektorëve të punës me numrin e inspektorëve të punës të vitit paraprak (2021). Numri është 37, kjo për arsye të pensionimit të disa prej tyre, disa e kanë lënë punën në Inspektorat dhe |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | punës | | | | me rrezikshmëri të lartë | 2 janë transferuar në vende tjra të punës . |
| III.3. 3 | Monitorimi i zbatimit rigoroz të Ligjit të Punës dhe ligjit për sigurinë dhe shëndetin në punë | Në vazhdi mësi | Buxheti i Kosovës | MFPT Inspektorat i i Punës Inspektorat i Shëndetësor – Ministria e Shëndetësisë | Raportet mbi monitorimin e zbatimit rigoroz të Ligjit të Punës dhe ligjit për sigurinë dhe shëndetin në punë | Konform kapaciteteve mbikëqyrëse lidhur me monitorimin e Ligjit të Punës dhe ligjit për sigurinë dhe shëndetin në punë , sipas planifikimit janë kryer 3022 inspektime (informacion i ofruar nga Inspektorati i Punës)<br><br>Numri i inspektimeve të realizuara sipas planifikimit është 3323 inspektime për vitin 2022. |
| III.3. 4 | Forcimi i kapaciteteve të inspektoratit të punës për adresimin e punësimit joformal | 2021-2022 | Nuk ka kosto shtesë<br><br>Buxheti i përfshirë në Planin eVeprimit të Strategjisë Sektoriale të MPMS-së 2018-2020 | **MFPT/ Inspektorati i Punës** IKAP, ASK | Programi i trajnimit i zbatuar dhe numri i inspektorëve të trajnuar<br><br>Analiza paraprake gjinore në përfshirjen e burrave dhe grave në ekonomine joformale, e realizuar përmes Anketës së Fuqise Punëtore. | Forcimi i kapaciteteve të inspektoratit të punës për adresimin e punësimit joformal<br>Program të trajnimit për zbatim ose i zbatuar nuk ka dhe numri i inspektorëve të trajnuar është mbi 20 inspektor.<br><br>IKAP, ka mbajt aktivitetin trajnues me titull “Siguria dhe shëndeti në punë” është organizuar:<br><br>Ditë / Pjesemarres / Certifikuar per pjesemarrje:<br>**10** / **56** / **56** |
| III.3. 5 | Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, të krijojnë bazën | 2021/2022 | Buxheti i Kosovës | MFPT Këshilli Nacional për Sigurinë | Krijimi i bazës ligjore do të mundësonte krijimin e një | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | Ligjore për sigurimin e të punësuarve nga aksidentet (fatkeqësitë) në punë dhe sëmundjet profesionale. | | | dhe Shëndetin në Punë | fondi të përbashkët të punëdhënësve dhe punëmarrësve i cili do t'iu siguronte punëtorëve të Kosovës dhe familjeve një trajtim me dinjitet në rast fatkeqësie në punë | |
| **III.4** | **Objektivi specifik: Zhvillimi i programeve për rehabilitim dhe trajtimin e varësisë nga alkooli dhe droga;** Progresi në zbatim | | | | | |
| III.4. 1 | Zhvillimi i programeve për rehabilitim dhe trajtimin e popullatave kyçe vartës nga alkooli dhe droga; | 2021-2023 | Buxheti Donatorët | **MSH** Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik (IKSHP) Departamenti për shëndetsinë në burgje Fondit Global në Kosovë | Programet për rehabilitim dhe trajtimin e popullatave kyqe vartës nga alkooli dhe droga të hartuara Bartës i veprimit është MSH, kurse IKSHPK është pjesëmarrës në grupet punuese per hartimin e dokumenteve strategjike dhe programeve duke ofruar | IKSHPK - ka raportuar Pjesëmarrja në organizimin e tryezës së rrumbullakët me rastin e shënimit të Ditës Botërore kundër Drogave, me profesionistët shëndetësor dhe palët tjera të interesit. Ligjeratat në shkolla në kuadër të Pakos bazike me temë "Duhani, akooli dhe drogat". |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | ekspertizën profesionale dhe shkencore | |
| III.4. 2 | Të ndërtohet Qendra rehabilituese për personat në varësi të substancave narkotike | 2022-2023 | Buxheti Donatorët | MSH Klinika Psikiatrike –QKUK | Ndërtimi i Qendrës rehabilituese për personat në varësi të substancave narkotike<br><br>Numri i personave të cilët kanë përfituar dhe marrë shërbime nga Qendra rehabilituese | **Lidhur me ndërtimin e Qendrës rehabilituese për personat në varësi të substancave narkotike- është inicue kërkesa nga departamenti i shërbimeve shëndetësore/divizioni i shëndetit mendore dhe është nënëshkruar nga Ministrit Shëndetësisë .**<br><br>Në kuadër të Vlerësimit Mbarëkombëtar në Shëndetin Mendor që do të realizohet përmes huamarrjes nga Banka Botërore, nga një kompani e kontraktuar është kërkuar planifikimi dhe kostimi i ndërtimit të Qendrës së Sëmundjeve të Varësisë në mënyrë që në vitin e ardhshëm të mund të hyjë në Planin e MSh-së. |
| III.4. 3 | Zhvillimi i programeve për parandalimin dhe eliminimin e stigmës dhe paragjykimeve dhe trajtimin e personave me HIV-it; | Në vazhdi mësi | Buxheti Donatorët | **MSH** Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik (IKSHP) Fondi Global për Grupin e Avokimit të Programit HIV dhe TBC në Kosovë – PAG | Programet për parandalimin dhe eliminimin e stigmës dhe paragjykimeve dhe trajtimin e personave me HIV-it të hartuara dhe zbatuara | Në kuadër të programeve për parandalimin dhe eliminimin e stigmës , paragjykimeve dhe trajtimin e personave me HIV-it,IKSHPK ka mbajtë ligjerata në shkolla të mesme me temë HIV/AIDS, parandalimi dhe eliminimi i stigmës dhe paragjykimeve |
| III.4. | Ngritja e kapaciteteve | Në vazhdi | Buxheti Donatorët | **MSH** Instituti | Numri i fushatave | **Mbajtja e trajnimeve periodike rreth Shëndetit seksual dhe riprodhues, me mësimdhënsit dhe nxënsit e shkollave të mesme, në** |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 4 | profesionale (për promovim dhe edukim shëndetësor, përfshirë shëndetin seksual dhe riprodhues si dhe nevojat specifike shëndetësore të grave dhe burrave). | mësi | | Kombëtar i Shëndetit Publik (IKSHP Shoqëria Civile Mediat | ,aktiviteteve të organizuara lidhur me Informimin, edukimin dhe këshillimin mbi shëndetin seksual dhe riprodhues | **bashkëpunim me MASHTI, UNFPA dhe KOPF.** |
| III.4. 5 | Të bëhet Vlerësimi periodik i nivelit të mundshëm të stigmës dhe diskriminimit dhe i kualitetit të shërbimeve të ofruara ndaj popullatave kyçe të rrezikuar nga HIV dhe PJHIV. | Në vazhdi mësi | Buxheti Donatorët | **MSH** Organizata Botrore e Shëndetsis ë (OBSH) OJQ-të të cilat merren me mbrojtjen dhe promovimi n e të drejtave të personave të prekur me HIV | Raportet dhe vlerësimet periodike te realizuara. Personat e rrezikuar nga HIV dhe PJHIV, trajtohen në mënyrë humane dhe marrin shërbimet e nevojshme shëndetësore etj | Nuk janë ofruar informacione |
| III.4. 6 | Të ofrohet trajtim human dhe shërbime të nevojshme shëndetsore për personat e prekur nga Tuberkulozi | Në vazhdi mësi | Buxheti Donatorët | MSH Organizata Botrore e Shëndetsis ë (OBSH) OJQ-të të cilat | Numri i personave të prekur nga Tuberkulozi (TBC) të trajtuar në mënyrë | Gjate vitit 2021 trajnimet e mbajtura me familjare dhe paciente me Tuberkuloz kanë qene me të pakta si pasoje e pandemise Covid 19. Megjithate nga donatori Fondi Global ka filluar pilotimi i VST/video supervised treatment , që inkurajon pacientet dhe familjaret e pacienteve me TB që të marrin si duhet , në kohën e duhur dhe pa ndërprerje trjatimin. Gajtë vitit 2021 ,janë siguruar 100% barnat dhe produktet laboratorike |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | (TBC) | | | merren me mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të personave të prekur me TBC | humane dhe marrin shërbimet e nevojshme shëndetësore etj... | diagnostike për TB nga buxheti i Kosovs.<br>Është shenuar Dita Botërore e TBC ku është bërë avokim për ofrim cilësor dhe të qasshem të shërbimeve për pacientet me TBC kudo në Kosovë.<br>Gjate vitit 2022 kemi pasur 608 raste/paciente me Tuberkuloz ne Kosovë.<br>MSh ka realizuar blerjen dhe furnizimin me mjete diagnostike dhe barna antituberkulare për të gjithë të dyshuarit dhe pacientet me TB. Gjate vitit 2022 nuk ka pasur ankesa nga pacientet për diskrimin në trajtim , trajtim jo human apo forma te tjera te diskriminimit. Janë organizuar fushata vetëdijësuese në ditën botërore të Tuberkulozit për punëtore shëndetsore , paciente dhe komunitet. |
| III.4. 7 | Ministria e Arsimit të iniciojë fushata vetëdijësuese në shkolla lidhur me pasojat nga përdorimi i substancave narkotike me qëllim parandalimin; | Në vazhdi mësi | Buxheti Donatorët | **MASHTI**<br>MSH<br>MKRS<br>OJQ-të të cilat merren me mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të personave përdorues të substancave narkotike | Numri i aktiviteteve të realizuara për vetëdijesimin e të rinjve lidhur me pasojat që sjell përdorimi i substancave narkotike | Nuk ka pasur fushatë të iniciuar nga MASHTI, por aktivitete të koordinuara me partnerë qeveritar e joqeveritare. Si çdo vit në fillim të vitin, në kuadër të planit operativ të policies në bashkësi janë mbajtuar ligjërtata në fushën e parandalimit të dukurive negative në shkolla nënprojektet:<br><br>“Siguria në objekte shkollore”<br>“Stop droga në shkolla”<br>“Rrugë të sigurta për nxënësit”<br><br>Sa i përket specifikisht parandalimit të narkotikëve, Drejtoria e Policisë në Bashkësi dhe Parandalim, gjatë vitit 2022 në bashkëpunim më të gjitha Drejtoritë Rajonale të Policisë ka mbajtur 107 ligjerata për parandalimin dhe pasojat nga substancat narkotike, duke përfshirë shkolla të ndryshme në nivel vendi.<br>Poashtu është mbajtur kampi treditor në Prevallë me të rinjë pjesëmarrës nga qytetet: Prishtinë, Mitrovicë dhe Prizren, ku është diskutuar për pasojat nga përdorimi i substancave narkotike.<br><br>**NJKDNJ në Kamenicë, në bashkëpunim me Policinë e Kosovës gjatë gjithë vitit organizon fushata sensibizilues dhe ligjërata nëpër shkolla sa i përket parandalimit të dukurive negative, abuzimit me substanca narkotike si dhe pasojave nga përdorimi i tyre..** |
| III.4. 8 | Ministria e Drejtësisë të përkujdeset që të varurit nga | Në vazhdi mësi | Buxheti i Kosovës | MD<br>Shërbimi Korrektues i Kosovës | Personat e varur nga narkotikët kanë marrë | Shërbimi i kujdesit shëndetësor në burgjet e Republikës së Kosovës organizohet dhe funksionon si pjesë integrale e sistemit shëndetësor të vendit.<br>Shërbimi shëndetësor që funksionon në burgje të cilat janë nën autoritetin e |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | narkotikët të cilët janë në vuajtje të dënimit nëpër qendra korrektuese (burgje) të marrin tretmanin e duhur për varësinë e tyre. | | | Shërbimi Sprovues i Kosovës OJQ "Labyrinth" | tretmanin e duhur<br><br>Numri i personave të cilët kanë marrë shërbime<br><br>Të paktën 30 persona të varur nga narkotikët kanë marrë shërbimet dhe tretmanin e duhur | Ministrisë së Drejtësisë, për shkak të specifikave organizohet dhe mbikëqyret nga Departamenti Shëndetësor i Burgjeve (DSHB) në Ministrinë e Shëndetësisë.<br><br>Në të gjitha Njësitë shëndetësore të burgjeve ka trajtim të personave dhe program të mirëmbajtjes me terapi me metadon<br>Gjatë vitit 2021 janë trajtuar 684 persona me sëmundje të varësisë.<br>Gjatë vitit 2022 janë trajtuar 683 persona me sëmundje të varësisë.<br>. |
| **IV.** | **Objektivi strategjik: Lehtësimi i Qasjes në Sistemin e Drejtësisë;** | | | | | |
| **IV.1** | **Objektivi specifik:Rritja e efikasitetit të trajtimit të lëndëve nga gjykatat dhe prokurorit** | | | | | Progresi në zbatim |
| IV.1.1 | Reduktimi dhe zgjidhja e lëndëve të vjetra, përmes përfshirjes së profesioneve të lira ligjore, ku përfshihen ndërmjetësuesit, noterët e përmbaruesit privat | 2021-2023 | Buxheti Donatorët | Ministria e Drejtësisë, Departamenti për profesione të lira<br>KGJK<br>KPK<br>USAID<br>UNDP | Përfshirja e profesioneve të lira ligjore në zgjidhjen e këtyre lëndëve në mënyrë që ky numër i madh i lendeve të vjetra të zgjidhet sa më parë. | Reduktimi dhe zgjedhja e lëndëve të vjetra, përmes përfshirjes së profesioneve të lira ligjore, ku përfshihen ndërmjetësimi, noterët e përmbaruesit privat.<br>Numri aktual është gjithsejtë 55 (pesëdhjetë e pesë) Noterë;<br>• Në vitin 2021 gjithsejtë janë përpiluar/hartuar 619,570 vërtetime/akte, prej tyre 468,813 vërtetime noteriale si dhe 150,757 akte noteriale, këto të dhëna janë sipas raportit vjetor për vitin 2021 të Odes së Noterëve .<br>Përmbarues Privat, numri aktual është gjithsejtë 39 (tridhjetë e nëntë);<br>Ne vitin 2021 sips raporteve të Përmbaruesve Privat gjithsejtë janë si në vijim:<br>- Numri i lëndëve të pranuara është 27,033<br>- Numri i lëndëve të zgjidhura është 19,625<br><br>Këshilli Gjyqësor i Kosovës në vazhdimësi ka promovuar përdorimin e Ndërmjetësimit si metodë alternative për zgjidhjen e kontesteve gjyqësore. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| IV.1. 2 | Ndërmarrja e nismës legjislative për propozimin e ligjit për mbrojtjen e së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm kohor ,me të cilin do të përcaktoheshin mjetet juridike për rastet që kane te bëjnë me zvarritjen e procedurave gjyqësore në pajtim me instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut | 2022 | Buxheti Donatorët | MD | Janë përcaktuar mjetet efektive juridike për rastet që kanë të bëjnë me zvarritjen e procedurave gjygjësore, në pajtim me instrumentet ndërkombëtare për të drejtat dhe liritë e njeriut ,me qëllim të parandalimit të shkeljes apo në formë të kompenzimit | MD është duke e finalizuar draftin e Koncept dokumentit për realizimin e të drejtave civile, përfshirë të drejtën e palëve në gjykim brenda kohës së arsyeshme, janë mbajtur dy punëtori me përkrahjen e Programit për Drejtësi - EUKOJUST janë angazhuar dy ekspert vendor, posa të finalizohet drafti do të shpërndahet për konsultime paraprake, MD është duke punuar qe brenda këtij viti të procedohet në Qeveri për shqyrtim dhe miratim. |
| IV.1. 3 | Të zvogëlohet numri i parashkrimit të lendeve të qytetarëve në gjykata dhe prokurori | Në vazhdi mësi | Buxheti i Kosovës | KGJK KPK | Eshët zvogëluar numri i parashkrimit të lëndëve në gjykata dhe prokurori | KGJK në vazhdimësi ka ndërmarr veprime për zvogëlimin e lëndëve, duke shtuar numrin e gjyqtarëve të ri duke bërë rekrutimin e 49 gjyqtarëve dhe shtimin e stafit mbështetëses, po ashtu Kgjk-ja ka miratuar Planin strategjik për përmirësimin e qasjes në drejtësi 2022-2025 efikasiteti dhe prioritizimi i lëndëve brenda sistemit gjyqësor, ku do tu jepet prioritet lëndëve që janë afër parashkrimit. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| IV.1. 4 | Këshillat, duhet të hetojnë në thellësi shkaqet e parashkrimit të lëndëve për çdo rast, pa asnjë përjashtim dhe të inicojnë procedura përkatëse ndaj përgjegjësve që kanë lejuar parashkrimin e lëndëve gjyqësore | Në vazhdi mësi | Buxheti i Kosovës | KGJK KPK | Numri i hetimeve të ndërmarra dhe masave të iniciuara dhe të shqiptuara lidhur me rastet e parashkrimit të lëndëve në gjykata dhe prokurori | KGJK në vazhdimësi i shqyrton kërkesat për inicimin e procedurave disiplinore që vijnë nga Autoritetet Kompetente konform Ligjit Nr. 06/L-057 për përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve |
| IV.1. 5 | Të sigurohet qasje në drejtësi për qytetarët që nuk kane mjete të mjaftueshme financiare, veçanërisht për viktimat e dhunës në baza gjinore, dhunës seksuale, komuniteteve jo-shumicë dhe personat e zhvendosur | Në vazhdi mësi | Buxheti i Kosovës Donatorët | Agjencia për Ndihme Juridike falas si dhe OJQ-të e specializua ra (CLARD) etj. | Numri i qytetarëve të cilët kanë përfituar shërbime falas për qasje në drejtësi, i ndarë sipas etnisë dhe gjinisë së përfituesve; | Agjencia për Ndihmë Juridike Falas në vazhdimësi ka bërë përpjekje për sigurimin e qasjesjes në drejtësi për qytetarët që nuk kane mjete të mjaftueshme financiare, veçanërisht për viktimat e dhunës në baza gjinore, dhunës seksuale, komuniteteve jo-shumicë dhe personat e zhvendosur. Gjatë vitit 2021 ndihmë juridike falas kanë përfituar 4599 qytetarë dhe janë ofruar 5006 veprime juridike, prej tyre te avokatët janë referuar 467 përfitues. Ndihmën juridike falas e kanë përfituar 1981<br>femrave dhe 2618<br>meshkuj. Sa i përket komuniteteve, ndihma juridike falas në vitin 2021 u është ofruar 643 qytetarëve të komuniteteve pakicë.<br>veprimet juridike u janë drejtuar institucioneve dhe organeve shtetërore si në vijim:<br>Gjykatave – 2255 veprime juridike<br>Komunave dhe organeve komunale - 747 veprime juridike<br>Ministrive dhe organeve ministrore - 1214 veprime juridike<br>Organeve tjera publike dhe private - 323 veprime juridike. |
| IV.1. 6 | Të sigurohet financim i qëndueshëm dhe prania e Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas (Agjencia) në të | 2021/20 23 | Buxheti i Kosovës Donatorët | Agjencia për Ndihme Juridike falas si dhe OJQ-të e specializua ra | Është rrit numri i zyrtarëve për ndihmë juridike në zyrat rajonale të Agjencisë | Gjatë vitit 2021-22, Ndihma Juridike Falas është ofruar nëpërmjet 7 (shtatë) zyrave rajonale për ndihmë juridike falas të cilat funksionojnë në: ZRNJF Prishtinë, Mitrovicë, Pejë, Prizren, Gjilan, Gjakovë dhe Ferizaj dhe përmes 14 zyrave mobile të cilat funksionojnë në komunat në vijim: Fushë Kosovë, Drenas, Deçan, Istog, Suharekë, Dragash, Mitrovicë Veriore, Zveçan, Leposaviq, Zubin Potok, Malishevë, Graçanicë, Skënderaj dhe Kamenicë. Këto zyra financohen nga buxheti i Republikës së Kosovës.<br>Ndihma juridike falas ofrohet edhe përmes 6 zyrave mobile të përkrahura |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | gjitha komunat, përmes rritjes së numrit të zyrtarëve për ndihmë juridike në zyrat e saj rajonale; | | | (CLARD) etj. | | financiarisht nga GIZ-i të cilat funksionojnë në komunat: Podujevë, Klinë, Lipjan, Shtime, Kaçanik dhe Hani i Elezit, duke mundësuar punësimin e 4 zyrtarëve të cilët do ofrojnë ndihmën juridike falas. Poashtu ndihma juridike falas ofrohet edhe përmes Klinikës Mobile Lëvizëse e përkrahur financiarisht nga UNDP, e cila funksionon në komunat ku nuk ka zyrë rajonale dhe zyrë mobile për ndihmë juridike falas dhe në rajonet me të thella të Republikës së Kosovës.<br>ANJF nuk e ka përmbushur në mënyrë të plotë nenin 22 të Ligjit për Ndihmë Juridike Falas ku për të arritur mbulueshmëri të plotë në tërë territorin e Republikës së Kosovës, parashihet hapja e Zyrave Mobile në të gjitha komunat e Kosovës.<br>**Kërkesa buxhetore e ANJF-së për të hapur Zyrat Mobile edhe në 6 komuna nuk ka hasur ende në përkrahje** |
| IV.1.7 | Të sigurohet një numër më i madh i përfaqësimeve në gjykata, përmes financimit të qëndrueshëm. | 2021/2023 | Buxheti i Kosovës Donatorët | Agjencia për Ndihmë Juridike falas si dhe OJQ-të e specializuara (CLARD) etj. | Është rritë numri i përfaqësimit të palëve në gjykata | Në vitin 2020 ka pasur rritje të numrit të avokatëve të angazhuar krahasuar me vitin 2019 dhe prej 335 lëndëve, me sukses janë përfunduar 53 lëndë dhe 1 pa sukses. Në vitin 2021 ka pasur rritje të numrit të avokatëve të angazhuar dhe prej 467 lëndëve, me sukses janë përfunduar 30 lëndë, ndërsa për 5 lëndë është ndërprerë procedura. Nga viti në vit, numri i përfaqësimit në gjykata është duke u ngritur në vazhdimësi. |
| IV.1.8 | Të sigurohen lehtësira për qasjen në sistemin e drejtësise për azilkërkuesit, refugjatët, personat pa shtetësi, duke ju siguruar përkthim adekuat institucional në gjuhët zyrtare dhe gjuhën të cilën e kuptojnë. | Në vazhdimësi | Buxheti i Kosovës Donatorët | KGJK KPK | Numri i shërbimeve të përkthimit të ofruara<br><br>Numri i personave të cilët kanë përfituar shërbime të përkthimit në gjuhën e tyre | KGJK-ja ka krijuar lehtësirat për përdorimin e Gjuhëve, ka bërë licesimin e përkthyeseve dhe intepretëve gjyqësor, procesi i cili ka qenë i mbikëqyrur edhe nga partnerët ndërkombëtar. |

| IV.2 | **Objektivi specifik: Funksionimi i Sistemit të ndërmjetësimit;** | | | | | Progresi në zbatim |
|---|---|---|---|---|---|---|
| IV.2.1 | Organizimi i kampanjave vetëdijesuese për të informuar qytetaret për mundësinë e shfrytëzimit të ndërmjetësimit, si dhe promovimin e procesit të ndërmjetësimit | 2021-2022 | Buxheti i Kosovës Donatorët | **MD** KGJK Këshilli Prokurorial i Kosovës, | Aktivitetet promovuese të realizuara lidhur me ndërgjegjësimin e publikut për ndërmjetësim dhe qendrat e ndërmjetësimit; | KGJK-ja në bashkëpunim me USAID është duke e bërë promovimin e Ndërmjetësimit përmes mjeteve të informimit, rrjeteve sociale dhe broshurave. |
| IV.2.2 | Të promovohet dhe ofrohet ndërmjetësimi si mjet i **zgjidhjeve alternative të mosmarrëveshjeve** për të gjitha kategoritë e rrezikuara komfor legjislacionit në fuqi, si dhe të sigurohet kompensim dhe financim adekuat për këtë shërbim | 2021-2023 | Buxheti i Kosovś Donatorët | MD KGJK Këshilli Prokurorial i Kosovës, | Është siguruar buxhet i nevojshëm për funksionimin e shërbimit te ndërmjetësimit<br><br>Numri i përfituesve nga ndërmjetësimi si mjet i zgjidhjeve alternative të mosmarrëveshjeve | Gjatë vitit 2021 janë miratuar dy Udhëzime Administrative per ndërmjetësimin,<br>- Udhëzimi Administrativ MD-Nr. 05/2021 për përcaktimin e procedurës së ndërmjetësimit të vetinicimit të rasteve dhe rasteve të referuara nga organi administrativ,<br>- Udhëzim Administrativ MD-Nr. 4/2021 Për tarifën e ndërmjetësuesve në Republikën e Kosovës.<br>Statistikat e rasteve në procedurën e ndërmjetësimit për vitin 2021 të referuara nga gjykatat dhe prokuroritë themelore.<br><br>Rastet e referuara nga gjykatat;<br>Rastet penale kane qene gjithësej 2232 raste, prej tyre të zgjedhura 1830, të pa zgjidhura 383 në procedur19.<br>Rastet civile, kane qene gjithse 887raste, prej tyre të zgjedhura kane qene 642, të pa zgjedhura 222, ne procedur 23.<br><br>Totali i 3119.<br><br>Rastet e referuara nga prokurorit ne vitin 2021 kane qene 2315, prejt tyre janë zgjedhur 1765 raste, te pa zgjedhura 308 raste dhe ne pune 240 raste. |
| IV.2.3 | Aty ku është e përshtatshme, mekanizmat e | 2021-2023 | Buxheti i Kosovës Donatorët | Prokurori i shtetit për të mitur | Drejtësia restauruese, një qasje | Të dhënat lidhur me drejtësinë restauruse janë duke u përpunuar nga Qendra Edukuese Korrektues për të Mitur. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | zgjidhjeve informale të mosmarrëveshjeve e në rastet e fëmijëve shkelës të ligjit duhet të përdoren, duke përfshirë këtu *zbatimin e masave të ndërmjetësimit dhe praktikës restauruese*[6] *për të miturit në konflikt me ligjin* | | | Shërbimi Korrektues dhe Shërbimi Sprovues i Kosovës MD ANJF OJQ-të që ofrojnë ndihme juridike falas | alternative në zgjidhjen e pasojave që vijnë nga kryerja e një vepre penale është promovuar | |
| **IV.3** | **Objektivi specifik: Përmirësimi i zbatimit të drejtës për ndihmë juridike falas;** | | | | | Progresi në zbatim |
| IV.3. 1 | Informimi dhe ndërgjegjësimi i publikut në lidhje me ushtrimin e së drejtës për ndihmë juridike falas, në mënyrë që të sigurohet qasje efikase në drejtësi për qytetarët që nuk kanë burime të mjaftueshme financiare. | 2021-2023 | Buxheti i Kosovës Donatorët | Agjencia për ndihmë juridike falas (ANJF) Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit | Është rritur vetëdijesimi i qytetarëve lidhur me realizimin e të drejtës në ndihme juridike falas përmes formave dhe aktiviteteve të ndryshme të promovimit | Agjencia për ndihmë juridike falas (ANJF), përkundës mungesës së mjeteve buxhetore, gjatë vitit 2021-22, në vazhdimësi ka mbajtur fushata vetëdijesuese të formave të ndryshme në komuna të ndryshme të Kosovës dhe të gjitha janë realizuar me mbështetjen e donatorëve. Si rezultat i këtyre fushatave është regjistruar numër më i madh i përfituesve të ndihmës juridike falas.<br>Të gjitha zyrat në përgjithësi gjatë vitit 2021 i kanë ofruar ndihmë juridike falas **4599** (katërmijë e pesëqind e nëntëdhjetë e nëntë) qytetarëve. |
| IV.3. | Të rritet në | 2021- | Buxheti i | Qeveria e | Është siguruar | ANJF me të gjitha të arriturat në ofrimin e shërbimeve juridike për |

[6] Drejtësia restauruese është një qasje ndaj krimit, e cila njeh pasojat e krimit mbi viktimën, komunitetin në të cilin është kryer krimi dhe shkelësin.Fokusi i saj parësor është të riparojë dëmin e shkaktuar nga shkelja, të zhdëmtojë komunitetin dhe viktimën, si dhe t'i ofrojë kundërvajtësit mundësinë për të dhënë kontributin e tij/saj pozitiv për komunitetin

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 2 | mënyrë substanciale buxheti për programin e ndihmës juridike falas. | 2022 | Kosovës Donatorët | Kosovës MFPT ANJF | buxhet i nevojshme për ofrim cilësor të ndihmës juridike falas | qytetarët, është përcjellë edhe me sfida të ndryshme. Sfidat me të cilat është përballur ANJF, janë si pasojë e buxhetit të pamjaftueshëm për arritjen e objektivave në mënyrë të plotë.<br>Poashtu plotësim ndryshimi i Ligjit për Ndihmë Juridike Falas ka rritur gamën e përfituesve të ndihmës jurdike falas, e që njëkohësisht rritet edhe nevoja për buxhet shtesë. Duke pasur parasysh se buxheti aktual i ndarë për ANJF është i ulët, me zgjerimin e gamës së përfituesve të ndihmës juridike falas do të hasim në vështirësi në zbatimin e Ligjit për Ndihmë Juridike Falas në rast se nuk kemi përkrahje buxhetore.<br>Për të arritur përmbushjen e obligimit ligjor në vazhdimësi përmes kërkesave buxhetore, kemi apeluar për të siguruar buxhetin e nevojshëm për hapjen e Zyrave Mobile, mirëpo në ligjin e buxhetit të vitit 2022 nuk është ndarë buxhet për të siguruar shtrirjen e ndihmës juridike falas në tërë territorin e Republikës së Kosovës. |
| IV.3. 3 | Të rritet bashkëpunimi ndërmjet Agjensionit për Ndihme Juridike falas dhe Organizatave Joqeveritare të cilat ofrojnë Ndihme Juridike falas | Në vazhdi mësi | Buxheti i Kosovës Donatorët | Agjencioni për Ndihmë Juridike Falas Zyrat rajonale për ndihmë juridike falas OJQ-të që ofrojnë ndihme juridike falas | Marrëveshjet e mirëkuptimi të arritura ndërmjet Agjensionit për Ndihme Juridike falas dhe Organizatave Joqeveritare të cilat ofrojnë Ndihme Juridike falas | Me miratimin e Rregullores për përcaktimin e kritereve për ofrimin e ndihmës juridike falas nga organizatat joqeveritare përmes partneritetit me Agjencine për ndihme juridike falas në Kosove, jemi në fazën e implentimit të rregullores në drejtim të ofrimit të ndihmës juridike falas nga OJQ, ndërsa sa i përket bashkëpunimit në fusha tjera, ANJF ka Memorandum të Mirëkuptimit me disa OJQ dhe ka qenë e hapur për bashkëpunim. |
| IV.3. 4 | OJQ-të ofrojnë shërbime juridike të autorizuara në bazë të kritereve të përcaktuara nga Këshilli, me propozim të Drejtorit të Agjencisë për Ndihmë Juridike | 2021-2022 | Buxheti i Kosovës Donatorët | Agjencioni për Ndihmë Juridike Falas OJQ-të që ofrojnë ndihme juridike falas | Kriteret janë të përcaktuara dhe shërbimet ofrohen komfor kritereve | Rregullorja për përcaktimin e kritereve për ofrimin e ndihmës juridike falas nga organizatat joqeveritare përmes partneritetit me Agjencine për ndihme juridike falas në Kosovë ka hy në fuqi, andaj kriteret janë të përcaktuara dhe jemi në fazën e implentimit të rregullores. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | falas | | | | | |
| **IV.4** | **Objektivi specifik: Lehtësimi i barrierave për mbrojtjen e viktimave të krimit, në veçanti për të mbijetuarit e dhunës me bazë gjinore, përfshirë dhunën në familje;** Progresi në zbatim | | | | | |
| IV.4. 1 | Të raportohet mbi financimin e qëndrueshëm për programin e kompensimit të viktimave të krimit, të paraparë në Ligji Nr. 05/L - 036 për kompensimin e viktimave të krimit; | 2021-2023 | Buxheti i Kosovës Donatorët | **MD** Komisioni për kompensimin e viktimës së krimit KPK KGJK Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave Zyrat për ndihmë juridike falas OJQ-të që ofrojnë ndihmë juridike falas për viktima. | Është zbatuar Ligji Nr. 05/L -036 për kompensimin e viktimave të krimit, si dhe është bërë kompensimi i viktimave komfor dëmit të shkaktuar<br><br>Numri i viktimave të cilët/at kanë përfituar kompensim konform Ligjit Nr. 05/L -036 për kompensimin e viktimave të krimit | KGJK-ja ka kodin buxhetor i cili i mbledh të hyrat që realizohen nga kjo lëmi, vlera për vitin 2021, ka qenë mbi **222.000 Euro**, të cilat të hyra raportohen në Thesar dhe në Ministrinë e Drejtësisë.<br><br>Sa i përket programit për kompensimin e viktimave, shuma për vitin 2022 ka qene **234.085 Euro,**<br><br>Ne vitin 2021, 28 viktima kane përfituar nga programin për kompenzimin. Ne periudhën Janar-Gusht 2022, 16 viktima kanë përfituar . |
| IV.4. 2 | Zbutja e pengesave për mbrojtjen e | 2021/2022 | Buxheti i Kosovës Donatorët | **MD** Komisioni për | Është amandamentuar dhe | Është bërë plotësim-ndryshimi i ligjit për kompensimin e viktimave të krimit dhe është ne proces të miratimit në Kuvend.Rrjeti i institucioneve që ofrojn shërbime për viktimat e krimit informojn viktimat në të drejtën e tyre |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | viktimave të krimit, konform detyrimeve ligjore të institucioneve përkatëse | | | kompensimin e viktimës së krimit<br>KPK<br>KGJK<br>Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave<br>Zyrat për ndihmë juridike falas<br>Institucionet shëndetësore dhe të kujdesit shoqëror<br>Policia<br>OJQ-të që ofrojnë ndihmë juridike falas për viktima. | aprovuar Ligji për Kompenzimin e Viktimave të krimit<br><br>Instucionet kompetente që vijnë në kontakt me viktimën i informojnë me kohë viktimat lidhur me të drejtën e kompenzimit në përputhje me detyrimet ligjore | ne kompensim.<br><br>KGJK-ja, përkatësisht gjykatat në vazhdimësi bëjn trajtimin e viktimave të krimit konform detyrimeve ligjore të institucionit përkatës.<br>Gjykatat bëjnë trajtimin e të gjitha palëve dhe pjesëmarrëseve në procedura penale duke i respektuar parimet e parapara në Kushtetutë, Konvetat Ndërkombëtare dhe legjislacionin penal.<br><br>Policia e Kosoves ka në përdorim kartelën e viktimave ku viktima njoftohet me disa inforamta qysh nga momenti i hapjes se rastit dhe për viktimat e dhunës në familje dhe viktimat tjera të cilat kanë drejt kompenzimi sipas legjislacionit në fuqi njoftohen çdo herë nga zyrtarër policor.Në kartelën elktronike është edhe **pika** për njoftimin e viktimës së krimit për të drejtën e kompenzimit sipas ligjit.<br>Në momentin e parë kur një viktimë referohet në Drejtorine për Hetimin e trafikimit me njerëz(DHTNJ) brenda dy (2) orësh mbildhet ekipi që nënkupton hetuesi nga DHTQNJ, mbrojtësi i viktimave dhe zyrtari nga QPS kur kemi të bëjmë me fëmijë. Në prezenc të këtyre zyrtarëve plotësohet forma mbi të drejtat e viktimës ku ndër tjera është edhe njoftimi për të drejtën e kompenzimit dhe e njejta formë nënshkruhet nga të gjithë personat prezent. Në këtë takim fillestar caktohet edhe menaxheri i rastit, ku në rastet kur viktima është fëmijë caktohet zyrtari nga QPS ndërsa kur kemi të bëjmë me të rritur caktohet mbrojtësi i viktimave, ky i fundit merret edhe me asistimin e viktimës në adresimin e kërkesës për kompenzim. |
| IV.4.3 | Të sigurohet mbështetje në realizimin e të drejtës për kompensim për fëmijët, gratë dhe viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore. | Në vazhdimësi | Buxheti i Kosovës Mjetet nga Programi për kompensimin e viktimave te krimit që kap | MD<br>MFPT<br>MPBAL | Numri i përgjithshëm i parashtruesve të kërkesave; numri i parashtruesve të kërkesave që u është mohuar kompensimi; numrin i | Në vitin 2021 janë pranuar 58 kerksea.<br>- 28 kerkesa janë refuzuar<br>- 28 janë aprovuar<br>- 2 në punë.<br>Vlera totale e kompenzimit 102.554 euro<br>• Gjatë periudhës Janar-Gusht 2022 janë refuzuar 15 kërkesa.<br>• Gjatë periudhës Janar-Gusht 2022 janë aprovuar 16 kërkesa.<br>Vlera e Kompensimit deri më tani është **54.306.00 euro** |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | buxhet në shumën prej afër 100.000 euro, që ekziston si linjë e rregullt buxhetore | | parashtruesve të kërkesave që u është dhënë kompensimi; shumën e kompensimit, të dhënë parashtruesve të kërkesave, | |
| IV.4.4 | Me qëllim të informomit të opinionit publik, të organizohen dhe mbahen aktiviete promovuese për promovimin e Programit për kompensimin e viktimave të krimit[7] | Në vazhdi mësi | Buxheti i Kosovës Donatorët | MD Komisioni për kompensimin e viktimës së krimit | Është promovuar e drejta për kompenzimin e viktimave të krimit, përmes kampanjave vetdijësuese, debateve apo formave tjera të promovimit. | Janë përditësuar informacionet ne linkun e web faqes së MD-së.<br>Së bashku me perfaqsusesn e ambasadës së SHBA-së kemi hartuar pano informuese e cila është vendosur në të gjitha institucionet që mund të jenë në kontakt me viktimat e krimit.<br>Në muajin Shkurt 2022 është mbajtur konferenca rajonale për të drejtat e viktimave dhe kompensimin e viktimave ë krimit.<br>Në muajin Mars 2022 kemi realizuar sesione informuese me Oden e Avokatëve për ligjin e kompensimit të viktimave të krimit. Po ashtu kemi organizuar sesione online me zyrat për mbrojtjen e viktimave të krimit ku jan diskutuar sfidat, veshtirësit dhe arritjet ne fushën e kompensimit të viktimave të krimit.<br>Policia e Kosovës; Policia e Kosoves ka në përdorim kartelën e viktimave ku viktima njoftohet me disa inforamta qysh nga momenti i hapjes se rastit dhe për viktimat e dhunës në familje dhe viktimat tjera të cilat kanë drejt kompenzimi sipas legjislacionit ne fuqi njoftohen çdo herë nga zyrtarër policor. Per më detaish ne do te ju përcjellim edhe kartelën elktronike në të cilën është edhe pika për njoftimin e viktimës së krimit për të drejtën e kompenzimit sipas ligjit.<br>Në momentin e parë kur një viktimë referohet në Drejtorine për Hetimin e trafikimit me njerz (DHTNJ) brenda dy (2) orësh mbildhet ekipi që nënkupton hetuesi nga DHTQNJ, mbrojtësi i viktimave dhe zyrtari nga QPS kur kemi të bëjmë me fëmijë. Në prezenc të këtyre zyrtarëve plotësohet forma mbi të drejtat e viktimës ku ndër tjera është edhe njoftimi për të drejtën e kompenzimit dhe e njejta formë nënshkruhet nga të gjithë personat prezent. Në këtë takim fillestar caktohet edhe menaxheri i rastit, ku në rastet |

[7] Ligji i Kosovës 05 / L-036 për kompensimin e viktimave të krimit rregullon të drejtën për kompensim për viktimat e krimeve të dhunshme si dhe të varurit e tyre. Ligji u miratua në 2015 duke renditur krimet e dhunshme që kompensohen nga fondi i kompensimit të viktimave.Krimet që duhet të kompensohen përfshijnë: trafikimin e qenieve njerëzore, përdhunimin, abuzimin seksual të fëmijëve, vrasjen,dhe krimet e dhunës në familje siç përcaktohen në ligjin për mbrojtjen nga familja Dhuna.

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | kur viktima është fëmijë caktohet zyrtari nga QPS ndërsa kur kemi të bëjmë me të rritur caktohet mbrojtësi i viktimave, ky i fundit merret edhe me asistimin e viktimës në adresimin e kërkesës për kompenzim. |
| IV.4. 5 | Vlerësimi i respektimit të të drejtave të njeriut në proceset gjyqësore penale në Kosovë | Në vazhdi mësi | Buxheti i Kosovës | KGJK KGJK QKRMT | Respektimi i të drejtave të burgosurve konform standardeve të përcaktuar me legjislacionin në fuqi dhe standardet ndërkombëtar e për të drejtat e njeriut | Gjykatat bëjnë trajtimin e të gjitha palëve dhe pjesëmarrëseve në procedura penale duke i respektuar parimet e parapara në Kushtetutë, Konvetat Ndërkombëtare dhe legjislacionin penal. |
| IV.4. 6 | Të sigurohet dhe ofrohet qasje në drejtësi për viktimat e dhunës seksuale gjatë luftës | Në vazhdi mësi | Buxheti Donatorët | Komisioni qeveritar për njohjen dhe verifikimin e statusit të personave të dhunuar gjatë luftës së fundit në Kosovë Prokurorit Gjykatat | Numri i kallëzimeve penale dhe aktakuzave të ngritura për dhunën seksuale gjatë luftës | Nga të dhënat e siguruara nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës (PSRK) , rezulton se numri i rasteve në procedim për viktimat e dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë, është si në vijim:<br><br>**50 –viktima të dhunës seksuale**<br>**(**48 raste për gjininë femërore)<br>( 2 raset për gjininë mashkullore**).** |
| **IV.5** | **Objektivi specifik: Realizimi i të drejtave pronësore dhe trashëgimore të grave, të drejtave pronësore të komuniteteve dhe të PZH-ve**<br><br>Progresi në zbatim | | | | | |
| IV.5. 1 | Regjistrimi i pronës së përbashkët në | 2021-2023 | Nuk ka kosto shtesë | **Agjencia Kadastral e e Kosovës** | Prona e përbashkët e regjistruar në emrin e të dy | Sipas MAPL, në emër të dy bashkëshortëve në 25 komuna janë të regjistruar 3380 prona, ndërsa në 13 komuna (Vushtrri, Ranillug, Deçan, Pejë, Leposaviq, Shtërpcë, Mitrovicë e Veriut, Mitrovicë Jugore, Partesh, Zveçan, Hani Elezit, Zubin Potok, Graçanicë) nuk janë ofru informacione. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | emrin e të dy bashkëshortëve | | | **(AKK)** Komunat ABGJ | bashkëshortëve | Nga Agjencia Kadastrale e Kosovës, kanë bërë të ditur se, duke përfshirë pronësitë individuale dhe ato që i kanë në bashkëpronësi, numri i pronave të regjistruara në emër të grave në Kosovë është mbi 138 mijë sosh.<br>Numri i njësive kadastrale të regjistruara me të drejtën e pronës apo posedim i përbashkët në Kosovë tani është 12 mijë e 158, teksa vetëm rreth një vit më parë ky numër nuk arrinte as 8 mijëshin.<br>Në dhjetor të vitit 2020, ishin 7 mijë e 417 prona në Kosovë të regjistruara si prona të përbashkëta të bashkëshortëve.<br>Ndërkaq ky numër është rritur dukshëm gjatë vitit 2021, ose më saktësisht është rritur për 4 mijë e 741 prona më shumë në shkurt të vitit 2022, sesa që ishin në dhjetor të 2020. |
| IV.5. 2 | Organizimi i fushatave vetëdijësuese për të drejtën në trashëgimi dhe pronë | 2021-2023 | Buxheti Financimi i Donatorëve | **MD, ABGJ,** Komunat MPL | Fushatat dhe aktivitete promovuese të realizuara | MAPL, Lidhur me zbatimin e të drejtave pronësore të grave në 26 komuna kanë ndërmarr veprime me qëllim të rritjes së ndërgjegjësimit dhe përmirësimit për të drejtat pronësore të grave: janë zhvilluar aktivitete me gratë e viseve rurale, lirimi i grave nga taksat komunale për regjistrimin e pronës së përbashkët, takime me grupe të grave dhe punëtori, janë shpërndarë postera dhe fletushka, janë vendosur postera nëpër vende të frekuentuara, janë organizuar fushata ndërgjegjësuese lidhur me Udhëzimin Administrativ (QRK) Nr. 02/2020 për masat e veçanta për regjistrimin e pronës së paluajtshme të përbashkët në emër të të dy bashkëshorteve kurse në 12 komuna (Gjakova , Zubin Potok, Shtime, Suhareka, Obiliq, Shtërpcë, Peja, Mitrovica e Veriut, Istog, Mitrovica e Jugut, Zveçan, Hani Elezit ) nuk janë ndërmarr veprime.. |
| IV.5. 3 | Të realizohen të drejtat pronësore të komuniteteve dhe të PZH-ve përmes Zbatim te vendimeve të plotfuqishmetë vendosura nga AKKVP-së (apo organi pasues) | 2021-2023 | Buxheti Financimi i Donatorëve | Sekretaria Ekzekutive e AKKVP-së Policia e Kosovës | Kthimi i të drejtave pronësore të komuniteteve dhe të PZH-ve, si rezultat i zbatimit të vendimeve të AKKVP-ja<br><br>Numri i vendimeve të plotëfuqishme të zbatuara | Sipas te dhënave te siguruara nga të gjitha Drejtorit Rajonale të Policisë -të gjatë vitit 2021 në 8 raste janë realizuar të drejtat pronësore .<br><br>Numri total i vendimeve të zbatuara është 281, prej tyre janë: Kërkesa për mbyllje 100; Kontrata e verifikuar e shitblerjes në organet kompetente 1; Kërkesa mosbashkëpunim 79;<br>Kërkesa për riposedim –lënde me AKP janë 2; Kërkesa per shkatërrim janë |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | 1; Kërkesa për administrim 13; |
| IV.5. 4 | AKKVP-ja duhet të zbatoj urdhrat për dëbim sipas kompetencave ekzekutive të AKKVP-së, si dhe duhet të lehtësojë bartjen dhe largimin eventual të uzurpuesve | 2021-2023 | Nuk ka kosto shtesë | AKKVP-së Policia e Kosoves | Numri i urdhërave të zbatura për dëbim, qoftë të pronave të uzurpuara apo ato të cilat janë ri uzurpuar<br><br>*Dëbimi i uzurpuesve të paligjshëm nga pronat përkatëse sipas kompetencave ekzekutive të Agjencisë* | Gjatë periudhës raportuese janë ekzekutuar gjithsej 20 dëbime të uzurpuesve të paligjshme nga 63 kërkesa aktive apo 20%. Edhe gjatë periudhës raportuese numri i dëbimeve në pritje në pjesën veriore të Mitrovicës mbetet 40. Për shkaqe të situatës së sigurisë në atë pjesë, Agjencia përkundër tentimeve në vazhdimësi, nuk ka mundur të bëjë dëbimet e planifikuara. Kjo rezulton në përqindje më të ulët sesa ajo prej 40% të planifikuar.<br><br>Policia e Kosovës ka asistuar organet përgjegjëse në:<br>25 raste janë ku janë zbatuar urdhëratë për dëbim<br><br>26 Raste dëbim i uzurpuesve dhe<br><br>2 Raste janë në prokurori<br><br>Të dhëat nga AKKVP .Gjatë periudhës 01 Janar 2021 – 31 Dhjetor 2021, Njësia për zbatim ka aranzhuar gjithsejt 33 kërkesa (Urdhër për Dëbim), prej tyre janë ekzekutuar 29 raste:<br>Gjilan: 3, Pejë: 5, Prishtine: 14 (1 raste është ri-uzurpuar serish), Prizren: 1, Mitrovicën Jugore: 4, Mitrovicën Veriore: 2, ndërsa 2 raste në MI/Veri dhe 2 raste në Prishtinë janë pezulluar përkohësisht. Gjatë periudhës raportuese 01 Janar 2021 – 31 Dhjetor 2021, Njësia për zbatim ka pranuar gjithsejt 41 kërkesa për riposedim (Urdhër për Dëbim). Si raste aktive deri me datën 31 Dhjetor 2021 janë 64 raste: Gjilan: 0, Pejë: 6, Prishtinë: 13, Prizren: 1, Mitrovicë Jugore: 6 dhe Mitrovicë Veriore: 38 |
| IV.5. 5 | Vendimet e Gjykatës Kushtetuese për çështjet e pronës duhet të respektohen plotësisht dhe të zbatohen me shpejtësi | 2022-2023 | Buxheti i Kosovës | Sekretaria Ekzekutive e AKKVP-së | Numri i vendimeve të zbatuara lidhur me të drejtat pronësore | Gjatë periudhës (1 korrik – 30 shtator 2022), Gjykata e ka njoftuar Prokurorinë e Shtetit për Mos përmbarimin e aktgjykimit të saj në rastin: 1. **KI90/16** (parashtrues: B.Jokić);<br>Aktgjykime të Gjykatës Supreme në total janë 41;<br>Raste të refuzuara janë 4. Sa i përket zbatimit të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese ende janë në pritje gjithsejt janë 5 kërkesa. Për 2 kërkesa kanë parashtruar kërkesë për shkatërrim, kurse 3 kërkesa pala është njoftuar se duhet të bëjë ndarjen fizike (ende nuk kemi konfirmim që pala ka përmbush obligimin). |
| IV.5. | Të zbatohen në | 2021- | Buxheti i | (AKKVP) | Pjesëtarët e | Të gjithë pjesëmarrësit në procedurat gjyqësore, para prokurorive, Policisë |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 6 | tërësi dispozitat nga Ligji Nr. 02/L-37 "për përdorimin e gjuhëve" për të siguruar se pjesëtarët e komuniteteve jo shumicë mund t'i qasen informatave dhe mund të marrin pjesë në të gjitha procedurat në të cilat preken të drejtat e tyre pronësore. | 2023 | Kosovës | Gjykatat Prokurorit Zyra për Qështje të komunitete ve Zyra e Komisione rit për Gjuhët | komuniteteve jo shumicë mund t'i qasen informatave dhe mund të marrin pjesë në të gjitha procedurat në të cilat preken të drejtat e tyre pronësore komfor dispozitave të përcaktuara me Ligji Nr. 02/L-37 "për përdorimin e gjuhëve | apo Shërbimit Korrektues të Kosovës, kanë të drejtë të përdorin gjuhët e tyre amtare. Përkthimin e siguron falas gjykata, përkatësisht organet e lartcekura.<br>Nuk është raportuar ndonjë akese lidhur me realizimin e kësaj të drejte në procedurat në të cilat preken të drejtat e tyre pronësore. |
| IV.5. 7 | Konform Rregullores për Kthimin e Personave të Zhvendosur dhe Zgjidhje të Qëndrueshme 01/2008 ,Qeveria të themelon Komisionin Qendror për Ankesa | 2021 | Buxheti i Kosovës | MKK ZKM MFPT MMPHI UNHCR | Qeveria ka marrë vendim për themelimin e Komisionit Qendror për Ankesa | Rregullorja (QRK) - NR. 01/2018 për kthimin e personave të zhvendosur dhe zgjidhjet e qëndrueshme është planifikuar të plotësohet/ndryshohet duke përfshirë edhe përbërjen dhe përgjegjësin e komisionit përkatës, andaj Komisioni nuk parashihet të themelohet deri në finalizimin e këtij procesi. |
| IV.5. 8 | ZKKK përgatit plan veprimet përkatëse në pajtueshmëri me prioritetet komunale, për t"i ndihmuar Komunës në | 2021/20 23 | Buxheti i Kosovës Donatorët | MKK Komunat ZKKK (Zyrat Komunale për Këthim dhe Komunitet | Numri i planeve të zhvilluara dhe aprovuara<br><br>Kategoria dhe numri i personave të | 1. Në 12 komuna është miratuar Plani Lokal i Veprimit për Integrimin e Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian, ndërsa në 19 komuna: Malishevë, Ranillug, Novobërdë, Zubin Potok, Suharekë, Pejë, Leposaviq, Shtërpcë, Mitrovicë e Veriu, Kamenicë, Mitrovicë e Jugut, Viti, Kllokot, Podujevë, Obiliq, Mamushë, Gjilan, Zveçan, Lipjan, nuk është hartuar ende si dhe në 7 komuna; Skenderaj, Dragash, Junik, Gllogoc, Kaçanik, Partesh, Hani Elezit, nuk kanë komunitet rom, ashkali dhe egjiptian.<br>**2.** Sa i përket projekteve të realizuara në 16 komuna: Fushë Kosovë, Lipjan, |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | përmbushjen e obligimeve të veta në lidhje me procesin e kthimit dhe të ri-integrimit në bazë të Rregullores për Zyrat Komunale për Komunitete dhe Kthim harton Planin e Veprimit Komunal për Kthim | | | e) MAPL UNHCR | cilët kanë përfituar | Gjakovë, Kamenicë, Malishevë, Mitrovica e Jugut, Obiliq, Podujevë, Prishtinë, Prizren, Shtime, Skenderaj, Ferizaj, Pejë, Rahovec dhe Klinë, janë ndërtuar 26 shtëpi, 12 shtëpi të rinovua ra, 1 Qendër për komunitetet, në infrastrukturë 24 projekte të realizuara (asfaltim, kanalizim, trotuare, ndriçim publik, puseta etj.), ndërsa 11,426 familje të ndihmuara me pako ushqimore, higjienike dhe veshmbathje, 202 familje të ndihmuara me dru zjarri sipas 16 komunave nga periudha raportuese.<br>**3.** Nga të dhënat e ofruara janë 20 komuna që kanë pasur qytetarë të kthyer: Dragash, Gllogoc, Junik, Fushë Kosovë, Kamenicë, Mitrovica e Jugut, Novobërdë, Prizren, Rahovec, Gjakovë, Deçan, Podujevë, Ranillug, Mamushë, Shtime, Klinë, Viti, Hani i Elezit, Obiliq, Lipjan, Pejë, Gjilan, Ferizaj, Malishevë, dhe Mitrovica e Veriut. Sipas përkatësisë etnike janë: 114 shqiptarë, 645 serb, 7 ashkali, 29 egjiptian, 7 goran, 6 boshnjak, dhe 115 persona nuk është raportuar nga komunat përkatësia etnike. Gjithsej janë 923 persona të kthyer gjatë periudhës raportuese. |